



BASHKIA VAU-DEJËS

Plani i Përgjithshëm Vendor

PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT (Draft)

Vau-Dejës 2017



BASHKIA VAU-DEJËS

PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORRIT

Tetor 2017

Parathënie

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të bashkisë Vau-Dejës mbështetet nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP) në Shqipëri, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC). Në tetor të vitit 2016, në takimin e Komitetit Koordinues të DLDP, ambasadori zviceran Z. Kristof Garf, zyrtarizoi nismën për mbështetjen financiare dhe teknike që do i jepej bashkisë Vau-Dejës për hartimin e PPV. Në atë takim gjithashtu u firmos edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit mes MZHU, AKPT, DLDP dhe Bashkisë Vau-Dejës, si një hap i parë i që përshkruante kornizën e angazhimeve dhe bashkërendimit të aktorëve kryesorë në këtë proces.

Në vijim, Bashkia do të punojë ngushtësisht me konsulentin për të kaluar hapat ligjore e teknike të hartimit të PPV-së dhe rregullores së tij. Finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor do të jetë një nga arritjet e para të kësaj bashkie të re, me dëshirën e vullnetin për të përballuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, së bashku me komunitetin, që është burimi dhe qëllimi final i këtij vullneti drejt të ardhmes.

Bashkia Vau-Dejës falënderon, të gjithë stafin e Bashkisë, në veçanti zyrën e planifikimit të territorit, për sigurimin e të dhënave dhe dokumenteve të dobishme të projektit. Të dhënat dhe njohuritë e zgjeruara të tyre, kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin sa më të plotë dhe të saktë të këtij dokumenti.

Falënderon gjithashtu të gjithë përfaqësuesit e Njësive Administrative, si dhe të palëve të interesuara dhe qytetarëve të kësaj bashkie, që gjithmonë kanë qenë pjesëmarrës dhe mjaft aktivë në çdo Forum Këshillues.

I shpreh mirënjohjen Ministrisë së Zhvillimit të Territorit, për nxitjen dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e cila në shumë raste ka dhënë ndihmesën e saj të vyer, gjatë hartimit të dokumentit të Planifikimit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Vau-Dejës. Falënderojmë, veçanërisht, koordinatoren e projektit, që me bashkëpunimin e ngushtë, ka ndihmuar në avancimin e punës për këtë dokument.

Së fundmi, falënderon konsulentin, UTS-01, për mbledhjen e të gjithë materialeve ekzistuese, për dokumentimin e tyre dhe për përditësimin e të dhënave, si dhe për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Territorial të Bashkisë.

Shkurtime

AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve
DRB	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
IGJEU	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PDV	Plan i Detajuar Vendor
PKS	Plan Kombëtar Sektorial
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar (Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë 2015-2030)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
ToR	Terma Reference
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMMTB	Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës Bujqësore
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Lista e figurave

Fig. 1 Koncepti territorial.....	21
Fig. 2 Nsarja e territorit sipas pesë sistemeve	33
Fig. 3 Sistemi urban	37
Fig. 4 Sistemi bujqësor.....	40
Fig. 5 Sistemi natyror.....	44
Fig. 6 Sistemi ujqor	47
Fig. 7 Sistemi i infrastrukturës.....	50
Fig. 8 Struktura individuale të veçuara.....	63
Fig. 9 Struktura individuale lineare	64
Fig. 10 Struktura individuale të grupuara.....	64
Fig. 11 Struktura kolektive të veçuara.....	65
Fig. 12 Struktura kolektive lineare	66
Fig. 13 Struktura kolektive paralele.....	66
Fig. 14 Struktura kolektive të grupuara.....	67
Fig. 15 Harta e Zonave të Mbrojtura. Burimi: VSM Vau-Dejës	88
Fig. 16 Rrugë e kategorisë A.....	101
Fig. 17 Rrugë e kategorisë C + korsi biçikletash	102
Fig. 18 Rrugë e kategorisë C	102
Fig. 19 Rrugë e kategorisë E	103
Fig. 20 Rrugë e kategorisë E + korsi biçikletash.....	103
Fig. 21 Rrugë e kategorisë F	104
Fig. 22 Rrugë e kategorisë F + korsi biçikletash.....	104
Fig. 23 Rruga industriale nga kryqëzimi i Bushati drejt kufirit me Shkodrën	105

Fig. 24 Korridor i gjelbër	105
Fig. 25 Pista për biçikleta.....	106
Fig. 26 Diagrama e ndërlidhjes së projekteve të zhvillimit dhe objektivave strategjike.....	Error! Bookmark not defined.
Fig. 27 Qëndrueshmëria financiare e projektit	120
Fig. 28 Kuadri i politikave strategjike të SKNDQV-së 2015–2020	153
Fig. 29 Pamje e faqes zyrtare të portalit e-Albania	157
Fig. 30 Faqja zyrtare e portalit e-Lejet	158
Fig. 31 Organigrama e Bashkisë Vau-Dejës	160

Lista e tabelave

<i>Table 1 Strategjitë bazë.....</i>	<i>25</i>
<i>Table 2 Ndërhyrjet strategjike sipas objektivave</i>	<i>28</i>
<i>Table 3 Shpërndarja e sipërfaqes te tokës të Bashkise në pesë sistemet territoriale</i>	<i>35</i>
Table 4 Të dhënat e popullsisë	70
Table 5 Luhatja e popullsisë (INSTAT)	71
Table 6 Popullsia 2000-2015 (Vau-Dejës).....	72
Table 7 Përbërja e popullsisë në 2011 (INSTAT)	72
Table 8 Projektioni i popullsisë sipas njësive administrative	74
Table 9 Ndikimet negative të parashikueshme dhe masat e propozuara	90
Table 10 Programi i Monitorimit të ndikimeve mjedisore	92
Table 11 Shtrirja kohore e projekteve strategjike.....	115
Table 12 Indikatoret sipas Sistemeve.....	139
Table 13 Indikatoret sipas Objektivave Strategjike	141
Table 14 Indikatoret për Monitorim periodik	145

Përmbajtja

1	STRATEGJIA E ZHVILLIMIT.....	15
1.1	METODOLOGJIA.....	15
1.2	VIZIONI STRATEGJIK.....	16
1.2.1	Peizazhet.....	16
1.2.2	Deklarata territoriale.....	17
1.2.3	Koncepti territorial	17
1.2.4	Kriteret udhëzuese	21
1.2.5	Objektivat strategjike	23
1.2.6	Strategjia e zhvillimit lokal.....	24
1.2.7	Tipet e projekteve strategjike	26
1.2.8	Projektet strategjike	28
1.2.9	Projektet prioritare.....	31
2	PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE.....	33
2.1	NDARJA E TERRITORIT SIPAS PESE SISTEMEVE.....	34
2.1.1	Sistemi Urban (UB)	35
2.1.2	Sistemi Bujqësor (B)	38
2.1.3	Sistemi Natyror (N).....	41
2.1.4	Sistemi Ujor (U)	45
2.1.5	Sistemi i Infrastrukturës (IN)	48
2.2	ZONIMI SIPAS PERDORIMIT TE TOKES.....	51
2.2.1	Kategoritë Bazë të përdorimit të tokës.....	51
2.2.2	Nënkategoritë e përdorimit të tokës	52

2.3	NDARJA E TERRITORIT NE NJESI ZHVILLIMI	55
2.3.1	Morfologjia urbane.....	55
2.3.2	Ndarja e territorit në Zona	56
2.3.3	Ndarja e territorit në Njësi Strukturore.....	58
2.3.4	Kodifikimi i Njësive	59
2.4	RRJETI I INFRASTRUKTURAVE	60
2.5	ZONAT E RENDESISE KOMBETARE	60
2.5.1	Zonat aktuale.....	61
2.5.2	Zgjerimi i zonave.....	61
2.6	ZONAT PRIORITARE TE ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN.....	62
2.7	TIPOLOGJITE HAPESINORE TE PROPOZUARA	62
2.8	PLANET E DETAJUARA VENDORE.....	68
2.9	SHPERNDARJA E POPULLSISE NE TERRITOR	70
2.9.1	Të dhënat demografike	70
2.9.2	Projeksioni i popullsisë	72
2.10	PLANI I STREHIMIT	74
2.11	ZONAT KU DO TE ZBATOHEN INSTRUMENTET PER DREJTIMIN E ZHVILLIMIT	76
3	PLANI I MBROJTJES SE MJEDISIT	79
3.1	HYRJE	79
3.2	TRAJTIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË PLANIT	80
3.2.1	Trajtimi i ndikimeve në Tokë	80
3.2.2	Trajtimi i ndikimeve në ajër dhe tek faktorët klimatikë.....	81
3.2.3	Trajtimi i ndikimeve në ujëra.....	81
3.2.4	Trajtimi i ndikimeve në biodiversitet dhe në mjedisin natyror	83

3.2.5	Trajtimi i mbetjeve në zonat Hot-Spot	83
3.2.6	Trajtimi i ndikimeve në mjedisin akustik-zhurmat	85
3.2.7	Trajtimi i ndikimeve në popullsi dhe në asetet materiale.....	86
3.2.8	Trajtimi i ndikimeve mbi trashëgiminë kulturore	86
3.2.9	Trajtimi i ndikimeve mbi peizazhin.....	86
3.2.10	Konkluzion për trajtimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit	89
3.3	PROGRAM MONITORIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS.....	89
4	PLANI I SHERBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE	95
4.1	INFRASTRUKTURA PUBLIKE	95
4.1.1	Infrastruktura e transportit	96
4.1.2	Rregullat e sistemit rrugor dhe të transportit sipas Kodit Rrugor	97
4.1.3	Kushtet teknike – dimensionimi i seksionit të rrugës	101
4.1.4	Parametra të tjerë, skema e lëvizjes dhe transporti publik	105
4.2	NDIKIMI I PLANEVE TE TJERA.....	107
4.3	SHERBIMET SOCIALE, TIPOLOGJIA DHE RREZET E MBULIMIT	109
4.3.1	Tipologjia	109
4.3.2	Shpërndarja në territor	111
4.3.3	Rrezet e mbulimit	111
5	PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIMIN E PPV	112
5.1	PROJEKTET E ZHVILLIMIT	112
5.1.1	Identifikimi dhe hartëzimi i projekteve	112
5.1.2	Projektet e zhvillimit dhe ato pilot	113
5.2	PLANI I VEPRIMIT	114
5.2.1	Fazimi i zhvillimit dhe projektet prioritare	115

5.2.2	Diagrama e veprimit	Error! Bookmark not defined.
5.2.3	Analiza financiare e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit	119
5.2.4	Analiza ekonomike e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit	120
5.3	PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE	121
5.3.1	Kërkesa financiare për projektet pilot dhe mbulimi i saj	122
5.3.2	Konsiderata përmbyllëse.....	131
5.4	TERMAT E REFERENCËS PËR ZONAT ME PDV	131
5.4.1	Të përgjithshme.....	131
5.4.2	Termet e referencës për PDV e Njesisë Qendrore Urbane të Vau-Dejës	133
6	MONITORIMI I PLANIT TE ZHVILLIMIT.....	139
7	RISHIKIMI I PPV	148
8	KAPACITETET INSTITUCIONALE	149
8.1	HYRJE	149
8.2	REFORMA ADMINISTRATIVE DHE SFIDAT KRYESORE TE BASHKISE VAU-DEJËS.....	150
8.3	ROLI I QEVERISE VENDORE	150
8.3.1	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	150
8.3.2	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale	151
8.3.3	Strategjia ndërsektorale për decentralizim dhe qeverisjen vendore 2015–2020	152
8.3.4	Institucionet (autoritetet) qendrore në planifikimin dhe zhvillimin e territorit ...	153
8.3.5	Instrumentet Kombëtare të Planifikimit	156
8.3.6	Portali e-Albania dhe e-Lejet	157
8.4	RRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË BASHKISË VAU-DEJËS	158
8.4.1	Masat institucionale	161
8.4.2	Trajnimet e stafit	163

8.4.3	Gjithpërfshirja e qytetarëve në proceset qeverisëse	164
9	ANEKS	166

HYRJE

Dokumenti i Relacionit të Zhvillimit të Territorit është një nga dy dokumentet finale të këtij studimi, i cili lindi mbi bazën Ligjit 107/2014, dt 01.10.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Rregullores së Planifikimit dhe aktetve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

Kjo fazë do të prodhojë rezultatet kryesore të Planit të Përgjithshëm Vendor: Planin e Zhvillimit të Territorit dhe Rregulloren Lokale. Këto rezultate do të paraqiten si 2 dokumente të veçanta: Raporti Teknik dhe Rregullorja.

Plani i Zhvillimit Territorial do të vazhdojë të detajojë më tej programin e Strategjisë Territoriale, që është dokumenti strategjik thelbësor që udhëzon zhvillimin fiziko-hapësinor të njësisë së qeverisjes vendore.

Konsulenti, duke u bazuar në Strategjinë Territoriale, ka formuluar planin e zonimit të bazuar në kategoritë dhe nën-kategoritë e propozuara të tokës, duke e ndarë territorin në zona dhe njësi zhvillimi. Po kështu Plani propozon infrastrukturën kryesore dhe shërbimet, ato dytësore ekzistuese dhe që do të krijohen. Vëmendje e veçantë i është kushtuar shpërndarjes së popullsisë (banorë, turistë, forcë pune), si dhe programeve të nevojshme për të arritur objektivat e Strategjisë si dendësimi, rigjenerimi, zhvillimi, ruajtja, etj.

Plani përcakton parametrat specifike të përdorimit të tokës, programin e banesave sociale dhe aplikimin e instrumenteve të veçanta të zhvillimit të bazuar në strukturën e territorit.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë:

- balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;
- krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor;
- drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;
- rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
- planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
- rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike, sipas këtij ligji;
- rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

Plani i zhvillimit bazohet gjerësisht në Analizën e gjendjes ekzistuese dhe objektivat e përcaktuara në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit të Territorit, si dhe përqasjen metodologjike që ajo shpalos për analizimin e territorit.

Ky dokument përbëhet nga 4 kapituj kryesore:

- Plani i propozimeve territoriale
- Plani i mbrojtjes së mjedisit
- Plani i shërbimeve dhe infrastruktura publike
- Plani i veprimit për zbatimin e PPV

Plani i propozimeve territoriale është një tërësi hartash dhe materiali shpjegues, që duke u bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, përkthen këto strategji në struktura konkrete, duke ndarë territorin në njësi zhvillimi dhe duke përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë e propozuara për përdorimin e tokës, kriteret e zhvillimit, format e ndërhyrjes në territor, etj.

Plani sqaron parametrat specifikë të përdorimit të tokës dhe aplikimin e instrumentave të veçanta për zhvillimin bazuar në metodologjinë e përcaktuar në Strategji për kuptimin e strukturës së territorit.

Programi i mbrojtjes së mjedisit bazohet kryesisht në kufizimet e vendosura sipas elementëve të rëndësishëm territorialë, zonat me rrezikshmëri dhe probleme mjedisore, propozimet për ruajtjen e hapësirës së mbrojtur natyrore dhe zgjerimit të saj. Vëmendje e veçantë u kushtohet zonave të ndjeshme dhe përmirësimit të cilësisë së ujit, tokës dhe ajrit.

Plani i shërbimeve dhe infrastruktura publike bazohet gjerësisht në rekomandimet e PPK dhe projekteve e programeve të tjera në nivel kombëtar, duke identifikuar elementët kryesorë të infrastrukturës, ndikimin e tyre në territor, masat që mund dhe duhet të ndërmerren për përmirësimin e sistemit infrastrukturor dhe segmentët e rinj që i shtohen këtij sistemi.

Bazuar në nevojat dhe problemet, janë identifikuar sipas tipologjisë, cilësisë, vendndodhjes dhe rrezes së mbulimit, shërbimet sociale të propozuara, së bashku me propozimet për infrastrukturën inxhinierike. Janë identifikuar tokat që preken nga këto zhvillime, dhe territoret konkrete të përshtatshme për disa nga ndërhyrjet, duke i lënë mundësi zgjedhje studimeve të metejshme dhe duke u përqëndruar në asetet publike që ka Bashkia Vau-Dejës.

Pjesë e këtij kapitulli është dhe detajimi i mëtejshëm i Planit të Investimeve Kapitale, që analizon më tej propozimet e hedhura në dokumentin e Strategjisë, duke u dhënë prioritet investimeve në infrastrukturën e domosdoshme për rritjen e cilësisë së jetës në sistemin urban dhe përmirësimin e prodhimit. PIK vazhdon me përpunimin e objekteve prioritare të identifikuara gjatë fazës së Strategjisë.

Plani i veprimit për zbatimin e PPV vazhdon me identifikimin e fushave prioritare për zhvillimin e territorit të bashkisë. Projektet prioritare janë shprehur që në strategjinë territoriale dhe konsiderohen si zbatues të objektivave të shprehura në të.

Për pjesët më të rëndësishme të hapave të zhvillimit, si direktivat për PDV-të e zonave prioritare, planeve të mundshme sektoriale, projekteve emergjente të ndërhyrjeve në infrastrukturë, Plani i veprimit përcakton kriteret bazë ku do të bazohen Termat e Referencës, mbi të cilat do të zhvillohen projektet konkretë në të ardhmen e afërt.

Po në këtë kapitull janë identifikuar treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së, duke treguar edhe faktorët që mund të kërkojnë një rishikim të pjesshëm të tij, apo që do të rrezikonin ecurinë e tij.

1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT

1.1 METODOLOGJIA

Në mënyrë që Plani i Përgjithshëm Vendor të mund të jetë një instrument efikas për zhvillimin e territorit, ai duhet:

- të kuptojë synimet ekonomiko-sociale të komunitetit në nivel strategjik;
- të evidentojë veprimet strategjike që mund të realizohen në një kohë të shkurtër me anë të resurseve të disponueshme dhe/të përdorshme;
- të përcaktojë objektiva konkrete dhe afatet kohore të tyre;

Vizioni Strategjik duhet konsideruar si qasja projektuese e një “perspektive territoriale”, e ndërtuar duke u nisur nga “ambiciet ekonomiko-sociale” të komunitetit lokal. Bëhet fjalë për ndërtimin e një politike të re urbane në harmoni më të madhe me logjikën ekonomike. Duke qenë se një detyrë e tillë zhvillimi nuk mund t’i lihet vetëm PPV-së, siç nënkuptohet tradicionalisht, procesi duhet të parashikojë ndërtimin e një perspektive territoriale si kalim nga ambiciet ekonomiko-sociale te projektet e ndërhyrjet.

Një PPV e hartuar sipas logjikës së mësipërme ka këto avantazhe:

- menaxhon transformime tokave, në kuadër të një objektivi koherent të nxjerrjes në pah të vlerave ekonomike;
- garanton funksionalitetin e secilës prej ndërhyrjeve, në lidhje me sistemin e përgjithshëm të rrjeteve;
- favorizon pikat (vendndodhjet) e mundshme prodhuese, që janë të afta të thithin investime nga jashtë.

Në këtë kontekst, Plani i Përgjithshëm Vendor duhet të dijë të përballojë me vetëdije raportin mes vendit dhe rrjetit, si në hapësirë ashtu edhe në shkallë, domethënë të përfytyrojë lloje të reja organizimi të hapësirës dhe t’i përfytyrojë ato në lidhje me pozicionimin strategjik të vendit krahasuar me dinamikën e rrjeteve.

Transformimi i një Plani të Përgjithshëm Vendor në një projekt zhvillimi, nënkupton shpjegimin e atyre ideve që mund t’i shtojnë planit mundësi të reja zhvillimi konkrete dhe të menjëhershme.

Në përputhje me vizionin e PPK dhe atë strategjik për territorin, PPV-ja duhet të marrë përsipër detyrën e parashikimit të "mundësive taktike" të afta për t’i bërë realitet zgjedhjet strategjike. Pra duhen parashikuar të gjithë elementët domethënës, që kanë aftësinë ta transformojnë në një projekt të zbatueshëm, që të mund të garantojë realizueshmërinë e strategjive të evidentuara në shkallë territoriale, si edhe sigurinë e shpejtësinë procedurale për realizimin e këtyre parashikimeve të bëra.

1.2 VIZIONI STRATEGJIK

1.2.1 Peizazhet

Sistemi territorial nga i cili është e përbërë bashkia e re Vau-Dejës për shkak të bashkimit administrativ të gjashtë njësive të mëparshme Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Shllak, Temal, paraqet diversitet të dukshëm nga pikëpamja e profilit peizazhistik dhe territorial.

Në fakt, bëhet fjalë për një territor që, kur vërehet nga jugu në veri, nga kufiri me Bashkinë e Lezhës dhe Shkodrës, drejt njësive që i përkasin zonës së mbrojtur të Alpeve Shqiptare, duket kryesisht e karakterizuar nga tre lloje peizazhesh:

- A. zona fushore bujqësore, e karakterizuar nga sistemi i gjerë kullues afër rrjedhës kryesore ujore (lumi Drin), drejt bashkimit të saj me pellgjet ujore të rajonit të Shkodrës, ku zhvillimi i vendbanimeve ka qenë më i madh, shpesh duke dëmtuar tokat bujqësore me pjellori të lartë;
- B. territori ujqor, i përbërë nga lumi Drin, i zgjeruar nga ndërtimi i hidrocentraleve të mëdha duke filluar nga fundi i viteve '60 (diga e Vau-Dejës dhe e Komanit);
- C. zona gjerë dhe pothuajse e pabanuar malore, një prelud për zhvillimin e sistemeve malore më të larta të rajonit, objekte të mbrojtjes mjedisore (Parku Kombëtar i Alpeve).

Termi "Peizazh" është përdorur këtu në kuptimin e tij strategjik-planifikues – sipas përkufizimit të dhënë nga Konferenca Evropiane për Peizazhin, Firence, 2000 – si një njësi territori e karakterizuar nga kushte homogjene nën profilin: (i) e karakteristikave gjeografike dhe morfologjike–hapësinore; (ii) të vendbanimeve të njerëzve dhe të përdorimeve mbizotëruese të tokës; (iii) të perspektivës programatike dhe qeverisjes së transformimeve.

Ky klasifikim i peizazheve mbizotëruese, i realizuar vetëm për qëllimin strategjik të programit, nuk përfshin disa "përgjashtime" lokale, të cilat gjithashtu duhen marrë parasysh për të pasur një analizë më të plotë dhe që mund të jenë një prelud për një artikulum të mëtejshëm të rregullave të përgjithshme, të cilat duhen zhvilluar në pjesën e rregullores së planit të ri:

- Peizazhi i korridorit infrastrukturor që përbëhet nga rruga kombëtare dhe linja hekurudhore;
- Peizazhi i kodrave që ngrihen brenda zonës fushore, dhe në të cilin gjenden vendbanimet e ultësirës.
- Peizazhi i qendrave të mëdha urbane, Bushat dhe Vau-Dejës, që ende nuk ngrihen në rangun e realiteteve të mirëfillta urbane, por që tashmë paraqesin një përqendrim urban të rëndësishëm nëse krahasohen me përqendrimin e ulët të vendbanimeve në zonat e tjera, sidomos në zonat malore.

Linjat e zhvillimit dhe rigjenerimit territorial që paraqiten në këto shënime fillestare, duhet të marrin parasysh këto karakteristika specifike të peizazhit, së bashku me një lexim të morfologjisë së vendbanimeve që shfaqen gjithashtu fortësisht të karakterizuara në lidhje me kontekste të tilla.

Parimet themelore që orientojnë strategjinë territoriale, përfshijnë:

A. Aspektet e peizazhit të ultësirës bujqësore

- p.1 Kontrolli i konsumit të tokës bujqësore
- p.2 Sigurimi i vendbanimeve nga rreziku hidrik dhe hidro-geologjik
- p.3 Pajisja me mjete dhe shërbime urbane bazë
- p.4 Përshtatja e infrastrukturave të lëvizjes dhe transportit

B. Aspektet e peizazhit malor të brendshëm

- p.5 Mbrojtja e mjedisit dhe peizazhit
- p.5 Mbështetja e vendbanimeve dhe aktiviteteve të "monitorimit" të zonës malore
- p.6 Hapje ndaj turizmit të qëndrueshëm duke respektuar cilësitë territoriale të peizazhit
- p.7 Zhvillimi i trashëgimisë ujore edhe për qëllime energjetike, në harmoni me vlerat mjedisore dhe të peizazhit të zonës

1.2.2 Deklarata territoriale

Vau-Dejës, vendi i tokës së mirë dhe ujit miqësor

Territori i Vau-Dejës është një territor i dedikuar për përdorim bujqësor të tokës, mbrojtjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve ujore, ruajtjen e peizazheve malore.

Vau-Dejës ruan tokën e saj, të pasur dhe pjellore, prodhuese e ushqimit dhe produkteve natyrore, dhe rrit rolin e saj si një portë hyrëse për në zonat malore të vendit. Në veçanti, ruan dhe kujdeset për peizazhet e saj malore, ku kultura e lashte, prodhimi i qëndrueshëm, dhe njerëzit që i mbajnë gjallë këto vlera janë një ndihmese në ruajtjen e ekuilibrit të ndjeshëm natyror dhe artificial prodhuar nga tradita shekullore dhe përdorimi i përgjegjshëm i këtyre burimeve, duke krijuar pengesë dhe mbrojtje kundër rreziqeve të luginës, për një jetesë të mirë të një komuniteti të bashkuar dhe të përgjegjshëm.

1.2.3 Koncepti territorial

Planifikimi urban me karakter strategjik bazohet shpesh në përdorimin e një koncepti territorial në fazën e tij fillestare. Koncepti territorial është një ideogramë që qëndron në bazë të procesit të hartimit të vizionit, me qëllimin e dyfishtë të:

- Qartësimi për palët në procesin e planifikimit se cilat janë zgjedhjet strategjike të vëna në themel të programit të zhvillimit

- Nisjes së një ballafaqimi të mundshëm me bashkëbiseduesit dhe grupet e interesit duke u nisur nga një ide sintetike për organizimin e hapësirës territoriale.

Për rastin në fjalë, territori në kompetencën e Bashkisë Vau-Dejës, mund të interpretohet si i përbërë nga dy zona homogjene të dallueshme qartë: një zonë fushore e karakterizuar nga aktivitet bujqësor dhe me vendbanime urbane të përhapura dhe tjetra malore e karakterizuar nga një përdorim i ulët njerëzor i territorit.

Zona fushore përshkohet nga infrastruktura kryesore me karakter kombëtar (rruga Tiranë-Shkodër dhe hekurudha) dhe akomodon qendrat kryesore urbane (Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Barbullush). Zona malore mbizotërohet nga prania e liqeneve artificiale dhe infrastrukturat e hidrocentraleve.

Nga pikëpamja e potencialit të zhvillimit të territorit (resurset e pranishme dhe ndjeshmëria e sistemit lokal) është e padiskutueshme se zona fushore është e prirur për riorganizimin e aktivitetit bujqësor dhe ajo malore për zhvillimin e turizmit mjedisor. Por, në rastin e parë zhvillimi i bujqësisë duhet të krijojë një marrëdhënie të dyanshme dhe sinergjike me fuqizimin e qendrave urbane. Në rastin e dytë, zhvillimi turistik duhet të gjejë forma bashkëjetese inovative me shfrytëzimin energjetik të resurseve ujore.

Pra, mundemi të sintetizojmë si vijon konceptin territorial që do të shërbejë si bazë e vizionit strategjik të PPV-së.

Në zonën fushore:

- Riorganizimi dhe zhvillimi i aktivitetit bujqësor, nëpërmjet vlerësimit të resursit terren dhe implementimit të resursit punë;
- Përforcimi i qendrave urbane, që kanë intensitet në aktivitetin urban por që mund të transformohen edhe në pole për ofrimin e shërbimeve për territorin përreth;
- Marrëdhënie sinergjike ndërmjet sistemit infrastrukturor dhe aktivitetit prodhues, si bujqësor ashtu edhe turistik.


Në zonën malore:

- krijimi i një korridori lumor plurimodal dhe multi funksional, si rrugë lidhëse me parkun e Alpeve, me qëllime turistike si dhe lidhjeje territoriale të komuniteteve lokale.
- Rigjallërimi dhe specializimi i rolit funksional të vendbanimeve të pranishme përgjatë korridorit lumor dhe integrimi i resurseve të ndryshme të disponueshme (natyrore, kulturore, historike, arkeologjike, etj.).


Ky koncept i thjeshtë strategjik, përveç identifikimit të sistemit të organizimit të hapësirave dhe funksioneve territoriale, lejon që realiteteve të ndryshme urbane që përbëjnë Bashkinë e Vau-Dejës, t’u përcaktohen role specifike në brendësi të vizionit të zhvillimit:

- qendra territoriale dhe rilindje urbane në njësitë administrative Vau-Dejës, Bushat, Hajmel;
- qendra lokale dhe me veçori turistike në njësitë administrative Vig-Mnelë, Shllak dhe Temal.

Transformimi i konceptit territorial në vizionin strategjik është hapi teknik i radhës i cili, mbi bazën analizave dhe udhëzimeve nga reagimet e komunitetit lokal, do të çojë në përcaktimin e hollësishëm të programit të zhvillimit nga pikëpamja e “objektivave” “programeve” dhe “projekteve” .



PPV Bashkia Vau-Dejës
Plani i Zhvillimi të Territorit






Fig. 1 Koncepti territorial

1.2.4 Kriteret udhëzuese

Kriteret udhëzuese shtjellohen në kriteret udhëzuese për kontekstet urbane dhe për kontekstet territoriale dhe në pjesën më të madhe dallohen nga detyrat që u jepen në përgjithësi Planeve të Përgjithshme Vendore, në rastin e Italisë, nga instrumentet e niveleve më të larta se niveli lokal dhe që i dedikohen planifikimit të peizazhit (si p.sh. Plani Rajonal Territorial i Peizazhit – PTPR). Këto kriteret janë gjithashtu në koherencë edhe me dispozitat për çështjet e peizazhit që vijnë nga Planet Kombëtare, të analizuar në paragrafët e mësipërm.

OBU (objektivat bazë të zonës urbane). Peizazhi fushor dhe zonat urbane kryesore

OBU.1 Parandalimi i konsumit të tokës

OBU.2 Qëndrueshmëria mjedisore e ndërhyrjeve

OBU.3 Ruajtja e karakterit kompakt të vendbanimeve urbane dhe të qendrës urbane kryesore

OBU.4 Rikualifikimi i zonave prodhuese

OBU.5 Zbatimi i parimit të transferimit të së drejtës për zhvillim

OBU.6 Krijimi i zonave në shërbim të transferimit të së drejtës për zhvillim ose të kompensimit të mundshëm të të drejtave më të mëdha për ndërtim

OBU.7 Përfshirja e vendbanimeve të reja për strehim publik në strukturën urbane ekzistuese, që do të realizohet nëpërmjet kompensimit dhe transferimit të së drejtës për zhvillim në zonat e parashikuara për zgjerim

OBU.8 Rigjenerimi i zonave të konsoliduara apo vendbanimeve historike

OBU.9 Rimëkëmbja dhe zhvillimi edhe për përdorim rezidencial dhe turistik të fshatrave të vjetër malorë dhe kodrinorë si dhe rikuperim i ndërtesave historike (kulla)

OBU.10 Mbrojtja, zhvillimi dhe akses i plotë i të mirave të përbashkëta territoriale dhe urbane, i trashëgimisë historike, kulturore, peizazhistike dhe mjedisore;

OBU.11 Rimëkëmbja dhe krijimi i qendrave të reja dhe të mirave të përbashkëta urbane, siç janë hapësirat e gjelbra dhe shërbimet, nëpërmjet mënyrave të reja menaxhuese;

OBU.12 Kundërshtimi i përjashtimit social të banorëve me të ardhura të ulëta

OBU.13 Zhvillimi i rrjeteve ekologjike urbane të integruara me rrjetet e lëvizshmërisë së ngadaltë dhe të turizmit të qëndrueshëm

OBU.14 Mbështetja dhe zhvillimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe kursimit energjetik

OBU.15 Rimëkëmbja dhe rikualifikimi peizazhistik i itinerareve dhe rrugëve të aksesit për në qendrat urbane dhe komplekset e prodhimit industrial, bujqësor dhe të energjisë

OBM (objektivat bazë të zonës malore). Peizazhet Malore

OBM.1 Ruajtja dhe zhvillimi i strukturës gjeo-morfologjike natyrore

OBM.2 Mbrojtja dhe zhvillimi i peizazheve malore bujqësore, pyjore dhe kullotave

OBM.3 Ruajtja e strukturës perceptuese dhe e vlerave origjinale të dukshmërisë së peizazheve lokale

OBM.4 Zhvillimi i infrastrukturave të lëvizshmërisë së butë për soditjen e peizazheve

OBM.5 Mbështetja e formave të shpërhapura të banesave malore, vendbanimet në mbrojtje të peizazhit

OBM.6 Zbutja e rrezikut nga shkaqe mjedisore dhe artificiale

OBM.7 Aktivizimi i politikave të zhvillimit të sektorit bujqësor

1.2.5 Objektivat strategjike

Strategjia e Planit mbështetet në gjashtë objektivat strategjike të mëposhtme:

OB.1. Ofrimi i shërbimeve bazë

OB.2. Lëvizja me mënyra të ndryshme

OB.3. Qendrat urbane

OB.4. Turizmi

OB.5. Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut

OB.6. Energjia

Objektivi i parë strategjik (“Pajisja me shërbimet bazë”) përfshin ato veprime të nevojshme për të pajisur territorin me kushtet minimale të strukturimit dhe funksionimit për të sjellë komunitetin lokal në gjendje për të ndërmarrë rrugën e zhvillimit. Bëhet fjalë për veprime që kryhen për të garantuar infrastrukturën bazë, shërbimet sociale thelbësore, sigurinë dhe gjallërinë. Ai artikullohet në programet e mëposhtme:

- 1.1. Përmirësimi i rrjeteve teknike
- 1.2. Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
- 1.3. Shërbimet ndaj qytetarëve

Objektivi i dytë strategjik (“Lëvizja me mënyra të ndryshme”) përmban veprime të nevojshme në përmirësimin e lëvizjes, edhe nëpërmjet formave të përshtatshme të integritetit të modaliteteve të ndryshme. Kjo artikullohet në programet e mëposhtme:

- 2.1. Rrugët automobilistike
- 2.2. Korridori lumor
- 2.3. Ndërhyrje të tjera për lëvizjen

Objektivi i tretë strategjik (“Qendrat urbane”) synon të ndjekë objektivin për të realizuar në territor pole urbane, të afta për të ofruar funksionet komplekse të sistemit urban. Duke qenë përballë një situatë në të cilën zhvillimi i vendbanimeve ka ndjekur trende spontane dhe jo të udhëhequra, ky objektivi kërkon të krijojë një hierarki funksionale të qendrave të banuara, i konsideruar si kusht thelbësor që struktura urbane të kryejë një funksion aktiv në mbështetje të zhvillimit të komunitetit lokal. Programet që e përbëjnë atë janë:

- 3.1. Pole shërbimi për territorin përreth
- 3.2. Zhvillimi i qendrave lokale
- 3.3. Rikualifikimi urban

Objektivi i katërt strategjik (“Turizmi”) paraqet elemente të zhvillimit socio-ekonomik bazuar në mundësinë e përdorimit për qëllime turistike të burimeve të rinovueshme në territor. Bëhet fjalë për veprime që ndërmerren për ti dhënë vlera potenciale natyrore dhe kulturore që ekzistojnë në territor. Programet në mbështetje të këtij objekti janë:

- 4.1. Turizmi mjedisor
- 4.2. Turizmi kulturor
- 4.3. Ndërhyrjet e tjera për zhvillimin e turizmit

Objektivi i pestë strategjik (“Bujqësia, blegtoaria dhe kultivimi i peshkut”) ka tendencë të zhvillojë potencialin e lidhur me prodhimin primar, të lidhur pikërisht me aktivitetin bujqësor, blegtoar dhe me kultivimin e peshkut. Programet e identifikuar janë:

- 5.1. Strukturat e shërbimit
- 5.2. Rritja e prodhimit

Objektivi i fundit strategjik (“Energjia”) kërkon të përqendrohet në zhvillimin e një resursi tjetër që është i pranishëm në mënyrë tradicionale në territor, atë të prodhimit të energjisë elektrike. Bëhet fjalë për veprime të ndërmarra për të zhvilluar prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, edhe nëpërmjet diferencimit të cikleve të saj prodhuese. Programet e identifikuar janë:

- 1.1. Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
- 1.2. Diferencimi i prodhimit të energjisë

Bashkimi sinergjik dhe plotësues i gjashtë objektivave strategjike të identifikuar, konsiderohet i përshtatshëm në përcaktimin e një vizioni të aftë për t’i dhënë komunitetit lokal një rrugë rritjeje dhe zhvillimi, duke u bazuar në efektin shumëfishues të veprimeve të veçanta.

Duke i atribuar veprimeve të ndryshme ndërhyrjet e identifikuar edhe në bazë të analizave në terren dhe fazave të dëgjësive lind një strategji e përgjithshme e hartuar si më poshtë:

Objektiva të tilla gjejnë shtjellim dhe përkufizim në përbërjen e Vizionit Strategjik Operativ të përmendur në paragrafët e mëposhtëm.

1.2.6 Strategjia e zhvillimit lokal

Vizioni hapësinor “lokal” evidenton në territor temat e mëdha strategjike të sistemit urbanistik, të nevojshme për përcaktimin e kushteve të favorshme për arritjen e objektivave të zhvillimit. Një sistem urbanistik funksional dhe i qëndrueshëm, si në shkallë territoriale ashtu edhe urbane, është një nga kushtet e domosdoshme për favorizimin e realizimit të programit. Por projektimi i vizionit hapësinor lokal ka nevojë për strategji specifike për t’u realizuar. Këto strategji duhet,

nga njëra anë të ndjekin përmbajtjen e propozimit strategjik të shkallës së gjerë dhe nga ana tjetër të përcaktojnë veçoritë funksionale për territore specifike, por pa krijuar ekskluzivitet funksionesh apo përdorimesh.

Për territorin e marrë në studim, “parakushti” strukturor për nisjen e zhvillimeve strategjike është tejkalimi i mungesave në sisteme dhe infrastruktura ekzistuese. Asnjë program nuk mund të zhvillohet në një territor i cili nuk garanton nivelet minimale të funksionalitetit të sistemeve të tij bazë. Nevoja e përmbushjes së hendeqeve të territorit lokal është një parakusht i pamënjanueshëm për nisjen e programeve të zhvillimit strategjik.

Në këtë kuptim, mund të konsiderohen si strategji të mirëfillta themelore:

- politikat që synojnë zgjidhjen e nyjeve strukturore të komunitetit lokal (përcaktimi i aseteve të pronësisë, rregullat për taksimin lokal, normat për qeverisjen e miratuar të transformimeve);
- programet që synojnë të garantojnë kushtet minimale të funksionimit teknik të vendbanimeve urbane (efiçenca e rrjeteve, efikasiteti i mënyrave të menaxhimit, akses i lirshëm ndaj resurseve);
- ndërhyrjet që kanë për synim garantimin e qëndrueshmërisë së zonave të banuara (vënia në siguri e territorit, mbrojtja e trupave ujore, mbrojtja e resurseve mjedisore);
- projektet që synojnë sigurimin e një sistemi urban të jetueshëm (organizimi i sistemit të transportit, krijimi i qendrave urbane, pajisja me shërbime).

Table 1 Strategjitë bazë

STRATEGJITË BAZË (kushtet fillestare për zhvillim)	
Politikat strukturore	Përcaktimi i aseteve të pronësisë
	Rregulla për taksimin lokal
	Norma për qeverisjen e miratuar të transformimeve
Funksionimi teknik	Efiçenca e rrjeteve
	Efikasiteti i mënyrave të menaxhimit
	Akses i lirshëm ndaj resurseve
Qëndrueshmëria e zonave të banuara	Vënia në siguri e territorit
	Mbrojtja e trupave ujorë
	Mbrojtje e resurseve mjedisore
Jetueshmëria e sistemit urban	Organizimi i transportit
	Krijimi i qendrave urbane
	Pajisja me shërbime

Për territorin duhet përcaktuar *misioni* kryesor i programit afatmesëm strategjik të zhvillimit. Bëhet fjalë për përcaktimin e sektorit (ose sektorëve) në të cilët do të investohet në një periudhë afatshkurtër, për të shprehur që në periudhën afatmesme të konstatohen efektet pozitive që do të kenë aftësinë nxitëse të cikleve të zhvillimit.

Evidentimi i këtyre sektorëve kyçe nuk përjashton mundësinë, që të njëjtat aktivitete të mund të jenë të zbatueshme diku tjetër. Bëhet fjalë për evidentimin e prioriteteve dhe veçorive të secilit territor, të cilat ndihmojnë në orientimin e investimeve publike dhe private.

Së fundmi, strategjia lokale duhet të mbështetet në disa projekte të cilat duhet të jenë të realizueshme në një kohë të shkurtër, me qëllim që të tregojnë aftësinë vepruese të zgjedhjeve të bëra, nëpërmjet disa ndërhyrjeve të cilat do të shërbejnë edhe si shembuj për projektet e ardhshme (projekte pilot).

1.2.7 Tipet e projekteve strategjike

Qasja inovative urbane, që synon të përftojë një kualitet më të lartë të rezultateve, bazohet në hartimin e bashkërenduar të strategjisë dhe të projekteve operative. Projektimi i zonave të veçanta përcaktohet njëkohësisht dhe në koherencë me vizionin e përgjithshëm strategjik, me synim maksimizimin e bashkëveprimit mes dinamikave të zhvillimit dhe karakterit hapësinor të zonave.

Kjo lidhje e ngushtë mes planifikimit strategjik dhe projekteve operative është kushti kryesor për të siguruar efikasitetin e proceseve dhe cilësinë e rezultateve. Për këtë arsye, Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), përveç koherencës së kuadrit të përgjithshëm, duhet të përmbajë edhe projektin e zonave të konsideruara me interes strategjik. Projekti i tyre duhet konsideruar si emblematic dhe si një shembull i drejtimeve të ndryshme që mund të ndiqen për rigjenerimin urban dhe zhvillimin e territorit, gjithashtu duhet të jetë një pikë referimi dhe udhëzues për ndërhyrjet e ardhshme në territor.

Projektet strategjike mund të jenë të llojeve të ndryshme. Edhe pse të gjitha kanë si synim zhvillimin e përgjithshëm të territorit, ato mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme në arritjen e objektivave strategjike.

Në radhë të parë, mund të themi se ekzistojnë projekte që janë të nevojshme për të siguruar kushtet nga ku mund të nisnin proceset e zhvillimit. Këto janë projekte që duhet të kenë si synim pajisjen e territorit me shërbimet bazë, siç janë shërbimet parësore, qëndrueshmëria mjedisore, jetueshmëria e qyteteve (përshtatja e rrjeteve teknike, pastrimi i territorit nga mbetjet urbane, kontrolli i shfrytëzimit të burimeve ujore etj.). Këto lloje projektesh mund t'i quajmë “projekte bazë”.

Pastaj qëndrojnë projektet që i dedikohen në mënyre më të veçantë zhvillimit. Këto projekte trajtojnë tematika specifike, brenda sektorëve të përcaktuar si strategjikë, për zhvillimin e komunitetit vendor. Si rregull, këto janë të paktë në sasi por mjaft të rëndësishëm dhe të aftë për të nxitur proceset spontane dhe vetë-financuese të zhvillimit. Këto lloje projektesh mund t'i quajmë “projekte zhvillimi” (dhe mund t'i ndajmë në kategori të ndryshme: projekte infrastrukturore, projekte urbane, projekte prodhimi, e kështu me radhë).

Brenda kategorisë së projekteve të zhvillimit qëndrojnë projekte më të vogla, por shumë të rëndësishme për nivelin e tyre të prioritetit dhe për aftësinë e tyre për të qenë shembull për projektet e ardhshme. Janë projekte shumë të rëndësishme për arsye të shikueshmërisë së tyre dhe aftësisë komunikuese, të cilat marrin rolin e “projekteve pilot”.

Në përfundim, projektet strategjike mund ti ndajmë në këto tre kategori:

- **Projekte Bazë**

“Projektet bazë/parësore” janë ata projekte, që konsiderohen të domosdoshëm për sigurimin e kushteve fillestare për zhvillim. Këto projekte nevojiten për të mundësuar arritjen e atyre kushteve fillestare që konsiderohen të domosdoshme për nisjen e çfarëdo programi zhvillimi, duke siguruar efikasitetin minimale të sistemit territorial, pa të cilën është e pamendueshme nisja dhe nxitja e proceseve të zhvillimit të sistemit prodhues.

Këto projekte kanë të bëjnë me kushtet minimale të funksionimit dhe të jetueshmërisë së sistemit territorial, si për shembull efikasitetin funksional të sistemit urban, qëndrueshmëria mjedisore e sistemit të transportit, jetueshmëria e sistemit urban etj.

Projektet bazë/parësore, jo domosdoshmërisht kanë përmbajtje “strategjike”, por shpeshherë kanë të bëjnë me pajisjen normale me elementet bazë të një territori. Në fakt, në rastet kur territori paraqet mungesa të mëdha nga pikëpamja e pajisjes me elementët bazë, mund të jetë e drejtë (në mos e domosdoshme) që t’u jepet ndërhyrjeve për zgjidhjen e këtyre mungesave një karakter strategjik.

Në rastin specifik të sistemeve urbane në fjalë, arritja e një gjendjeje minimale të funksionalitetit të territorit është padyshim një para-kusht i nevojshëm për çfarëdo programi zhvillimi.

- **Projekte Zhvillimi**

“Projektet e zhvillimit” janë projektet të mirëfillta me karakter strategjik, të cilave plani kërkon t’u caktojë detyrën e nisjes së proceseve të zhvillimit të sistemit territorial dhe atij socio-ekonomik.

Bëhet fjalë, në përgjithësi, për projekte që kanë disa karakteristika bazë: i) janë të lidhura ngushtë me potencialin që plani i njeh kontekstit të konsideruar; ii) kanë një rëndësi të lartë dhe aftësi të mëdha nxitëse; iii) prej tyre pritët një impuls i fortë në ndihmë të proceseve të zhvillimit.

Këto projekte përfaqësojnë përgjigjen operative ndaj drejtimit që plani sheh si potencial (ose kërkon të zhvillojë) në një territor të caktuar: i japin forcë potencialeve ekzistuese ose të evidentuara në kontekstin lokal. Është kjo arsyeja pse këto projekte janë të rëndësishme dhe me peshë të madhe, si nga pikëpamja e përqendrimit të resurseve, ashtu edhe nga ajo e pritshmërisë së zhvillimit.

Për shkak të natyrës së tyre të veçantë, këto projekte nuk mund të jenë të shumtë në numër, për të njëjtin territor. Situata me optimale do të ishte që, plani të përcaktojë pak ndërhyrje, pra ato që cilësohen si më prioritare nga administratorët lokalë dhe palët e interesit.

- **Projekte Pilot (prioritare)**

Në kuadër të projekteve të zhvillimit, është e domosdoshme të identifikohen ata që kanë për detyrë të shfaqin, me fakte, potencialet e zhvillimit të identifikuar për territorin përkatës ("projektet pilot"). Këto ndërhyrje, janë të lidhura ngushtë me strategjinë e zhvillimit të identifikuar për zonën në studim, por janë të një përmase më të vogël, edhe pse me domethënie dhe ndikim të fortë komunikues. Karakteristika kryesore e këtyre projekteve është, që të realizohen shpejt dhe me pak fonde: bëhet fjalë kryesisht për projekte demonstruese, për të cilat nuk është e nevojshme që të ketë shpenzime të mëdha kapitale, ndërkohë që është e rëndësishme të jenë në gjendje të nisin menjëherë, dhe të jenë në gjendje të tregojnë, sa më shpejt, në kohë të shkurtër, frytet e veprimeve të zhvillimit të identifikuar në planin e propozuar.

1.2.8 Projektet strategjike

Table 2 Ndërhyrjet strategjike sipas objektivave

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
1- PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	1.1.1 Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale 1.1.2 Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë 1.1.3 Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve 1.1.4 Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	1.2.1 Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane 1.2.2 Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit 1.2.3 Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmytjet
	1.3 Shërbimet publike	1.3.1 Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit) 1.3.2 Shërbimi i autobusëve shkollorë 1.3.3 Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara 1.3.4 Qyteti mik i fëmijëve
2- LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	2.1.1 Përmirësim i rrugës Shkodër – Pukë – Kukës 2.1.2 Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve 2.1.3 Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës – Bushat-Velipojë - Shëngjin 2.1.4 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman 2.1.5 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Vig 2.1.6 Përmirësim i rrugës Koman-Ukë-Bibaj 2.1.7 Realizimi i bypass-it të Vau-Dejës

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
		2.1.8 Rehabilitim i urës Hajmel
	2.2 Korridori lumor	2.2.1 Realizimi i linjës së transportit ujqor Vau-Dejës – Koman 2.2.2 Lidhja rrugore e stacioneve të tragetit me fshatrat 2.2.3 Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen	2.3.1 Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë 2.3.2 Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Mjedë dhe Hajmel 2.3.3 Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel 2.3.4 Realizim i pistave të biçikletave
3- QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	3.1.1 Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës/Mjedë) 3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)
	3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	3.2.1 Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës 3.2.2 Zhvillim i qendrës urbane Mjedë 3.2.3 Zhvillim i qendrës urbane Bushat 3.2.4 Zhvillim i qendrës urbane Rranxë 3.2.5 Zhvillim i qendrës urbane Barbullush 3.2.6 Zhvillim i qendrës urbane Koman 3.2.7 Zhvillim i qendrës urbane Hajmel 3.2.8 Zhvillim i qendrës urbane Nënshatë 3.2.9 Zhvillim i qendrës urbane Ashtë 3.2.10 Zhvillim i qendrës urbane Kosmaç 3.2.11 Zhvillim i qendrës urbane Vig 3.2.12 Zhvillim i qendrës urbane Benë
	3.3 Rikualifikimi urban	3.3.1 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës 3.3.2 Rikualifikim i qendrës urbane Bushat
4- TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	4.1.1 Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik 4.1.2 Lidhje funksionale me Planin e Alpeve nëpërmjet ndërhyrjeve për zhvillimin e ekskursionizmit dhe sporteve ujore 4.1.3 Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit përgjatë liqenit 4.1.4 Realizimi i një korridori të gjelbër në lumin Gjadër 4.1.5 Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit
	4.2 Turizmi kulturor	4.2.1 Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Vig – Sapë – Danjë – Sardë – Koman 4.2.2 Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit 4.2.3 Realizim i një itinerari për turizmin energjetik

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
		4.2.4 Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale dhe ansambleve urbane 4.2.5 Projekt ndriçimi skenografik i kështjellave (Sapë, Danjë, Sardë) 4.2.6 Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës
	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	4.3.1 Realizim qendrash për agro - turizëm dhe turizëm eno - gastronomik 4.3.2 Projekt për pyllëzimin mjedisor të kodrës së Zefjanës 4.3.3 Projekt për brandimin e prodhimeve lokale 4.3.4 Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit
5- BUIQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	5.1 Strukturat e shërbimit	5.1.1 Realizimi i qendrave agro - ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit. 5.1.2 Zona tregtare me prodhime me km zero 5.1.3 Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmytjeve në zonat malore.
		5.1.4 Organizimi i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë.
		5.1.5 Nxitja e shoqërizimit të punës, domosdoshmëri për rritjen e prodhimit bujqësor.
		5.1.6 Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gështenjën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal.
	5.2 Rritja e prodhimtarisë	5.2.1 Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehte 5.2.2 Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat dhe Vau-Dejës 5.2.3 Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejës 5.2.4 Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë. 5.2.5 Zhvillimi i baxhoje në Hajmel dhe Vig-Mnelë
		5.2.6 Zhvillimi i vreshtave në Hajmel ,Bushat, Vau-Dejës, Vig –Mnelë
		5.2.7 Asistence Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale): • Kultivimi i perimeve në sera • Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit.

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROJEKTET
		5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok.
		5.2.9 Park bletësh në Shllak dhe Temal
6- ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	6.1.1 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike 6.1.3 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë	6.2.1 Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës 6.2.2 Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik

1.2.9 Projektet prioritare

Një listë shumë e gjerë e projekteve për zhvillimin nuk përfaqëson një zgjedhje strategjike. Nëse një plan propozon të gjitha ndërhyrjet e mundshme që teorikisht përputhen me qëllimet e supozuara pa dhënë një zgjedhje të prioriteteve, nuk mund të konsiderohet të jetë një plan strategjik. “Të bësh strategji” do të thotë të zgjedhësh, domethënë të vendosësh (me vetëdije dhe kolektivisht) se cilat veprime janë më të dobishme në terma të kapacitetit të tyre dhe efektshmërisë në arritjen e objektivave.

Në rastin tonë objektivat që përbëjnë vizionin strategjik janë gjashtë:

- 1 PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË
- 2 LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME
- 3 QENDRAT URBANE
- 4 TURIZMI
- 5 BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT
- 6 ENERGJIA

Ndër këta, nuk ka dyshim që i pari (“Pajisja me shërbimet bazë”), për vetë natyrën e tij specifike që përfshin të gjitha projektet që kanë si synim arritjen e para-kushteve të cilat janë thelbësore për nisjen e zhvillimit të territorit, është ai më urgjenti dhe më i nevojshmi.

Megjithatë ai përmban ndërhyrjet që, për nga natyra e tyre, duhet të kryhen me mjetet “e zakonshme” të programimit dhe shpenzimeve të bashkisë.

Objektivat që sipas gjykimit tonë duhet të konsiderohen prioritare për nisjen e strategjisë së zhvillimit janë, sipas radhës:

- Qendrat urbane (ndërhyrje për rikualifikimin e qendrave kryesore)
- Bujqësia, blegtoria dhe kultivimi i peshkut (ndërhyrje për zhvillimin e aktivitetit prodhues)
- Turizmi (ndërhyrje për zhvillimin e korridorit lumor)

Me fjalë të tjera jemi të bindur se territori në shqyrtim, përveç një parapërgatitjeje të veçantë për zgjidhjen e mangësive bazike, ka nevojë të themelojë projektin e vet të zhvillimit në një ngritje të fuqishme të aftësive të sistemit urban për të luajtur rolin e “qendrës” për territorin përreth, në kuptimin social (hapësira urbane) dhe ekonomike (pole shërbimi), dhe më pas të synojë zhvillimin e sektorëve të prodhimit bujqësor dhe turizmit.

Sipas kësaj logjike duhen konsideruar “projekte strategjike prioritare” (pra që futen në programin afat shkurtër) ndërhyrjet e mëposhtme, që shfaqin koherence me objektivat e parashtruara:

QENDRAT URBANE

3.2.1 Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës

3.3.1 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës

3.2.3 Zhvillim i qendrës urbane Bushat

BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT

5.1.1 Realizimi i qendrave agro-ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit

3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)

5.2.7 Asistence Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale):

- Kultivimi i perimeve në sera
- Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit.

5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok

TURIZMI

2.2.1 Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman

2.1.4 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman

4.2.1 Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Vig - Sapë – Danjë – Sardë – Koman

2 PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE

Propozimet territoriale për bashkinë Vau-Dejës janë hartuar duke u mbështetur mbi analizën e thelluar të gjendjes ekzistuese si dhe vizionin strategjik të PPV. Këto propozime janë formuluar në përputhje me bazën ligjore aktuale e cila parashikon ndarjen e territorit në pesë sisteme.




Fig. 2 Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve

Bazuar në VKM 671, dt. 29.07.2016 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, territori i Bashkisë është ndarë në 5 sistemet bazë të përkufizuara dhe kodifikuara si më poshtë:

- Sistemi urban (U) formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër.
- Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë” (N) dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm.
- Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë” (B). Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
- Sistemi ujqor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujqor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë” (U).

- Sistemi infrastrukturor përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës "infrastrukturë" (IN).

2.1 NDARJA E TERRITORIT SIPAS PESE SISTEMEVE

Strategjia territoriale ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit të Bashkisë Vau-Dejës. Objektivat strategjike të përcaktuara në aksin e prioriteteve dhe politikave, sipas radhës së tyre përkthehen në projekte dhe ndërhyrje specifike të propozuara. Ndërhyrjet e propozuara mund të shoqërohen me ndryshime në masën dhe gjendjen e sistemeve ekzistuese territoriale, siç përcaktohet në VKM nr. 671 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit". Në shumicën e rasteve, ndryshimet në sistemet territoriale janë të pritura, dhe korrespondojnë direkt me objektivin e ndërhyrjeve dhe mund të shërbejnë:

- në ruajtjen / mbrojtjen e mëtejshme të sistemit territorial,
- zgjidhjen e konflikteve midis sistemeve territoriale dhe
- sigurimin e pajtueshmërisë / plotësueshmërisë midis sistemeve territoriale.

Si rezultat i zbatimit të vizionit dhe planit të zhvillimit dhe projekteve strategjike në territor, kanë ndodhur edhe ndryshime të sistemeve territoriale, pra konvertime të tokës nga një sistem në tjetrin. Këto konvertime/transformime ndodhin mbi bazën e propozimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të infrastrukturave si dhe përmes disa procedurave ligjore të vendosura në legjislacionin sektorial në fuqi (për bujqësinë, tokat natyrore, ujërat, etj.).

Në disa raste, ndryshimi i karakterit dhe përdorimit të një sipërfaqeje toke mund të shkaktojë efekte negative në ndonjë nga sistemet, kryesisht në atë natyror. Në kuadër të VSM do të bëhet një vlerësim i ndikimeve të mundshme mjedisore dhe do të propozohen masa për të monitoruar dhe për zbutur këto ndikime.

Ndryshimet sipërfaqësore/ sasiore në sistemet territoriale lindin si për shkak të sipërfaqes që kërkohet për pranimin e një veprë edhe të kërkesave të territorit përreth (mbrojtjes, distancës minimale, etj.) që kërkohet në bazë të legjislacionit në fuqi (angazhimi dhe vullneti institucional). Duke pasur parasysh se një projekt mund të përfshijë një territor të caktuar, i cila ndryshon karakterin - përdorimin dhe kalon më pas nga një sistem territorial në një tjetër, mund të bëjmë një vlerësim të përafërt të ndryshimeve nga sistemi në sistem, në pesë sistemet territoriale dhe të raportit mes tyre që arrihet, pas implementimit të projekteve të propozuara në planin e veprimit të propozuar.

Gjithashtu, pavarësisht nga ndryshimet në zonën e zënë nga sistemet territoriale, dalin dhe ndryshime cilësore, ndryshime në karakteristikat e cilësisë të mjedisit urban, rural, natyror etj. Përmirësimi i karakteristikave të cilësisë është një element bazë dhe i synuar për ndërhyrjet, për çdo ndikim negativ do të bëhet një vlerësim përkatës në nivelin e Studimit Strategjik të Ndikimit në Mjedis dhe studimeve të specializuara.

Table 3 Shpërndarja e sipërfaqes të tokës të Bashkise në pesë sistemet territoriale

SISTEMI I PËRDORIMIT TË TOKËS	Sipërfaqja ekzistuese	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara
	përqindja %	përqindja %
Sistemi Natyror	68.89	69.27
Sistemi Ujor	5.1	5.1
Sistemi Bujqësor	19.52	21.33
Sistemi Urban	5.95	3.72
Sistemi territorial infrastrukturor	0.52	0.56
	100	100

Ndryshimet, si në territorin natyror dhe atë bujqësor kanë ardhur kryesisht nga tendenca për të sistemuar Sipërfaqen e Sistemit Urban të bazuar fillimisht të Vendimi Nr. 5 i KKT, Datë 29.12.2014 dhe për ta përshtatur shpërhapjen urbane me konceptin e hedhur në Strategjinë e Zhvillimit.

Sipërfaqja e territorit urban është reduktuar ndjeshëm, duke shmangur shtrirjen e panevojshme në territor dhe duke propozuar struktura të përqendruara të mirëpajisura me infrastrukturë. Ky fakt ndihmon edhe në ruajtjen e tokës bujqësore dhe natyrës. Ndërtimet që do të klasifikohen të shtrira në këto sisteme (bujqësor dhe natyror), do të vazhdojnë të ekzistojnë, por nuk do të lejohet zhvillimi i ndërtimeve të tjera në këto territore.

Në vija të përgjithshme, ndryshimet e mëdha janë të kufizuara, duke synuar ruajtjen e karakterit të zonës dhe mbrojtjen e territorit natyror, rural e ujor.

Targeti për 2030 i PPV-së synon shtimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura. Ruajtja dhe shtimi i zonave të mbrojtura natyrore do të bëhet nëpërmjet:

- Vendosjes së prioritetit të përdorimit të Zonave të lira natyrore, me përparësi mjedisin.
- Krijimi dhe konsolidimi i Korridoreve lidhëse Natyrore (korridore të gjelbra) përgjatë luginave lumore, të cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme të sistemit të zonave të mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor.
- Mbrojtjes në zonat me rrezikshmëri natyrore ndaj njeriut si rrjedhim i erozionit, nivelit të lartë sizmik, prezencës së materialeve të dëmshme për shëndetin, etj.
- Mbrojtjes në zonat e degraduara prej aktiviteti njerëzor, si punime minerare, depozitim mbeturinash, shfrytëzim i pa kriter i burimeve natyrore, etj.

Objektivat strategjike të zhvillimit të pesë sistemeve paraqiten në vijim.

2.1.1 Sistemi Urban (UB)

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër. “Territori urban” është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor.

Objektivi kryesor: Rritja inteligjente

Politika: Zhvillimi policentrik, densifikimi, gjithë përfshirja

Për të zbutur pabarazinë e krijuar, Sistemi Urban sipas planit kombëtar propozon:

- Hierarkizimin e qendrave
- Profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomikë të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.
- Rajonizimin, ose bazat për zhvillim rajonal i shprehur në bashkimin funksional të qendrave urbane primare dhe të specializuara.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, në varësi të statusit aktual dhe të propozuar të qendrave urbane, me qëllim sigurimin e zhvillimit të territorit në përputhje me Vizionin e planit, propozon ndërhyrje konsoliduese, përforcuese, rigjeneruese, kooperuese dhe fuqizuese për qendrat urbane. Plani kombëtar për sistemin urban propozon:

- Zhvillim hapësinor policentrik dhe një marrëdhënie të rë urbane - rurale;
- Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara, duke promovuar densifikimin në vend të shperhapjes urbane;
- Akses më të mirë në një infrastrukturë multimodale, e cila është jo vetëm më e efektshme, por edhe miqësore ndaj mjedisit;
- Funksione mikse dhe komplementare;
- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në vecanti i ujit, energjisë dhe mbetjeve;
- Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të ketyre aseteve në jetën urbane.

Politika që udhëheq strukturën e propozuar të sistemit urban është krijimi dhe forcimi i qyteteve dinamike, tërheqës dhe konkurrues në rajone të urbanizuara.

Qyteti i Vaut të Dejës përcaktohet në PPK si qendër urbane terciare. Këto qendra përmbajnë funksione dhe shërbime bazë si psh.:

- Funksionet ekonomike dhe të vendbanimeve,
- Funksionet e tregtisë me pakicë,
- Funksionet kulturore dhe të rekreacionit,
- Funksionet administrative,
- Funksionet arsimore shkolla të mesme, shkolla profesionale,
- Funksionet shëndetësore dhe të perkujdesjes sociale.

Gjithë qendrat e tjera urbane të bashkisë bëjnë pjesë në kategorinë Lokalitete.

Lokalitete janë konsideruar qendra të vogla të banuara me karakter rural. Në përgjithësi lokalitetet janë fshatra, të cilat janë pjesa më e vogël e organizimit territorial.




Fig. 3 Sistemi urban

Objektivat specifike:

- Nxitja e rikuperimit dhe rivitalizimit të qendrës historike të qytetit të Vau-Dejës si dhe qendrave të vogla urbane apo monumenteve historike, nëpërmjet përdorimit turistik.
- Fuqizimi i aktiviteteve akomoduese dhe shërbimeve plotësuese për turizmin kulturor, mjedisor, sportiv (aktiv), ujqor, në zonat urbane të Vau-Dejës, pranë fshatrave Nënshat, Vig, Koman, në zonën me interes natyror, peizazhistik dhe mjedisor të luginës së Drinit, si dhe në fshatrat e zonave të thella malore.
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kategorive të urbanizimit kryesor (rrjetet kryesore) në zonat urbane dhe në vendbanimet informale të legalizuara
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pajisjes me shërbime urbane dytësore (arsim, struktura publike, gjelbërim dhe parkim) në zonat urbane kryesore
- Zhvillimi i shërbimeve të reja urbane në Vau-Dejës, Mjedë, Bushat, Rranxë, Barbullush, dhe Hajmel dhe lokalitetet e tjera të mëdha urbane (qendra formimi dhe aftësimi, biblioteka dhe mediateka lokale).
- Zhvillimi i sistemeve me lëvizje urbane alternative (pista biçikletash, rrjete pedonale) të integruara me sistemin e transportit publik automobilistik dhe hekurudhor
- Racionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të rrugëve automobilistike, të integruar me sistemin e parkimeve urbane dhe territoriale.

- Rimëkëmbja dhe ripërdorimi, si një korridor transporti me lëvizje të shpejtë, i linjës ekzistuese hekurudhore, në përputhje me rimëkëmbjen e saj si një infrastrukturë e rëndësishme kombëtare; rehabilitim ky, i parashikuar edhe në PPK.
- Nxitja e qasjes, përdorimit dhe shkëmbimit të resurseve urbane të përbashkëta (Urban Commons) për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i qyteteve dhe të mirave të përbashkëta të aksesueshme, të sigurta dhe që arrijnë drejtpërdrejtë të fëmijët (Qyteti mik i fëmijëve).

Përcaktimi i njësive pjesë e sistemit urban është bërë kryesisht mbi bazën e kufijve historikë të zonave të urbanizuara, si dhe bazuar në Vendimin e KKT-së, Nr 5, Datë 29.12.2014, mbi zonat e urbanizuara në Shqipëri. Duke ndjekur direktivat e PPK dhe PINS të bregdetit, qëllimi ka qene që të mbrohet toka bujqësore dhe natyrore duke konsoliduar qendrat ekzistuese.

Sistemi territorial urban zë sot një përqindje të rëndësishme të sipërfaqes së përgjithshme të territorit. Ndërtimet janë shpërhapur në mënyrë të parregullt, me mjaft probleme në planifikimin urban dhe infrastrukturën sociale. Ndërhryrjet synojnë përmirësimin estetik dhe funksional të territorit urban, modernizimin e infrastrukturës teknike e sociale dhe rigjenerimin ekonomik.

Ndërhryrjet kryesore në këtë sistem planifikohen të jenë në:

- Përmirësim i hapësirës urbane, zgjerim i rrjetit rrugor dhe aksesit në infrastrukturë
- Përmirësimi i shërbimeve bazë sociale dhe administrative
- Shtimi i fondit të ndërtimit për shkak të rritjes së popullsisë, përmirësimi të kushteve të banimit, zëvendësimit të ndërtesave të degraduara nga koha dhe zhvendosje e popullsisë prej zonave të rrezikshme apo të degraduara.
- Adresimi i nevojave për banesa sociale

2.1.2 Sistemi Bujqësor (B)

Sistemi bujqësor (B) përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”.

Objektivi kryesor: Efiçencë për një sektor bujqësor konkurrues

Politika: Ruajtje, konsolidim, modernizim.

Politika të tjera lidhen me:

Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - tregtim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.

Ulja e kostos dhe rritja e cilësisë nëpërmjet investimeve në:

- teknologjinë e prodhimit për modernizimin e saj;
- investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale vaditëse – kulluese, etj.

Integrim dhe bashkëpunim me sektorët e tjerë të ekonomisë:

- Bujqësi - turizëm, ku veçantia e sektorit turistik shqiptar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.
- Bujqësi - transport, ku infrastruktura e transportit i shërben rritjes së efciences së rrjetit bujqësor në grumbullimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.
- Bujqësi - energji, ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.

Krijimi i qendrave/poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit bazuar në traditën e kultivimit të kulturave vendore.

Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqiptarë.

- Bimë Mjekësore
- Pemë frutore arrore
- Ullinj dhe Vreshta
- Perime karakteristike të vendit
- Produkteve bujqësore të përpunuara

Plani i Përgjithshëm Vendor do të bazojë ndarjen e territorit të Sistemit bujqësor sipas këtyre objektivave:

- Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore, me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban. “Asnjë ndërtim i ri në tokë bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor”.
- Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim – grumbullim – përpunim - eksportim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.
- Krijimi i *qendrave të specializuara* bujqësore dhe profilizimi i tyre sipas karakteristikave të prodhimit lokal.
- Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike të zonës.




Fig. 4 Sistemi bujqësor

Objektivat specifike:

- Promovimi dhe zhvillimi i modernizimit dhe inovacionit në sektorin e industrive vendase dhe në sektorin e integrit të zinxhirëve të strukturave të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit.
- Promovimi dhe zhvillimi i prodhimit cilësor në sektorin bujqësor, blegtoral dhe pyjor (produktet e Zadrimës).
- Përmirësimi i aftësive sipërmarrëse dhe profesionale të punëtorëve në sektorin e bujqësor dhe pyjor.
- Promovimi i metodave të kultivimit biologjik dhe të permakulturës.
- Konvertimi për përdorim bujqësor, i zonave të degraduara dhe të braktisura.
- Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral pyjor në zonat kodrinore, në lugina dhe zonat malore të brendshme, të kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore (çaj mali etj.), të eterovajorëve, të kultivimit të peshkut, si dhe të bletarisë.
- Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral, në zonat fushore e bujqësore blegtorale, në zonat kodrinore dhe ato malore.
- Riorganizimi dhe zhvillimi i strukturave mbështetëse për aktivitetin bujqësor, të tilla si shoqëritë (konsorciumet) bujqësore për shërbim dhe trajnime, për fermat e vogla dhe të mesme.
- Rivendosja në punë e rrjetit të kanaleve të vaditjes e kullimit të tokave bujqësore, gjë e cila do shërbejë edhe si një masë mbrojtëse nga përmytjet.

- Zhvillimi i ndërtimit të objekteve të logjistikës për mbledhjen, ruajtjen, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore vendore, mbi bazë të konsorciumit dhe/ose kooperativës.
- Promovimi i krijimit të qendrave të kërkimit dhe trajnimit në agrobiznes dhe edukimit në mirë ushqimin, madje edhe në shkolla dhe fushën e arsimit (shkolla profesionale Bushat).
- Promovimi i ngritjes e shpërndarjes territoriale të strukturave akomoduese (struktura agro-turizmi, B&B ekologjike, ferma didaktike, fshatra ekologjike) dhe të restoranteve cilësorë që valorizojnë produktet dhe traditat ushqimore vendase, si dhe peshkimin dhe kultivimin e peshkut.

Për të garantuar mbrojtjen e tokës bujqësore, në territorin e bashkisë janë përcaktuar një numër i konsiderueshëm njësish, të cilat kanë si përdorim parësor bujqësinë. Vlen të përmendet se këto njësi nuk janë të vetmet njësi në të cilat ka prezencë të tokës bujqësore. Toka bujqësore është pjesë edhe e njësive të tjera të përcaktuara si pjesë e Sistemit Urban, por në këto njësi janë përcaktuar kritere të forta për ta ruajtur atë, kurse në njësitë tashmë pjesë e Sistemit Urban, ajo do të jetë subjekt i ndryshimeve në kohë dhe zhvillimit. Gjithsesi kjo kategori është në vlera relativisht të ulëta.

Lidhur me shpërndarjen aktuale të territorit të Bashkisë në pesë sistemet një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes së territorit mbulohet nga toka bujqësore dhe e kultivuar. Toka bujqësore shtrihet përgjithësisht në perëndim, në fushat e Zadrimës dhe është një burim i rëndësishëm ekonomik për zonën. Një prioritet kryesor i studimit është mbrojtja maksimale e tokës bujqësore dhe menaxhimi i qëndrueshëm i saj.

2.1.3 Sistemi Natyror (N)

Sistemi natyror (N) përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit “natyrë”.

Objektivi kryesor: Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit natyror.

Politika: Rritje e zonave të mbrojtura natyrore, promovimi dhe aksesimi i tyre.

Objektivi kryesor i PPV synohet të arrihet nepermjet politikave të mëposhtme:

- Rritja e përgjegjesise kombëtare e ndërkombëtare për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, duke kombinuar konceptet e qëndrueshmërisë dhe administrimit të mirë;
- Mbrojtja dhe rritja e zonave të mbrojtura natyrore; krijimi i një sistemi të qëndrueshëm e komunikativ mjedisor;
- Rritja e rolit të mjedisit në zhvillimin ekonomik të vendit; integrimi i sistemit natyror në vlerën ekonomike të sektorëve të zhvillimit;
- Rritja e rolit të mjedisit në cilesine e jetës urbane përmes promovimit dhe krijimit të aksesit të përshtatshëm ndaj zonave natyrore.

Targeti për 2030 i PPV-së do të synojë shtimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura 20 % për tokën dhe 12-15 % të sipërfaqes ujore. Ruajtja dhe shtimi i zonave të mbrojtura natyrore do të bëhet nëpërmjet:

- Vendosjes së prioritetit të përdorimit të zonave të lira natyrore, me përparësi mjedisin.
- Krijimi dhe konsolidimi i korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave lumore, të cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme të sistemit të zonave të mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor.
- Zonat me rrezikshmëri natyrore ndaj njeriut si rrjedhim i erozionit, nivelit të lartë sizmik, prezencës së materialeve të dëmshme për shëndetin, etj.
- Zonat e degraduara prej aktiviteti njerëzor, si punime minerare, depozitim mbeturinash, shfrytëzim i pa kriter i burimeve natyrore, etj. Të vendosen objektiva kohorë për rikthimin e këtyre zonave në gjendjen e mëparshme.

Udhëzimet për territoret sipas karakteristikave urbane jepen në vijim.

Në lokalitete (kooperim dhe përforsim):

- Zhvillimi urban duhet inkurajuar brenda zonave të urbanizuara që shfrytëzojnë infrastrukturen ekzistuese të ndërtuar;
- Toka me karakteristika të mira pjellore, por që nuk mund të përdoren më për bujqësi duhet të pyllëzohen aty ku është e mundur. Kjo do të rriste mundësitë ekonomike të zonës për shfrytëzim të lëndës drusore ose për përmirësim të peizazhit natyror dhe rritjen e atraksioneve turistike;
- Në tokat me karakteristika jo të mira bujqësore inkurajohet përdorimi i tyre për parqe fotovoltaike apo eolike sidomos për zonat pranë stacioneve dhe rrjetit ekzistues elektrik;
- Në tokat me shfrytëzim intensiv të bujqësisë rekomandohet ripërdorimi i mbetjeve bujqësore për gjenerimin e energjisë elektrike. Kjo do të mundësonte zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe mbrojtjen e cilësive të rrjedhave ujore nga shpërhapja e mbetjeve bujqësore;
- Promovimi i rrjedhave ujore për sportet dhe aktivitetet ujore.

Në qendrat urbane terciare (konsolidim dhe fuqizim):

- Parandalimi i shpërhapjes urbane;
- Ndalimi ku është e mundur dhe reduktimi i humbjes së tokës bujqësore dhe tokës së lire natyrore për shkak të përdorimit urban;
- Mbrojtja e karakteristikave të peizazhit rural dhe minimizimi i fragmentimit të tij, duke ruajtur sa më qartë diferencat karakteristike midis peizazhit urban dhe atij rural;
- Krijimi i infrastruktureve të gjelbra për qytetet, që do t'i mundësojnë banorëve akses në zonat natyrore dhe në aktivitetet rekreative që do të zhvillohen në to;
- Ruajtja dhe aty ku është e mundur shtimi i zonave të mbrojtura mjedisore dhe biodiversitetit në to;

- Mbrojtja e objekteve dhe strukturave ndërtimore me vlera karakteristike të peizazhit të traditës historike e kulturore.

Në qendrat urbane terciare (rigjenerim):

- Mjedisitë si produkt turistik që tërheq vizitorët nga cilësia e peizazhit natyror, historiko - kulturor dhe biodiversitetit, si edhe nga një gamë e gjerë mundësish për zhvillimin e aktiviteteve natyrore;
- Tërheqja e sipërmarrjeve dhe njerëzve që karakterizohen nga aftësi dhe një spektër i gjerë ekspertize teknike dhe intelektuale, për të cilët jetesa në qytete të vogla ku garantohet cilësia mjedisore, i mundëson atyre cilësinë e jetës që ata kërkojnë;
- Zhvillimi i avancuar i infrastruktures së komunikimit, e cila mund të sigurojë zgjerimin e shkallës së aktiviteteve ekonomike si dhe të sipërmarrjeve të vendosura në një vend të caktuar.

Përqasja e PPK për këtë sistem shprehet nëpërmjet dy koncepteve: Promovim dhe Akses. Në këtë kuader disa nga propozimet janë:

- Rritje të zonave natyrore nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura dhe korridoreve lidhëse natyrore përgjatë luginave të lumenjve;
- Shtimi i tri parqeve kombëtare në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura:
 - Parku i Bunës
 - Parku i Alpeve
 - Parku i Vjosës

Gjithashtu, propozohet që në rrjetin e zonave të mbrojtura të shtohet edhe rrjeti Emerald.

- Krijimi i hapësirave rekreative dhe atraksioneve natyrore përgjatë luginave të lumenjve;
- Futja e rrjetit kombëtar të bicikletave, i cili akseson dhe pershkron zonat natyrore dhe ato të trashëgimise historike e kulturore;
- Projekte ripyllëzimi dhe rigjenerimi në zonat e degraduara nga dukuri natyrore si erozioni dhe përmytjet, por edhe nga aktivitetit njerezor.

Objektivat specifike:

- Mbrojtja dhe zgjerimi i biodiversitetit të territorit.
- Lidhja e Parkut Kombëtar të Alpeve me Peizazhin e Mbrojtur Bunë-Velipojë, nëpërmjet luginës së Drinit duke krijuar një korridor të lundrueshëm, natyror e peizazhistik mal-det.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të vendbanimeve ekzistuese urbane brenda dhe përreth zonave natyrore të mbrojtura.
- Zvogëlimi progresiv dhe zhdukja e niveleve aktuale të ndotjes së lumenjve / liqeneve, në harkun kohor të të dy dekadave.
- Rritja e zonave pyjore në zonat kodrinore e malore.
- Promovimi i turizmit natyror, lundrimit dhe të ekskursionit.

- Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjetit ekologjik territorial, si një lidhje strukturore midis zonave me vlerë dhe pasuri të madhe të biodiversitetit.
- Promovimi dhe përgatitja e instrumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të zonave me interes mjedisor.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të zonave dhe objekteve industriale dhe të minierave ekzistuese brenda dhe përfaqë zonave urbane.
- Bashkimi dhe homogjenizimi i sistemeve të mbrojtjes mjedisore, që shpeshherë rezultojnë të mbivendosura dhe të vështira për tu kuptuar dhe zbatuar.




Fig. 5 Sistemi natyror

Propozohen ndryshime të kufizuara në sistemin natyror. Sipërfaqet natyrore kanë shtrirje të gjerë në Bashkinë Vau-Dejës, pjesa më e madhe shtrihet në lindje dhe verilindje, në pjesën malore, me dendësi banimi të ulët e sipërfaqe të mëdha pyjore.

Sistemi natyror është propozuar të shtohet me Parkun Natyror Rajonal të luginës së Drinit me sipërfaqe prej rreth 10 000 Ha. Ky park do të mundësojë krijimin e një korridori të vazhduar peizazhistik, mjedisor e turistik nga Alpet në Adriatik. Rregullorja e posaçme e kësaj zone do të jetë subjekt i procesit ligjor që do vijojë për të mundësuar marrjen e statusit të plotë të Parkut Rajonal për këto dy teritore.

2.1.4 Sistemi Ujor (U)

Sistemi ujor (U) është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë”.

Rekomandimet e PPK për këtë sistem fokusohen në:

- Shfrytëzim racional i ujërave duke ruajtur balancën e abstragim/rimbushje të akuifereve;
- Kontrolli i aktiviteteve të paligjshme;
- Investime në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive mbi burimet ujore dhe në veçanti të shtresave gjeologjike dhe kufijve të akuifereve;
- Shfrytëzim i qëndrueshem i ujërave nëntokësore, duke përfshirë këtu edhe shpimet e pakontrolluara;
- Ruajtja e ujëmbledhësve nga precipitime të shirave për përdorim bujqësor.
- Eliminimi i ndotjeve të ujit nga burime të ndryshme.

Plani i Përgjithshëm Vendor për Sistemin Ujor orienton drejt këtyre objektivave:

- Prioritet maksimal mbrojtjes së burime hidroenergjetike të zonës.
- Përcaktimin e vijës blu, të mbrojtjes së sipërfaqeve hidrike dhe fashat mbrojtëse të kërkuar nga ligji.
- Evidentimi i zonave të rrezikshme për njeriun si rezultat i përmytjeve, ose që janë në rrëgjim kënetor
- Përcaktimi i zonave të përshtatshme për zhvillim turistik ujor
- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin e peshkimit dhe infrastrukturës së nevojshme.

Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Politikat primare të PPK për sistemin ujor janë:

Politikat e densifikimit të zhvillimit urban dhe korridoret natyrore përgjate luginave të lumenjve.

Në mbrojtje të Sistemit Ujor, PPK vendos:

VIJËN BLU e cila ka për qëllim:

- Per rrjedhat lumore, rigjenerimi i korridoreve natyrore që shoqerojnë rrjedhen e tyre.
- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror të territorit që shtrihet nga vija bregdetare deri në kreshten e brezit të pare kodrinor malor.
- Të mbrojë resurset ujore nga përdorimi i papërshtatshëm si

Shfrytëzim intensiv i inerteve të lumit,

Vend-depozitime të mbetjeve urbane

Aktivitet bujqësor e industrial i konsiderueshëm.

Korridoret e gjelbra

Integrimi i luginave të lumenjve është menduar të realizohet nëpërmjet burimeve të tjera natyrore, në mënyrë që të kryhet vlerësimi i lumenjve me pamje të mirë peizazhistike, duke i cilësuar ato si korridore të gjelbra që mundësojnë lidhjen e vendeve të ndryshme me njëri-tjetrin; lidhjen e vlerave natyrore, kulturore, liqenet, monumente historike, vendbanime me vlera arkitektonike, fshatra historikë, lagunat, plazhet, etj., duke filluar nga vija bregdetare deri në pjesën e brendshme malore të territorit.

Pra luginat e lumenjve, do të shërbejnë si:

- Korridoret e gjelbër do të kenë funksionin e zonave bllokuese për kufizimin e shtrirjes urbane dhe gjithashtu të krijojnë mundësinë për përdorime rekreative të hapësirave publike.
- Këto “kanale natyrore”, do të përdoren për lëvizjen e turistëve nga një zonë e mbrojtur, në tjetrën.
- Si zona të përshtatshme për ecje, çiklizëm apo sport.

PPV duhet të përcaktojë gjithashtu edhe zonat me rreziqe mjedisore, për këto territore; si rrëshqitjet, erozioni, zonat e rrezikuara nga përmytjet në vijën bregdetare. Gjithashtu, ato duhet të përcaktojë parametrat e ndërtimeve të reja, në afërsi të këtyre korridoreve, për rastet që aty pranë mund të ketë lokalitete të zhvilluara, në mënyrë që të parandalohen dëmet që këto ndërtime mund të shkaktojnë.




Fig. 6 Sistemi ujq

Objektivat specifike:

- Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve dhe rezervave natyrore hidrologjike.
- Rigjenerimi i trupave ujqorë kryesore, në të mirë të ekosistemeve lokale dhe të një zhvillimi të mundshëm të turizmit sportiv.
- Zhvillimi i lundrimit (transportit), të turizmit sportiv dhe peshkimit.
- Modernizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjeteve të shpërndarjes lokale.
- Ruajtja, modernizimi dhe rritja e kapacitetit prodhues të hidrocentraleve.
- Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe shpërndarjes së ujit publik, i parë si një nga të mirat/resurset e përgjithshme.
- Krijimi i një Autoriteti Publik Menaxhimi të burimeve ujqore, në njohjen e zonave homogjene territoriale, si një mjet kontrolli dhe menaxhimi të cilësisë.

Dy elementët më të rëndësishëm në kuadrin e Sistemi Ujq janë mbrojtja nga ndotjet dhe dëmtimi i brigjeve nga erozioni, apo dora e njeriut. Nga ana tjetër, mbrojtja e brigjeve lumore është e lidhur ngushtësisht me problemin e përmbytjeve dhe dëmtimit të pasurisë e jetës së banorëve. Rezerva ujqore është nën presion të rëndë nga aktivitetet e njeriut dhe duhet të ruhet në kuadrin e menaxhimi të integruar, racionalizimit të konsumit dhe kursimit të rezervës ekzistuese.

Element që është e vështirë të përcaktohet qartë në gjendjen ekzistuese është zona baferike e Sistemit Ujq, e cila është e qartë në përkufizim, por nuk reflektohet në realitet. Përcaktimi i saktë

i këtij territori, tashme me njësi, sipërfaqe e rregullore të përcaktuar, është në parim ndryshimi i vetëm që i bëhet përcaktimit të kufijve të Sistemit Ujor.

Integrimi i luginave të lumenjve është menduar të realizohet duke i cilësuar ato si korridore të gjelbra që mundësojnë komunikimin e zonave të ndryshme; këto lugina lidhin territoret e vlerave natyrore, kulturore, liqenet, monumentet historike, vendbanimet me vlera arkitektonike, fshatrat historikë, lagunat, plazhet, etj, duke filluar nga zonat malore në thellësi të territorit dhe duke zbritur deri në bregdet (jashtë territorit të bashkisë).

2.1.5 Sistemi i Infrastrukturës (IN)

Sistemi infrastrukturor (IN) përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”.

Objektivi kryesor: Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmerisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar të flukseve.

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një Sistemi të integruar multimodal mbarë kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Me formulimin e kërkesave të aksesueshmerisë për qendrat kryesore dhe sekondare duhet të garantohet roli qendror i tyre dhe të sigurohet cilësia e qendrave prioritare si pika spirancë në hapësirën dhe mobilitetin e njerëzve për sa i përket ofrimit të shërbimeve publike. Më tej, hierarkizimi i rolit të këtyre qendrave, kërkon vendosjen e prioriteteve lidhur me sigurimin, zgjerimin, dhe sipas rastit ngritjen e rrjeteve dhe korridoreve të reja infrastrukturore dhe mirëfunksionimin e tyre.

Politikat e propozuara lidhen me organizimin e territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

Për transportin objektivi principal është zhvillimi i tipit multimodale dhe miqësor ndaj ambientit.

Objektivat e tjera të PPV-së së në lidhje me sistemin infrastrukturor janë:

- Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave urbane.
- Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave prioritare, si qendra që ofrojnë shërbime publike të specializuara e të avancuara.
- Promovimi i transportit publik si dhe transportit alternativ nëpërmjet infrastrukturës së butë, rrugë për biçikleta dhe këmbësorë.
- Rinovimi i hekurudhave ekzistuese.
- Klasifikimi i rrjetit rrugor ekzistues dhe të parashikuar në:
 - rrjet të kategorisë I
 - rrjet të kategorisë II

- rrjet të kategorisë III
- Përcaktimi i “Vijës së kuqe” ose vijës së ndërtimit të rrugës për çdo tip rrjeti dhe korridori të përfshirë në Sistem. Vija e kuqe është kufiri i lejuar për vendosjen e një ndërtimi në anët e trupit të rrugës që i referohet ose vija kufizuese e të gjithë brezave mbrojtës, si p.sh., brezat mbrojtës të përcaktuar nga Kodi Rrugor, të zonave të mbrojtura nga legjislacioni i mjedisit, kulturës, energjisë etj., si edhe breza mbrojtës të përcaktuar nga dokumentet e planifikimit.

Transporti ujor

Në bregdetin e Republikës së Shqipërisë ndodhen dhe gjashtë porte detare, katër prej të cilave shërbejnë për transportin e pasagjerëve dhe të mallrave dhe administrohen nga shteti ndërsa dy portet tjera janë dhënë me koncesion për transportin e hidrokarbureve dhe konkretisht;

Porti i Shëngjinit është Porti detar më verior i Republikës së Shqipërisë dhe më i rëndësishmi për bashkinë Vau-Dejës. Përveç përpunimit të mallrave dhe transportit të udhëtarëve ky port shërben edhe për anijet e peshkimit.

Gjithashtu, territori i bashkisë përshkohet nga një rrjet ujor i lundrueshëm që mund të shërbejë në zhvillimin e këtij transporti dhe në ndërlidhje më të fortë të qndrave të banuara që ndodhen pranë tij. Ky rrjet mund të jetë promotor i zhvillimit turistik dhe si i tillë përbën një nga asetet kryesore të territorit.

Objektivat specifike:

- Garantimi i efikasitetit dhe funksionimit të plotë të rrjetit infrastrukturor me karakter kombëtar (korridorit kombëtar) nëpërmjet ndarjes së trafikut lokal, realizimit të kryqëzimeve të rrafshëta dhe mbikalimeve të rrjeteve lokale, transformimi progresiv në autostradë.
- Zhvillimi i polit të lëvizjes plurimodale dhe ndërlidhjes Mjedë – Vau-Dejës (hekurudhë, rrugë automobilistike, lundrim, korsi biçikletash, shtigje këmbësore)
- Krijimi i një rrjeti transporti ujor publik dhe funksional
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i rrjetit hekurudhor kombëtar, për lidhje ndërkombëtare si dhe për përdorim urban dhe lokal.
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i stacioneve hekurudhore, si pikat aksesit dhe shërbimi të qendrave të banuara, dhe si pika të lidhjes me rrjetin e korridoreve të gjelbër, të cilët realizojnë ndërveprimin ndërmjet zonës bregdetare dhe asaj malore.
- Krijimi i një qendre logjistike strategjike, e lidhur me hekurudhën dhe korridorin infrastrukturor.
- Zhvillimi dhe konsolidimi i rrjetit të parkimit në nivel territorial, urban dhe lokal.
- Zhvillimi i një rrjeti rrugor me lëvizshmëri të ngadaltë, të lidhur me rizbulimin e vendeve dhe peizazheve me interes natyror, kulturor dhe arkeologjik, etno-antropologjik, agroushqimor cilësor (rrugët e vajit, verës, prodhimeve lokale)

- Zgjerimi dhe përmirësimi sistemeve aktuale operative dhe menaxhimi i ciklit të mbeturinave të ngurta urbane.
- Fuqizimi i rrjeteve urbane teknike, në veçanti rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.
- Kontrolli dhe nxitja për kursimin e energjisë dhe për rikuperimin/ ripërdorimin/ riciklimin e mbetjeve të ngurta komunale dhe menaxhimin e pikave të grumbullimit.
- Forcimi dhe zhvillimi i rrjeteve të telekomunikacionit dhe jo-materiale, si në nivel territorial (rrjetet satelitore), ashtu edhe në nivel urban (rrjeti wireless), të instaluar në qendrat kryesore.
- Zhvillimi dhe fuqizimi i rrjetit të infrastrukturës energjetike, me vëmendje ndaj ndikimeve të shkaktuara (ndotja elektromagnetike) dhe zhvillimi i burimeve të rinovueshme energjetike.
- Zhvillimi i sistemeve të prodhimit energjetik nga burime të rinovueshme në fushën urbane dhe në mbështetje të impianteve industriale ekzistuese dhe të aktiviteteve ekonomike kryesore urbane.




Fig. 7 Sistemi i infrastrukturës

Sistemi infrastrukturor si tërësi më vete është një koncept relativisht i ri në planifikim. Njëkohësisht është e vështirë të thuash saktë sa është vlera e sipërfaqes së këtij sistemi aktualisht, në mungesë të zonave buferike reale dhe ruajtjes së distancave. Po kështu duhet theksuar, se pozicionet e sakta, format e ndërhyrjes dhe volumet reale të veprave teknike do të përcaktohen nga studime të veçanta.

2.2 ZONIMI SIPAS PERDORIMIT TE TOKES

2.2.1 Kategoritë Bazë të përdorimit të tokës

Në përputhje me VKM 671/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", kategoritë bazë të përdorimit të tokës janë:

- Banim (A): përfshin zona dhe objekte ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit, edhe në rast se janë të klasifikuara nga legjislacioni për monumentet e kulturës ose të tilla që janë në funksion të banimit
- Industri dhe Ekonomi (IE): përfshihen të gjitha llojet e industrive sipas legjislacionit të posaçëm, nxjerrje dhe përpunim mineralesh e materialesh ndërtimi, parqe industriale dhe logjistike, inkubatorë biznesi dhe të përziera industriale dhe ekonomike për sa kohë që qëllimi kryesor i funksionit të tyre nuk janë shërbimet dhe aktivitete ekonomike bujqësore
- Bujqësi (B): territor dhe struktura për qëllim bujqësor sipas legjislacionit të posaçëm, përfshirë aktivitetet ndihmëse dhe në funksion të drejtpërdrejtë të bujqësisë, përveç banesave dhe rrugëve
- Shërbime (S): territore dhe struktura për shërbime tregtare, zyra dhe qendra biznesi
- Përdorim i veçantë (V): varrezat dhe çdo territor apo strukturë që nuk përfshihet në kategoritë e tjera bazë
- Ujëra (U): të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ujërat
- Toka natyrore (N): sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme
- Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike (M): sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm, përveç atyre që banohen
- Zona ushtarake (ZU): territore dhe objekte të klasifikuara si të tilla në territor apo në legjislacionin e posaçëm
- Institucione (IS): administrata dhe struktura shtetërore, pavarësisht nivelit, të sistemit gjyqësor, bankat, mediat, institucione të mbrojtjes civile dhe kombëtare veç atyre që përfshihen në kategoritë e tjera, të shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit social, të shoqërisë civile, sistemi i burgjeve dhe institucione fetare
- Aktivitete sociale dhe rekreative (AR): aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, përfshirë ato sportive , sipas legjislacionit të posaçëm
- Arsim (AS): sipas legjislacionit të posaçëm
- Shëndetësi (SH): sipas legjislacionit të posaçëm
- Infrastruktura (IN): të gjitha pjesët e infrastrukturave për transportin, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftën dhe gazin, biokarburantet, komunikimin elektronik, furnizimin me energji elektrike, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rrëshqitja dhe mbrojtjen kundër zjarrit, sipas legjislacionit të posaçëm

2.2.2 Nënkatëgoritë e përdorimit të tokës

Në vijim të kategorizimit të përdorimit të tokës, janë përdorur nënkategoritë në vijim për të përcaktuar llojin dhe karakterin e zhvillimit.

Për kategorinë e përdorimit “Banim”

Me qëllim ndihmesën në përcaktimin korrekt të kushteve të zhvillimit, kategoria e përdorimit banim, sipas rastit, mund të ndahet në nënkategoritë vijuese

- A.1** Territore me banim ekzistues
- A.2** Zgjerim banimi, pjesërisht e zënë me ndërtime ekzistuese
- A.3** Banim me densitet të ulët, banesa të veçuara
- A.4** Banim me densitet të mesëm, banesa të veçuara dhe të bashkëngjitura
- A.5** Banim me densitet të lartë, banesa shumëfamiljare

Për kategorinë e përdorimit “Aktivitete sociale dhe Rekreative”

Kategoria e përdorimit “aktivitete sociale dhe rekreative”, sipas rastit, mund të ndahet në nënkategoritë vijuese:

- AR.1** Hapësira publike të hapura ose gjysmë të hapura, artificiale ose natyrore, sheshe publike jo për qëllime trafiku, elementë ujorë dhe hapësirat mbështetëse
- AR.2** Ndërtime dhe territore të përshtatura për aktivitete sportive dhe argëtimi
- AR.3** Parqe urbane dhe natyrore, qendrore dhe periferike, botanike ose zoologjike
- AR.4** Të tjera

Për kategorinë e përdorimit “ArSim”

Kategoria e përdorimit “arsim”, sipas rastit, mund të ndahet në nënkategoritë vijuese:

- AS.1** Çerdhe dhe kopshte;
- AS.2** Shkolla fillore dhe 9-vjeçare;
- AS.3** Shkolla të mesme - të përgjithshme dhe profesionale;
- AS.4** Konvikte dhe ndërtime të tjera në ndihmë të arsimit;
- AS.5** Universitete

Për kategorinë e përdorimit “Bujqësi”

Përdorimi i tokës dhe i ndërtimeve në të për bujqësi mund të përfshijë zhvillime ekzistuese në momentin e hartimit të PPV-së, me intensitet shumë të ulët për qëllime banimi, për sa kohë që banimi është funksion mbështetës i kategorisë së përdorimit bujqësi, që u përket njësive përkatëse. Infrastruktura e kullimit dhe vaditjes së tokave. Toka të kultivuara, të pakultivuara apo

të lëna djerrë. Ndërtime dhe territore të dedikuara për aktivitete mbështetëse për bujqësinë, blegtorinë, strehim kafshësh, etj.

Nënkategoritë e përdorimit “Bujqësi” janë:

- B.1** Zona bujqësore të kultivuara;
- B.2** Zona bujqësore të lëna djerrë, pavarësisht nga boniteti i tokës;
- B.3** Zona bujqësore që pavarësisht nga boniteti i tokës dhe statusi i kultivimit dhe/ose kultura përkatëse, janë zona nën përmbytje;
Ndërtime dhe territore të dedikuara për aktivitete mbështetëse për bujqësinë edhe blegtorinë, si ndërtime të përkohshme dhe të përhershme dhe/ose të lehta magazinimi, përpunim produktesh bujqësore, strehim për kafshët dhe të tjera të kësaj natyre, të lejuara dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi;
- B.4**
- B.5** Infrastruktura e kullimit dhe vaditjes së tokave bujqësore, përfshirë rezervuarët artificiale dhe rezervuarët e produkteve të akuakulturës;
- B.6** Zona bujqësore me zhvillime ekzistuese banimi, me intensitet shumë të ulët;

Rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit të posaçëm në fuqi për tokën bujqësore, për turizmin, për kullotat dhe livadhet, për menaxhimin e rezervave ujore dhe për mjedisin

Për kategorinë e përdorimit “Industri dhe Ekonomi”

Të gjitha tipat e aktiviteteve ekonomike, ekspozita, tregje, magazina, industri e lehtë ushqimore, industri përpunuese ose montimi, fabrika, etj. Nënkategoritë e këtij përdorimi janë:

- IE.1** Parqe industriale, ndërtime dhe territore posaçërisht për industrinë e lehtë, përpunuese ushqimore dhe parqe logjistike;
- IE.2** Zona të përziera industriale dhe tregtare ;
- IE.3** Zona për nxjerrje dhe përpunim materialeve ndërtimi;
- IE.4** Parqe industriale, ndërtime dhe territore posaçërisht për industrinë e rëndë, përpunuese e kimike dhe depozitim karburantesh.
- IE.5** Zona për nxjerrje dhe përpunim mineraleve

Një numër i madh biznesesh dhe aktiviteteve me natyrë ekonomike-industriale shtrihen përgjatë infrastrukturës rrugore ekzistuese. Mospërkrahja e standardeve të infrastrukturës (kryesisht hyrje-daljet) është kusht i kësaj rregulloreje dhe do të trajtohet me kujdes në Kreun “Rregulla për Infrastrukturën”.

Për kategorinë e përdorimit “Infrastruktura”

Kategoria e përdorimit “infrastrukturë”, sipas rastit, mund të ndahet në nënkategoritë vijuese.

- IN.1** Infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore;
- IN.2** Stacione të transportit rrugor dhe hekurudhor;
- IN.3** Ujësjellës-kanalizime. Ndërtime ndihmëse dhe stacionet e tyre të posaçme;
- IN.4** Linjat e furnizimit me energji elektrike dhe stacione elektrike;
- IN.5** Vend-depozitime të mbetjeve të ngurta dhe të lëngëta;
- IN.6** Linja të tjera infrastrukturore, sipas legjislacionit të posaçëm.

Për kategorinë e përdorimit “Natyrë”

Natyra është gjerësisht e pranishme në territorin e Bashkisë. Nga pikëvështrimi peizazhistik sistemi natyror ndihmon në krijimin e sekuencave më të pasura dhe të larmishme të peizazhit gjatë rrugëtimit nëpër territoret pranëbregdetare dhe kodrinore-malore të bashkisë. Agrikultura duhet parë gjithnjë e më tepër si një ndërthurje e sistemit bujqësor dhe natyror.

Nënkategoritë e përdorimit Natyrë janë.

- N.1** Pyjet dhe burimet pyjore, ekonomia dhe infrastruktura pyjore, fidanishtet pyjore sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm për pyjet dhe shërbimin pyjor.
- N.2** Kullotat dhe livadhet, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi
- N.3** Zonat natyrore të mbrojtura dhe monumentet e natyrës sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi;
- N.4** Tokat e pafrytshme, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi;

Rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit të posaçëm në fuqi për pyjet dhe shërbimin pyjor, për turizmin, për kullotat dhe livadhet, për menaxhimin e rezervave ujore dhe për mjedisin

Për kategorinë e përdorimit “Shërbim”

Përdorimi i tokës dhe i ndërtimeve në të për shërbime, përfshin ato zhvillime të lejuara që bëhen për ofrimin e shërbimeve, infrastrukturave mbështetëse përkatëse, kryesisht për qëllime banimi, por duke përfshirë edhe ndërtimet për qëllime turistike. Nënkategoritë e Shërbimeve janë:

- S.1** Ndërtime dhe territore të përshtatura për zyra, qendër biznesi dhe shërbime tregtare dhe të tjera në shërbim të banimit
- S.2** Ndërtime të përshtatura për zyra, qendër biznesi dhe shërbime tregtare pjesë përbërëse e ndërtimeve që qëllim banimi
- S.3** Hoteleri-turizëm. Të gjitha ndërtimet që janë në shërbim të turizmit;

Për kategorinë e përdorimit “Shëndetësi”

sipas legjislacionit të posaçëm;

- Sh.1** Ndërtime dhe territore spitalore;

Sh.2 Ndërtime dhe territore për qendra shëndetësore, poliklinika, Ambulanca-këshillimore etj.

Sh.3 Ndërtime ndihmëse të infrastrukturës shëndetësore dhe territoret përkatëse

Kategoria e përdorimit “Veçantë”

Nënkategoritë e përdorimit të “veçantë” janë:

- V.1** Ndërtime, instalime dhe territore të përshtatura për infrastrukturë publike, të caktuara për prodhim, mbrojtje, etj, si: Hidrocentrale, Termocentrale, Nënstacione elektrike, etj.;
- V.2** Territore për varreza;
- V.3** Çdo territor apo ndërtim që nuk përfshihet në kategoritë e tjera bazë

2.3 NDARJA E TERRITORIT NE NJESI ZHVILLIMI

2.3.1 Morfologjia urbane

Zona e përcaktuar si urbane nga Vendimi nr.5 i datës 29.12.2014 i Këshillit Kombëtar të Territorit, mund të artikulohet në brendësi, duke njohur lloje të ndryshme morfologjie urbane, të cilat mund të jenë objekt i politikave të përshtatshme të ndërhyrjeve, të diferencuara sipas mjedisit në të cilin ndodhen. Me fjalë të tjera, nga mbivendosja e llojeve të ndryshme të tipologjive urbane me pesë sistemet e përcaktuara, do të jetë i mundur artikulimi, në zonat e ndryshme, i politikave të administrimit të transformimeve.

Bazuar në karakteristikat morfologjike të territorit urban si dhe në peizazhin përkatës, ndërhyrjet kryesore të PPV bazohen në klasifikimin e mëposhtëm:

URB

Njohje e karakterit qendror urban, mundësi për dendësim të ndërtimit, mundësi ndërtimi në hapësirat e përfshira, përshtatje e rrjeteve teknike, përshtatje dhe zhvillim i shërbimeve urbane dytësore dhe tretësore. Identifikohen tre nënzona me tregues të ndryshëm zhvillimi:

- URB.01 dendësim intensiv (qendrat kryesore: Bushat, Vau-Dejës)
- URB.02 dendësim mesatar (qendrat dytësore: Hajmel, Mjedë, Barbullush)
- URB.03 dendësim i ulët (qendrat tretësore: Ashtë, Paçram)

ESP

Njohje e karakterit periferik urban, mundësi ristrukturimi urbanistik, përshtatje e rrjeteve teknike dhe pajisjen me shërbime urbane baze. Identifikohet një nënzona me treguesit përkatës të zhvillimit:

- ESP.01 zgjerim intensiv (zgjerimi i qendrave kryesore)

RUR

Njohje e kushteve të jetesës larg qendrave urbane dhe mungesë e shërbimeve urbane dytësore, mundësi ndërtimi me tregues mesatar dhe të ulët zhvillimi dhe ristrukturim / zgjerim për ndërtesat ekzistuese, përshtatje e rrjeteve teknike dhe pajisjen me shërbime urbane bazë. Identifikohet dy nënzona:

- RUR.01 vendbanim rural mesatarisht i përqendruar dhe zgjerimi i fshatrave kryesore, me tregues mesatar zhvillimi
- RUR.02 vendbanim rural i shpërhapur me tregues të ulët zhvillimi

AGR

Njohje e vendbanimeve tradicionale ne zona kodrinore dhe malore ne territor bujqësor. Lejohet ndërtim i banesave individuale/një-familjare, për qëllime primare strehimi, me tregues shumë të ulët zhvillimi si dhe mirëmbajtja e zakonshme dhe të jashtëzakonshme e objekteve ekzistuese. Lejohet edhe ndërtimi i objekte në funksion të prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Identifikohet një nënzona:

- AGR.01 ndërtime në zona kodrinore dhe malore të realizuara në tokë bujqësore

IND

Njohje e vendosjeve industriale ekzistuese, përshtatje e rrjeteve infrastrukturore dhe ndërhyrje për racionalizimin dhe organizimin urbanistik. Identifikohet një nënzona:

- IND.01 industri e lehtë, e mesme dhe e rëndë

Këto përcaktime janë përdorur edhe për ndarjen e territorit në zona e më pasë në njësi strukturore.

2.3.2 Ndarja e territorit në Zona

Zonat përmbledhin disa njësi strukturore, pavarësisht cilësive të ndryshme që mund të kenë në përdorim, kritere zhvillimi, etj.

Për përcaktimin , e zonave edhe të njësive në Bashkinë Vau-Dejës, merren parasysh këto kritere:

- Kufijtë e sistemeve sipas skemës së propozuar
- Përdorimet e tokës dhe aktivitetet e ndryshme
- Kufijtë e njësive administrative
- Plani strategjik me objektivat për mbrojtjen, rritjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave natyrore dhe rurale, burimeve ujore dhe mjedisit banesor

- Kriteret e përcaktuara në legjislacionin (VKM 671/2015) "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

Konkretisht, në përputhje me Nenin 74 të VKM 671/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", zonimi është procesi i përcaktimit të kategorive të përdorimit të tokës, ekzistuese dhe të propozuara, me objektiv ndarjen e përshtatshme të territorit të Bashkisë. Zonimi sipas të njëjtit ligj (VKM 671/2015 "Për miratimin e rregullores për planifikimin e territorit") merr parasysh kriteret e mëposhtme:

- Harmonizimi i përdorimit të tokës brenda një zone apo midis zonave fqinje.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i karakterit të një rajoni / zone dhe harmonizimi i interesit publik dhe privat në zhvillimin e saj.
- Përmirësimi i mobilitetit, rregullimi i trafikut dhe siguri i një qasje të barabartë për të gjithë.
- Zhvillimi i qëndrueshëm i gjithë territorit.
- 14 kategoritë themelore të përdorimit të tokës, me përmbajtjen dhe kodet e tyre përkatëse që janë përcaktuar në nenin 77 të të njëjtit vendim (VKM 671/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit").

Detajimi i strategjisë territoriale, e cila përcakton përmbajtjet thelbësore të PPV-së, konsiston në:

- zonimin e përdorimeve urbanistike;
- programin e mbrojtjes mjedisore;
- planin e pajisjes me shërbime dhe infrastruktura publike;
- programin e veprimeve për implementimin e planit.

Në lidhje me zonimin urban, PPV-ja duhet:

- të ndajë territorin në njësi zhvillimi mbi bazën e strategjisë së përcaktuar territoriale;
- të përcaktojë skemën e infrastrukturave dhe të pajisjes me shërbime publike ekzistuese dhe të propozuara;
- të përkthejë vendimet zonuese në programe veprimi për arritjen e objektivave të parashikuara;
- të përcaktojë parametrat e ndërrueshmërisë, programet e ndërtimeve sociale dhe instrumentet e parashikuara të zhvillimit.

Territori i bashkisë është ndarë në zona, secila prej të cilave mund të përfshijë në vetvete disa Njësi Strukturore, që i përkasin sistemeve të njëjta apo të ndryshme territoriale dhe kanë vazhdimësi hapësinore.

Zonat, për qëllimin e kësaj PPV-je, shërbejnë kryesisht për ndarjen e sistemit urban dhe janë krijuar nga procesi i zonimit. Në funksionimin dhe përdorimin e tokës, ekzistues a të planifikuar, zonimi formon sipërfaqe të vetme të kufizuar ose një bashkësi sipërfaqesh të kufizuara e të shpërndara në territor.

2.3.3 Ndarja e territorit në Njësi Strukturore

Ndarja e territorit në njësi strukturore është kryer në bazë të përcaktimeve ligjore si “ndarja më e vogël e territorit për qëllime zhvillimi, e cila përcaktohet gjatë procesit të planifikimit” (VKM 671, 29.07.2016 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”).

Referuar rregullores së PPV, njësia është pjesa më e vogël, në të cilën ndahet territori administrativ i bashkisë nga PPV-ja për qëllime zhvillimi. Njësitë krijohen nga procesi i planifikimit vendor si nënpjesë të zonave dhe kanë kushte zhvillimore të njëtrajtshme sipas përcaktimeve të PPV-së dhe /ose dokumenteve të zhvillimit, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Kufiri i njësive, aty ku ekziston mundësia, është element fizik territorial i dallueshëm për ta bërë njësinë lehtësisht të përcaktueshme në territor.

Ndarja e njësive ka marrë në konsideratë përputhshmërinë midis përdorimeve të ndryshme dhe shmangien e përdorimeve me ndikime kontradiktore mes tyre në të njëjtën njësi, veç rasteve kur parashikohen kushte shtesë për realizimin e një zhvillimi. Gjithashtu faktori kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë përsa i përket tipologjisë hapësinore është një tjetër kriter i përdorur për ndarjen e tyre. Për ndarjen e njësive janë respektuar kriteret për treguesit dhe kushte të njëtrajtshme të zhvillimit, ndërsa për kufijtë e tyre janë përdorur elementë si rrjeti rrugor, linja hekurudhore, breza mbrojtës dhe sanitare, brigje ujore, përrrenj, lumenj, kufij administrative, apo elemente të tjera lineare dhe të dukshme në territor në mënyrë që këta kufij të jenë lehtësisht të dallueshëm.

Janë përdorur dhe disa elemente të tjera si marrëdhënia me zonat historike, natyrore, bujqësore e ujore, cilësia e strukturës ekzistuese si konsolidimi apo shpërhapja, raporti me parimet strategjike, struktura fiziko gjeografike, etj. Në këtë kontekst, edhe parashikimet për të ardhmen janë të zbatueshme më thjeshtë dhe në mënyrë më të qartë për gjithë përdoruesit e planit, duke garantuar forma të ngjashme zhvillimi për njësi me cilësi të ngjashme dhe duke siguruar një zhvillim të harmonizuar të gjithë territorit.

Në ndarjen e njësive kanë ndikuar fort edhe përcaktime të bëra gjatë strategjisë, me anë të konceptit të korridoreve, morfologjisë urbane, strukturës gjeografike dhe ndërthurjes mes tyre, si element analitik për kuptimin dhe zbërthimin e territorit të bashkisë.

Njësitë strukturore pjesë e sistemit urban janë me sipërfaqe shumë më të vogël se njësitë e sistemeve të tjera. Prej njohjes së mirë të territorit dhe problemeve konkrete që lidhen me të, sidomos në Vau-Dejës e Bushat, sipërfaqja e njësive strukturore është reduktuar në maksimumin e mundshëm, për të lehtësuar procesin e hartimit të PDV-ve në të ardhmen dhe në përgjithësi menaxhimin e zhvillimit në ato zona që priten të kenë më shumë presion dhe interes nga investitorët.

Në çdo njësi përcaktohen një ose më shumë kategori përdorimesh të tokës sipas nënkategorive / aktiviteteve / funksioneve përkatëse. Në lidhje me përdorimet e tokës, është bërë një përpjekje

për përshtatjen e Objektivave strategjike, me gjetjet nga gjendja ekzistuese dhe përcaktimet që vijnë nga VKM 671- 2015 për kategoritë e përdorimit të tokës.

Përtej kategorive kryesore, për secilën njësi janë parashikuar dhe përdorimet e tjera të lejuara si dhe ato të ndaluara për të shmangur ndikimet negative. Vlen të përmendet se për ndërhyrje për qëllime të infrastrukturës së rëndësishme kombëtare dhe/ose në interes publik parashikimet në planin e përgjithshëm vendor mund të rishihen rast pas rasti për aq kohë sa respektojnë ligjet dhe dokumentet e planifikimit të niveleve më të larta.

2.3.4 Kodifikimi i Njësive

Përsa i përket kodifikimit të njësive strukturore është përdorur metoda e mëposhtme në mënyrë që të lejohet një kërkim sa më i lehtë për qytetarët dhe përdoruesit e tjerë të planit në lidhje me njësitë strukturore në GIS.

Kodifikimi i njësive është kryer duke mbajtur parasysh kriteret vijuese:

- Kodi është i papërsëritur dhe identifikon një dhe vetëm një njësi, për të qenë më i lehtë dhe i pangatërrueshëm në platformën e integruar GIS për gjithë Shqipërinë;
- Kodi përbëhet nga tre pjesë ku secila pjesë përcakton:
 - 1) Njësine administrative (ish komunën). Njësia administrative nuk përbën kriter planifikues të drejtpërdrejtë pasi territori i bashkisë është një i vetëm, por roli i mundshëm i tyre në të ardhmen (nëpërmjet delegimit të kompetencave), elementi traditë (përdoruesit e kanë më të lehtë identifikimin e zonës) ka bërë të nevojshme përdorimin e kësaj kufize;
 - 2) Sistemin, si pjesë dalluese e territorit brenda bashkisë;
 - 3) Numrin rendor të njësisë në grupin e njësive me 2 kufizat e para të njëjta.

Bazuar në kriteret e mësipërme

Kufiza e parë e kodifikimit i korrespondon dy germave të para të emrit të bashkisë (VD – Vau-Dejës). Nëse në platformën tërësore të territorit të Shqipërisë, bashkia do të kodifikohet me numrin përkatës (nga 01 në 61), ndryshimi është i lehtë për tu realizuar. Gjithsesi ky kod do të jetë i fshehur dhe shërben vetëm për platformën GIS;

Kufiza e dytë i korrespondon dy germave të emrit të njësisë administrative VD: Vau-Dejës, BU: Bushat, HA: Hajmel, SHLL – Shllak, VM: Vig-Mnelë, TE: Temal;

Kufiza e tretë i korrespondon kodit të sistemit (UB, B, IN, N, U)

Kufiza e katërt i korrespondon numrit të njësisë (psh. 1 ose 25)

Shembull

Konkretisht, nëse flasim për njësinë 25, që ndodhet në sistemin urban dhe i përket njësisë administrative Bushat, kodi përkatës është (VD) - BU-UB-25. Bazuar në kriteret e mësipërme:

2.4 RRJETI I INFRASTRUKTURAVE

Duke shqyrtuar infrastrukturën sociale në Bashkinë Vau-Dejës, propozohet fuqizim i vendbanimeve tradicionale, të konsoliduara dhe me strukturë shërbimesh ekzistuese. Këto janë kryesisht në Vau-Dejës dhe Bushat, si qendra me peshë në lidhje me vendbanimet e tjera që kanë një endje urbane të dallueshme. Po një rol të ngjashëm do të luajnë edhe fshatrat Barbullush, Hajmel, Nënshatë e Mjedë. Barbullushi është aktualisht fshati më i madh i territorit. Mjeda përkon me stacionin hekurudhor, që do të shndërrohet në një kryesore të zhvillimit të lëvizjes multimodale në territor. Hajmeli e Nënshata përkojnë me një territor me aktivitet bujqësor intensiv, shtrirë përgjatë aksit historik të komunikimit Shkodër – Lezhë (rruga rrëzëmalore) si dhe me vlera të trashëgimisë historike e kulturore.

Kuptohet, më i rëndësishmi mbetet qyteti i Vau-Dejës si qendër urbane dhe historike me rëndësi të veçantë, ku dhe janë vendosur zyrat e bashkisë dhe shërbimet kryesore. Gjithësesi edhe Bushati është një qendër mjaft e rëndësishme si për nga numri i popullsisë, ashtu edhe për nga aktiviteti ekonomik.

Ka qenë pjesë e rëndësishme e Strategjisë, evidentimi i Projekteve Bazë, si projekte në fushën e infrastrukturës, të domosdoshme për stabilizimin e një niveli minimal jetese dhe zhvillimi të qëndrueshëm, si bazë për ecurinë e mëtejshme të territorit.

Këto projekte përfshihen në tre programe:

1. **Përmirësimi i rrjeteve teknike** nënkupton ndërhyrjet e nevojshme për krijimin ose përmirësimin e infrastrukturave bazë që mbulojnë zonat urbane dhe krijojnë kushtet bazë të jetesës për komunitetet lokale që jetojnë në këto zona.
2. **Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit** lidhet me hartimin e projekteve për ndërhyrjet në territor për mbrojtjen ndaj përmbytjeve, kujdesin ndaj mjedisit si dhe ruajtjen dhe përmirësimin e peizazhit.
3. **Shërbimet publike**, nënkupton shërbimet e nevojshme në nivel urban për ti shërbyer popullatës. Këtu përfshihen arsimimi, transporti, shëndetësia, shërbimet administrative, shërbime social-kulturore, shërbimet për fëmijët etj.

2.5 ZONAT E RENDESISE KOMBETARE

Vau-Dejës për vetë pozicionin gjeografik strategjik si dhe për shkak të historisë së tij është një prej bashkive territori i të cilave përmban një numër të konsiderueshëm zonash me rëndësi kombëtare.

2.5.1 Zonat aktuale

Bazuar në kuadrin ligjor për planifikimin e territorit, “çështje, zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit” janë ato çështje, zona dhe objekte që njësohen ose lidhen me interesa shtetërorë ose kombëtarë. Zakonisht, për zonat me rëndësi kombëtare, ka akte të miratuara për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre, nga organet qendrore (ministritë dhe agjencitë) që mbulojnë sektorët përkatës.

Nga analiza territoriale e bashkisë Vau-Dejës rezulton që çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit janë:

- Infrastruktura kombëtare e transportit (rrugore, hekurudhore e ujore)
- Infrastruktura energjetike (HEC)
- Zonat me vlera të veçanta natyrore dhe mjedisore
- Zona me vlera të veçanta arkeologjike, historike dhe të trashëgimisë kulturore

Në përputhje me këtë përcaktim, zonat aktuale të rëndësisë kombëtare për territorin e Bashkisë Vau-Dejës përshkruhen në vijim:

- Rruga nacionale Lezhë – Shkodër
- Rruga nacionale Pukë – Shkodër
- Aksi hekurudhor Lezhë – Shkodër
- Itinerari i lundrueshëm Koman – Fierzë (Liqeni i Komanit)
- Hidro Elektro Centrali i Vau-Dejës
- Hidro Elektro Centrali i Komanit
- Hidro Elektro Centrali i Ashtës (Ashta 1 dhe 2)
- Zona arkeologjike e Komanit
- Peizazhi i mbrojtur Lumi Buna - Velipojë
- Monumentet e natyrës
- Monumentet e kulturës

2.5.2 Zgjerimi i zonave

PPV parashikon ruajtjen e zonave me rëndësi kombëtare zgjerimin e tyre si dhe identifikimin dhe shpalljen si të tilla të zonave të reja.

Konkretisht për territorin e Bashkisë Vau-Dejës propozohet:

- Ruajtja e të gjitha zonave me rëndësi kombëtare ekzistuese
- Zhvillimi i parkut arkeologjik në Koman
- Krijimi i parkut natyror rajonal i Luginës së Drinit (Shtrirje tokësore 10 000 Ha, Sip. ujore 2 000 Ha)
- Vënia në mbrojtje e korridoreve të gjelbra përgjatë rrjedhave ujore sipas përcaktimeve të PPV
- Zhvendosja e pjesshme dhe zhvillimi i aksit rrugor Lezhë - Shkodër
- Rehabilitimi i rrjetit hekurudhor

2.6 ZONAT PRIORITARE TE ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN

Territori i Bashkisë Vau-Dejës, në përputhje edhe me vizionin strategjik, është parë si një territor, që i duhet rikthyer traditave të mira dhe solide ekonomike, duke ruajtur karakteristikën e tij si territor tranzitimi, marrëdhëniesh, lëvizjeje dhe shkëmbimesh, por duke u mbështetur tek aktivitetet që prodhojnë punësim dhe të ardhura duke filluar nga zhvillimi i qëndrueshëm i resurseve lokale.

Rol vendimtar në realizimin e vizionit dhe zbatimin e objektivave strategjike luajnë zonat kryesore ekonomike dhe të banimit. Në to janë përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike. Këto zona krijojnë mundësi të reja dhe janë bazë për rigjallërimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë. Propozohet që këto zona të jenë të shumëllojshme, me karakter dhe intensitet të ndryshëm, që të sigurohet një zhvillim sa më fleksibël që i përshtatet sfidave të së ardhmes duke qenë elastike ndaj ndryshimeve të mëdha të mundshme.

Në përputhje me prioritetet e PPV, zonat prioritare të zhvillimit ekonomik dhe urban janë:

- Qendrat e zonave urbane Vau-Dejës, Bushat, Hajmel, Barbulush
- Zonat që preken nga projektet pilot / prioritare
- Poli i transportit multimodal Vau-Dejës – Mjedë
- Poli i shërbimeve bujqësore Bushat - Rranxë
- Zona ekonomike në Bushat (përgjatë aksit të sotëm rrugor Lezhë – Shkodër)
- Zona arkeologjike e Komanit
- Itinerari turistik Sapë – Danjë – Sardë – Koman
- Itinerari vozitës Ishulli i Bojanës – Lumi Buna – Vau-Dejës – Koman - Fierzë

Pikërisht këto prioritetet i përkasin edhe zhvillimit ekonomik-urban të bashkisë në vitet e ardhshme, duke konkretizuar vendimet strategjike të PPV.

2.7 TIPOLOGJITE HAPESINORE TE PROPOZUARA

Kriteret për përcaktimin e tipologjive hapësinore kanë të bëjnë kryesisht me:

- **Njëtrajtshmëria e llojit dhe volumit të strukturave.** Kjo nënkupton që strukturat e një ndarjeje tipologjike të jenë me mbizotërim të një tipologjie banimi, p.sh.: zona me ndërtesa të veçuara njëfamiljare ose zona me ndërtesa shumëfamiljare të tipit kullë.
- **Mënyra e vendosjes së tyre në njësi strukturore.** Ky aspekt trajton mënyrën se si pozicionohen ndërtesat në lidhje me rrugët perimetrale të bllokut, rrugët e brendshme, dhe vetë parcelat. Gjithashtu, ka rëndësi pozicionimi i ndërtesave në lidhje me njëra-tjetrën: të vendosura në rresht, të bashkëngjitura, paralele, perimetrale, bllok në formë U-je, L-je etj. Ky element është mjaft i rëndësishëm për të studiuar në vazhdim përputhshmërinë me standardet e distancave dhe për të dhënë propozime të vlefshme për treguesit e zhvillimit (Ksht, Kshr, Kshp, etj.)

- **Lartësia e strukturave.** Kriteri i ndarjes tipologjike sipas lartësisë së strukturave siguron që të ketë njëtrajtshmëri të numrit të kateve, në mënyrë që të shmangen problemet e hijezimit, privatësisë, diferencës së madhe në lartësi mes dy strukturave të ngjitura, siluetës etj. Gjithashtu, unifikimi i lartësisë mundëson një llogaritje më të thjeshtë të treguesve të propozuar për zhvillimin (p.sh. intensitetit të zhvillimit).

Në kushtet e territoreve të reja bashkiake me sipërfaqe shumë më të mëdha dhe karakter të larmishëm urban, periurban, rural, bujqësor, natyror etj., që në fazën e analizës është bërë një klasifikim shumë-shtresor i tipologjive. Kjo analizë na ka ndihmuar në përcaktimin e përdorimit të propozuar të tokës dhe të kufijve të shtrirjes së sistemit urban, si dhe në caktimin e standardeve të zhvillimit në nivel njësie strukturore.

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës tipologjitë hapësinore e ndërtimore të përfthuara nga analiza shumë shtresore dhe të implementuara si faktorë përcaktues për zhvillimin e ardhshëm variojnë si më poshtë:

TH1. Struktura Individuale të Veçuara (Banesa njëfamiljare)

Kjo tipologji përbëhet kryesisht nga banesa njëfamiljare të vendosura në parcela urbane me dimensione të ndryshme, përgjithësisht të rrethuara e me gjelbërim. Lartësia e ndërtesës varion kryesisht 1-3 kate dhe shpeshherë ka edhe një kat nëntokë. Karakteristikë e kësaj tipologjie është vendosja e ndërtesës në parcele, duke krijuar mundësi për hapjen e dritareve në të gjitha faqet e saj, dhe duke krijuar kushte optimale për orientimin dhe diellzimin. Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim apo turizëm.




Fig. 8 Struktura individuale të veçuara

TH2. Struktura Individuale Lineare / të ngjitura (Banesa njëfamiljare të bashkëngjitura)

Me këtë tipologji do të kuptojmë dy ose më shumë ndërtesa / banesa të pavarura, të vendosura të bashkëngjitura në një ose dy faqe dhe që formojnë një vazhdimësi urbane e ndërtimore. Këtu përfshihen edhe rastet kur ndërtesat kanë mbulesë të përbashkët apo kur ato zhvillohen në të

njëjtën parcelë. Karakteristike e kësaj tipologjie përgjithësisht është dimensionimi i reduktuar i sipërfaqes së parcelës dhe njësisë së banimit (në krahasim me TH1).

Ndërtesat mund të jenë një, dy ose tre kate dhe në disa raste me një kat nënçati. Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim apo turizëm.




Fig. 9 Struktura individuale lineare

TH3. Struktura Individuale të Grupuar (Banesa të grupuara)

Kjo tipologji përbëhet kryesisht nga banesa njëfamiljare me seksione të njëjta apo të ngjashme, të vendosura pranë njëra tjetrës, në parcela urbane me dimensione të vogla. Lartësia e ndërtesës varion kryesisht 1-3 kate. Karakteristikë e kësaj tipologjie është organizimi kompakt i hapësirës urbane dhe sipërfaqe e reduktuar e njësisë së banimit (në krahasim me TH1). Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim apo turizëm.




Fig. 10 Struktura individuale të grupuara

TH4. Struktura Kolektive të Veçuara (Banesë kolektive)

Kjo tipologji përbëhet kryesisht nga banesa kolektive të vendosura në parcela urbane me dimensione të ndryshme. Lartësia e ndërtesës mund të jetë deri në pesë kate dhe shpeshherë ka edhe një kat nëntokë.

Karakteristike e kësaj tipologjie përgjithësisht është dimensionimi i minimal i njësive të banimit dhe grupimi i këtyre njësive duke ekonomizuar përdorimin e tokës dhe njëkohësisht edhe koston e banesës. Gjithashtu, kjo tipologji, krijon mundësinë për hapjen e dritareve në të gjitha faqet e ndërtesës, dhe duke krijuar kushte optimale për orientimin dhe diellzimin.

Shtrirja e gjurmës së ndërtesës mund të ketë forma të ndryshme që mund të përgjithësohen në seksione planimetrie me skemë I, T, L, U, O. Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim dhe shërbime.




Fig. 11 Struktura kolektive të veçuara

TH5. Struktura Kolektive Lineare / të ngjitura (Banesë kolektive e bashkëngjitur)

Me këtë tipologji do të kuptojmë dy ose më shumë banesa kolektive të pavarura, të vendosura të bashkëngjitura në një ose dy faqe dhe që formojnë një vazhdimësi urbane e ndërtimore. Këtu përfshihen edhe rastet kur ndërtesat zhvillohen në të njëjtën parcelë. Karakteristike e kësaj tipologjie përgjithësisht është dimensionimi i minimal i njësive të banimit dhe grupimi i këtyre njësive duke ekonomizuar përdorimin e tokës dhe njëkohësisht edhe koston e banesës.

Ndërtesat mund të jenë 3-5 kate të larta. Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim dhe shërbime.




Fig. 12 Struktura kolektive lineare

TH6. Struktura Kolektive Paralele (Banesa kolektive të vendosura paralelisht)

Kjo tipologji përbëhet kryesisht nga banesa kolektive të vendosura në mënyrë paralele me njëra tjetrën duke krijuar një kompozim ritmik të strukturës urbane. Lartësia e ndërtesave mund të jetë deri në pesë kate dhe shpeshherë ka edhe një kat nëntokë.

Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim dhe shërbime.




Fig. 13 Struktura kolektive paralele

TH7. Struktura Kolektive të Grupuara (Banesa kolektive të grupuara)

Kjo tipologji përbëhet kryesisht nga banesa kolektive me seksione të njëjta apo të ngjashme, të vendosura pranë njëra tjetrës, në një skemë urbane të organizuar (kompleks). Lartësia e ndërtesave mund të jetë deri në pesë kate dhe shpeshherë ka edhe një kat nëntokë. Karakteristikë e kësaj tipologjie është organizimi i hapësirës urbane dhe asaj publike në sipërfaqe të përbashkëta relativisht të mëdha.

Në bazë të funksioneve të lejuara në njësinë përkatëse, ndërtesa mund të ketë destinacion kryesor përdorimi për banim dhe shërbime.




Fig. 14 Struktura kolektive të grupuara

TH8. Objekte industriale të veçuara

Kjo tipologji përbëhet nga objekte industriale të veçuara me funksione të ndryshme, përgjithësisht me hapësira njëkatëshe për ambientet industriale dhe lartësi 1-3 kate për ambientet e tjera. Këto ndërtesa shoqërohen me hapësira për administrimin e aktivitetit, shërbime ndihmëse si dhe ambiente ekspozimi të prodhimit.

TH9. Tipologji të veçanta (në varësi të funksionit)

Me këtë tipologji do të kuptojmë objekte të veçanta, të dedikuara për funksione specifike, të cilat nuk mund të klasifikohen brenda tipologjive të tjera të mësipërme, si: stadione, pallate sporti dhe komplekse sportive, aeroporte dhe terminale transporti, shkolla dhe institucione arsimore, spitale dhe qendra shëndetësore, ndërtesa administrative dhe institucione, qendra tregtare, qendra biznesi dhe tregje të hapura, ndërtesa social-kulturore, ndërtesa polifunksionale, ndërtesa shërbimesh, kioska dhe ndërtime të përkohshme, etj.

Propozohet që në zonat ku do të zhvillohet ndërtimi i blloqeve të banimit nëpërmjet PDV të bëhet në mënyrë të organizuar, që të realizohet integrim harmonik i bllokut të banimit në mjedisin

natyror dhe mjedisin e banimit të zonës, shfrytëzimi i hapësirave të lira të tokave dhe shërbimi për nevojat sociale të banorëve të njësisë së banimit.

2.8 PLANET E DETAJUARA VENDORE

Bazuar në Vizionin Strategjik si dhe në Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 671, datë 29.07.2015, “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, janë përcaktuar njësitë ose grupin e njësive, për të cilat duhet të hartohet Plani i Detajuar Vendor (PDV).

Plani i Detajuar Vendor hartohet me qëllim:

- zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e një zone
- rigjenerimin/ripërtëritjen e një zone kryesisht urbane
- ndërtimin e infrastrukturave publike
- ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit
- investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit
- programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte.

Në bashkinë Vau-Dejës, objektivi kryesor i hartimit të PDV është zhvillimi cilësor i hapësirës urbane, me ndjeshmëri të lartë kundrejt kontekstit dhe me vizion të qëndrueshëm për të ardhmen. Kryesisht PDV do të jenë instrumente zhvillimi në:

- Zona të trashëgimisë historike dhe kulturore. Këto zona i nënshtrohen PDV për të mundësuar zhvillimin në përputhje me karakterin e zonës duke ruajtur peizazhin urban dhe historik.
- Zona me asete ambientale dhe peizazhistike. Në këto zona, zhvillimi urban duhet të jetë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemit, biodiversitetit si dhe të ketë impakt minimal në peizazh.
- Zona të ekspansionit turistik. Këto zona parashikojnë zgjerimin e kapaciteteve në zonat me asete të turizmit natyror, agro dhe eko turizmit, turizmit historik e kulturor etj.
- Zonat e reja urbane të ekspansionit. Në këto zona planifikohet zgjerimi i qendrave urbane por nuk ekziston rrjeti i mirëfilltë rrugor dhe zona nuk ka një karakter të përcaktuar.
- Zonat informale. Në këto zona synohet të zhvillohet infrastruktura urbane dhe transformimi gradual në hapësira urbane, sociale dhe ekonomike të qëndrueshme.
- Zonat që preken nga infrastrukturat e rëndësishme kombëtare. Këto zona paraqesin rëndësi të veçantë në shkallë kombëtare dhe në këtë mënyrë paraqesin nevojën për një proces planifikimi të hollësishëm.

Gjithashtu, njësitë për të cilat hartohet PDV-ja janë ato që sipas PPV-së parashikohet të kenë:

- zhvillim dhe/ose rizhvillim, sipas parashikimeve të PPV-së
- ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit, sipas parashikimeve të PPV-së
- investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit, sipas parashikimeve të PPV-së

- programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte, sipas parashikimeve të PPV-së

Në parim, Plan i Detajuar Vendor propozohet në zonat ku është zgjedhur për të drejtuar zhvillimin dhe pritet këto zona të jene nën presion për zhvillim. Për këtë arsye konsiderohet si një mjet i përshtatshëm për të organizuar hapësirat dhe për të siguruar infrastrukturën e nevojshme. Madhësia e zonave për PDV varet nga ndërtesat ekzistuese dhe dendësia e rrjetit rrugor, intensiteti i ndërtimit dhe mënyra e zhvillimit të ndërtesave. Kështu kemi madhësi të ndryshme, por në çdo rast edhe të vogla, që të jenë me elastike dhe të menaxhohen me lehtë. Në mënyrë të veçantë janë përcaktuar njësi më të vogla në zonat urbane pranë qyteteve të bashkisë ku parashikohen zhvillime densifikimi dhe urbanizimi me intensitet mesatar apo të lartë.

Zhvillimi përmes Planit të Detajuar Vendor lidhet me njësi të cilat i përkasin dy zonave me orientime të ndryshme: zona ekonomike dhe zona të zhvillimit të banimit. Këto të fundit ndodhen kryesisht në vazhdim të qendrave të qyteteve dhe në zonat e parashikuara për ndërtime sociale.

Më veçanërisht propozohet hartimi i Planit të Detajuar Vendor për njësi të cilat i përkasin zonës së qendrave kryesore të banuara si Vau-Dejës, Bushati, Barbullushi, Mjeda, Rranxa, Hajmeli, si dhe për zonat që zhvillohen përgjatë akseve kryesore rrugore dhe elementëve të rëndësishëm territorialë. Subjekt i PDV do të jenë edhe zonat që nuk kanë një strukturë urbane dhe janë në pjesën më të madhe të pandërtuara.

Gjithashtu, PDV propozohet edhe për disa njësi të Zonës Ekonomike. Këto zona janë pikërisht ato ku marrëdhënia me infrastrukturën dhe peizazhin përbën rol kryesor në funksionalitetin dhe karakterin e zonës. Në këto pika janë vendosur edhe disa nga projektet zhvillimore të planifikuara nga PPV. Vendosja e bizneseve në receptorë të organizuar të aktiviteteve produktive lejon kushte më të buta për të vepruar, siguron infrastrukturën e nevojshme, lehtëson procedurën e marrjes së lejeve të nevojshme, kontribuon në rregullimin optimal të përdorimit të tokës dhe shmang konfliktet, ecën në përputhje me përpjekjet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit si dhe me përmbushjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm. Në mënyrë specifike, PDV do të hartohen për zonat ekonomike pranë rrugës së sotme nacionale Lezhë – Shkodër si dhe në zonën pranë stacionit hekurudhor të Mjedës.

Njëkohësisht, territore të kufizuara që formojnë bërthamën urbane të fshatrave do të zhvillohen nëpërmjet PDV. Qëllimi është për të krijuar nyje të mirëpajisura e të mirëprojektuara me shërbime urbane që do të shndërrohen gradualisht në magne të urbanë për densifikimin dhe zhvillimin e strukturës. Këtu bën pjesë edhe zonat e përcaktuara (zona banimi në terrene publike) për transferimin e banorëve nga territoret me rrezik të lartë përmbajtjeje

2.9 SHPERNDARJA E POPULLSISE NE TERRITOR

2.9.1 Të dhënat demografike

Sipas të dhënave të Censurit 2011, popullsia e bashkisë Vau-Dejës (duke përfshirë të gjashtë njësitë administrative të saj) shkon në 30 438 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrit të gjendjes civile të vitit 2015, rezultojnë 49 399 banorë.

Table 4 Të dhënat e popullsisë

Njësia Administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnelë	Total
Popullsia Census 2011	14 149	4 430	671	1 562	8 117	1 509	30 438
Popullsia Census 2011 %	46.48	14.55	2.2	5.13	26.67	4.96	100
Dendësia e përafërt e popullsisë sipas censurit (banorë/km ²)	140	118	11	14	90	21	65
Popullsia Gjendja Civile 2015	23 834	6 300	1 899	2 520	12 669	2 177	49 399
Popullsia Gjendja Civile 2015 %	48.25	12.75	3.84	5.1	25.65	4.41	100
Dendësia e përafërt e popullsisë sipas gjendjes civile (banorë/km ²)	240	200	26	26	128	30	105.6
Diferenca e popullsisë midis dy të dhënave	9 685	1 870	1 228	958	4 552	668	18 901

Arsyeja që shpjegon ndryshimin e dukshëm të të dhënave mes INSTAT dhe Regjistrit Civil, mund të justifikohet nga lëvizjet demografike brenda vendit pas vitit '89, të cilat jo gjithmonë regjistroheshin në procedurat e deklarimit demografik nga ana e bashkisë. Një hipotezë që sugjerohet është se variacioni negativ në prezencën demografike – i dukshëm në terma absolute dhe përqindje: shifra mesatare është 38.38%, me 18.961 banorë më pak, më shumë se një e treta e popullsisë absolute – t'i atribuohet fenomenit migrues brenda vendit (zonat metropolitane dhe bregdetare) dhe jashtë vendit (diasporës shqiptare).

Në thelb, Zyra e Regjistrat Lokal vazhdon të regjistrojë si rezidentë persona të cilët realisht kanë emigruar jashtë shtetit për qëllime pune.

Në konfirmim të kësaj hipoteze, është edhe koincidenca e rëndësishme e variacionit negativ demografik të matur në të dhënat e Censurit të vitit 1989 – i fundit i periudhës komuniste – dhe atij të vitit 2011, i cili ende tregon një variacioni të konsiderueshëm për të gjitha njësitë administrative aktuale, por me variacione shumë të larta për qendrën e Vau-Dejes, Temal dhe Shllak, vendet malore të bashkisë së re.

Table 5 Luhatja e popullsisë (INSTAT)

Njësia Administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnelë
Popullsia Census 2011	14 149	4 430	671	1 562	8 117	1 509
Luhatja e popullsisë 1989 – 2011 në %	-38.2	-12.4	-78.3	-98.7	-84.9	-59.3
Luhatja e popullsisë 2001 – 2011 në %	-17.7	-18.2	-44.7	-8.3	-13.9	-52

Krahasimi i variacioneve të të dhënave demografike të regjistruara në tre Censuset e fundit të popullsisë, tregon një rënie të qëndrueshme, megjithatë me tendencë për të ngadalësuar vitet e fundit.

Prania e popullsisë luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e territorit, dhe duhet të mbështetet nga politika të përshtatshme që të kundërshtojnë fenomenin e braktisjes ende në vazhdim.

Në përgjithësi, duke parë proceset afatgjata demografike, rënia e popullsisë në territoret e bashkisë së re të Vau-Dejes, në periudhën 1989-2001 ka çuar në një ulje mesatare rreth 13.2% në vit me një lëvizje totale më pak se 82% të popullsisë (rreth 17,000 persona) duke filluar nga viti 1989.

Rënia e popullsisë në periudhën 2001-2011 ka çuar në një mesatare rreth 2,23% në vit, me një lëvizje totale prej 20% (rreth 7600 banorë).

Duke analizuar tendencat e mësipërme, shifra e popullsisë ka përjetuar një fenomen të rënies së vazhdueshme, me një konsolidimin pasues.

Është e pritshme që në vitet e ardhshme të konsolidohen njësitë më të prekura nga kushtet e reja të zhvillimit global. Pra, është e mundur të supozojmë se rënia e popullsisë mund të karakterizohet nga një stabilizim progresiv, dhe ndoshta ta ndryshojë tendencën drejt asaj rritëse gjatë 15 viteve të ardhshme, kohëzgjatja e Planit të ri në formim.

Për konfirmimin e kësaj vlejën të dhënat e pakta të disponueshme për lëvizjet migratore të kthimit - të karakterizuara nga kthimi në atdhe i punëtorëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Të dhënat e disponueshme të INSTAT (burimi: <http://www.instat.gov.al/en/census/census-2011/census-data.aspx>) tregojnë një rritje interesante të këtyre kthimeve, me një kulm të shfaqur në vitet 2008-2010 (vitet e krizës financiare ndërkombëtare).

Në bazë të të dhënave të Regjistrat Civil në lidhje me 15 vitet e fundit (2000-2015), popullsia lokale përkundrazi u rrit me 6.7% (mesatarisht rreth +0.43% në vit). Rritja më e madhe u verifikua gjatë viteve 2005-2010, ndërsa gjatë periudhës pesëvjeçare 2010-2015 u mat një rritje mesatare prej + 0.07% në vit.

Table 6 Popullsia 2000-2015 (Vau-Dejës)

Njësia administrative	Viti 2000	Viti 2005	Viti 2010	Viti 2015	Diferenca 2000-2015	Rritja e popullsisë 2000-2015
Bushat	21 425	22 332	23 454	23 834	2409	11,24
Vig Mnelë	2 495	2450	2 421	1717	-778	-31,18
Temal	2530	2460	2389	2520	-10	-0,4
Shllak	1783	1553	1767	1899	+116	+6,51
Hajmel	6050	6227	6541	6760	700	+11,6
Vau Dejes	12033	12312	12660	12669	636	+5,29
Total	46.316	47334	49232	49339	3083	+6,66

Kontradikta mes të dhënave të INSTAT dhe atyre të ofruara nga Zyra e Regjistrimit është e dukshme dhe ndoshta e shkaktuar edhe nga kërkesat e natyrës elektorale dhe aksesit në fondet e Pushtetit Qendror, të cilat ndikojnë si përqindje në madhësisë demografike të bashkive. Megjithatë, duke i shqyrtuar në total, përsa i përket dinamikave që këto të dhëna duket se tregojnë, mund të vërehet një stabilizim progresiv i rënies demografike, veçanërisht në qendrat fushore dhe ndoshta edhe shenjat e para të rritjes.

Table 7 Përbërja e popullsisë në 2011 (INSTAT)

Njësia Administrative	Totali	Femra	Meshkuj	Numri i familjeve	Anëtar i një familje
Popullsia	30438	15181	15257	7424	4,1

Nga tabela më sipër, vihet re se raporti mashkull/femër është i barabartë në terma numerikë.

Familjet përbëhen nga një mesatare prej 4.1 anëtarë, një shifër pranë mesatares kombëtare.

Për shifrën e rajonit të Shkodrës, raporti i lindjeve për 1000 banorë të një territori (në një vit të caktuar) për vitin 2015, siç tregohet në tabelën më poshtë, është më e ulët se norma kombëtare e lindjeve.

2.9.2 Projeksioni i popullsisë

Aktualisht lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale apo të largëta drejt qytetit dhe zonave fushore dhe bregdetare brenda bashkisë së re të Vau-Dejës, duket se janë stabilizuar; edhe pjesa më e madhe e zonave të banuara tregojnë tendencë drejt konsolidimit. Një rol shumë pozitiv në këtë drejtim ka luajtur procesi i legalizimit të vendbanimeve joformale në të gjithë vendin.

Në këtë kontekst, për shkak të mungesës së të dhënave së disponueshme demografike dhe ndryshimit ndërmjet burimeve të ndryshme të gjetura, duhet të theksohet vështirësia dhe arbitrariteti i çdo parashikimi demografik të përdorshëm.

Parashikimi i popullsisë i propozuar nga studimi aktua, tenton kështu një rrugë të mesme mes të dhënave të INSTAT dhe atyre të regjistrimit civil të Vau-Dejës. Përtej vlerësimit mbi pjellorinë,

vdekshmërinë dhe proceseve të migrimit, sigurimi i parashikimeve të besueshme mbetet një detyrë e vështirë.

Një parashikim i tillë është ende me hipoteza të ndryshme: të lartë, të mesme dhe të ulët.

Norma të tilla kanë konsideruar edhe hipoteza dytësore mes të dhënave të INSTAT 2007-2011 dhe të dhënave nga bashkia për të njëjtat vite.

Një shtysë për këtë element kombinimi ishte pozicioni strategjik i bashkisë, pranë qendrave kryesore urbane të veriut, zonës së burimeve ujore të Zadrimës (Drini, Liqeni i Vau-Dejës, Liqeni i Shkodrës, Velipoja).

Në përcaktimin e parashikimeve demografike të bashkisë së re të Vau-Dejës, janë analizuar tendencat e zhvillimit territorial dhe të lëvizjeve demografike, veçanërisht ato të 25 viteve të fundit. Duke pasur parasysh varësinë e ndryshimeve demografike në raport me fazat e ndryshme të zhvillimit, besohet se skenarët e pritshëm të ndryshimit të popullsisë në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi, dhe në veçanti në kontekstin lokal, mund të lidhen me kushtet e mëposhtme:

- Në rastin e zhvillimit ose rritjes ekonomike, popullsia mbetet e njëjtë ose pëson rritje të lehtë
- Nëse regresioni ekonomik vazhdon të ekzistojë, popullsia tenton të tkurret duke u zhvendosur në qendra të karakterizuara nga akses më i mirë dhe aktivitet më i madh ekonomik

Pavarësisht të dhënave kundërshtuese mbi popullsinë në dispozicion, duke vlerësuar edhe treguesit jo të drejtpërdrejtë (për shembull, gratë e moshës pjellore: 49.37%) dhe analiza e treguesve të mëtejshëm, përfundimisht shfaqet i pritshëm një skenar zhvillimi i aftë për të garantuar një rritje të popullsisë prej 0,15% në vit.

Për rrjedhojë, popullsia e Vau-Dejës, është e parashikueshme në vitet 2030, midis një vlere prej 31.200 deri në 50.500 banorë, me një mesatare të pranueshme prej 41.000 persona.

Ky parashikim prej 41,000 banorë në vitin 2030, krahasuar me të dhënat e disponueshme të popullsisë (të dhënat e INSTAT 2011 dhe Zyrës së Gjendjes Civile), përfaqëson, në rastin e parë një rritje totale prej 134.70% të të dhënave të INSTAT 2011; në rastin e dytë, një ulje të popullsisë në 83% të të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile 2015.

Nëse në analizën fillestare konsiderojmë të vlefshme këto parashikime të 41,000 banorë në vitin 2030 për të gjashta njësitë administrative të bashkisë, mund të përcaktohet kuadri i mëposhtëm referues:

Table 8 Projektioni i popullsisë sipas njësive administrative

Njësia administrative	Bushat	Hajmel	Shllak	Temal	Vau-Dejës	Vig Mnele	Total
CENSUS INSTAT 2011	14149	4430	671	1562	8117	1509	30.438
Të dhënat e zyrës së regjistrimit 2015	23.834	6300	1899	2520	12669	2177	49399
Parashikimet e rritjes në 2030	19.059	5967	904	2104	10.934	2033	41.000
Variacioni neto INSTAT 2011	4910	1537	233	542	2817	524	10562
Variacioni neto sipas zyrës së regjistrimit 2015	-4.775	-333	-995	-416	-1735	-144	-8.399

Ky kuadër përfundimtar i të dhënave do të konsiderohet si bazë reference për konsideratat e bëra në fazat e mëvonshme të studimit, në veçanti si një bazë referimi për kostot e nevojshme për të përshtatur standardet urbane bazë me kushtet e ndryshme demografike.

Në këtë drejtim, sugjerohet që "parashikimet" demografike, përfaqësojnë, ndoshta më me kuptim, një lloj objektiv angazhimi për administratën publike, në kushtet e veçanta të zhvillimit të bashkisë në shqyrtim. Me fjalë të tjera, këto parashikime marrin vlerë në prani të kushteve të jashtme – rimëkëmbja e zhvillimit dhe rritjes së kombit dhe territorit lokal, rritja e kushteve të punësimit dhe të të ardhurave - por edhe në lidhje me përmbushjen e të drejtave thelbësore rezultuese të qytetarisë - shëndetin, arsimin, kulturën, të drejtat për shtëpi - përlogariten në terma realë si fusha të shërbimeve apo strehimit për përshtatjen e standardeve të strehimit, ashtu edhe kostot që i atribuohen operatorëve publikë dhe privatë.

2.10 PLANI I STREHIMIT

Kapaciteti ekzistues i zonave urbane, siç përcaktohen nga ky studim (vija e gjelbër) dhe vlerësimi i cilësisë dhe gjendjes të mjedisit të ndërtuar në përputhje me analizën, përcaktohet në planin e strehimit.

Nisur nga Parashikimet e shpërndarjes së popullsisë dhe prioritetet strategjike, është bërë shpërndarja e intesitetve dhe kritereve të tjera të zhvillimit, duke u kujdesur të kemi kapacitete më të mëdha strehimi në territoret prioritare për zhvillim urban. Në bazë të kapaciteteve maksimale dhe normës maksimale të sipërfaqes së ndërtimit për banor, është bërë edhe plani i kapaciteteve maksimale të strehimit sipas njësive strukturale.

Në planin e strehimit janë përlogaritur kapacitetet e strehimit të popullsisë sipas karakterit dhe zhvillimit të zonave urbane. Popullsia e konsideruar për strehim është 41.000 banorë të cilët shpërndahen në gjithë territorin sipas projeksioneve të popullsisë. Këtu përfshihet strehimi në banesa private si dhe strehimi social.

Duhet patur parasysh se ky plan hartohet për një popullsi që shtohet me rreth 1000 banorë në 15 vite në një situatë kur një pjesë e sipërfaqes së banimit mbetet e pa shfrytëzuar (sidomos në zonat rurale). Kjo ndodh kryesisht për shkak të emigrimit, por edhe të ndërtimit përtej nevojave

specifike apo përtej kërkesave të tregut. Më konkretisht, në bashkinë Vau-Dejës rreth 23.4% e banesave janë të pabanuara; nga këto 16.01% janë të pabanuara e në përgjithsi të braktisura, ose në kushtë të këqija, kurse 7.3% janë shtëpi të dyta ose e përdorim të përkohëshëm, si shtëpi pushimi veror ose malor. Gjithësesi shifrat për sipërfaqen e ndërtuar janë ende larg parashikimeve të planit (14.4 m²/ banor nga 25 m²/ banor të planifikuara). Në këtë kuadër, shtimi i numrit të banesave është një domosdoshmëri për vitet e ardhshme në funksion të rritjes së cilësisë së jetës.

Plani i strehimit hartohet mbështetur mbi drejtimet kryesore për zhvillimin urban të vendbanimeve, në përputhje me dispozitat e VKM 671, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit". Zhvillimi urban mund të ketë gjashtë tipe: konsolidim, zhvillim, konservim, rihvillim, rigjenerim dhe dendësim.

Persa i perket vendbanimeve të Bashkisë Vau-Dejës, rezulton masivisht nevoja e përgjithshme për konsolidim, si procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës dhe strukturës urbane ekzistuese duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara. Ndërtimi intensiv i dekadave të fundit, pa investime proporcionale të shërbimeve dhe infrastrukturave të tjera të përbashkëta, pa një plan të organizuar, solli krijimin e vendbanimeve të keqpajisura, me rrjet rrugor irracional dhe densitet të pabarabartë. Ky model është i përbashkët për të gjitha vendbanimet në pjesën fushore të territorit dhe periferitë e qendrave urbane.

Përjashtim bëjnë qendra e banuar e Vau-Dejës si dhe deri diku qendra e Bushatit e Barbullushit, ku kriter bazë mbetet ruajtja e kontekstit urban aktual, vlerave historike dhe hapësirës publike. Edhe në fshatrat e Zonës Malore do të aplikohet kryesisht konservimi, si proces i ruajtjes dhe i mbrojtjes së territorit dhe ndërtimeve aktuale, në formën e tyre ekzistuese.

Disa zona urbane, qendra fshatrash ekzistuese të konsoliduara në kohë, apo fashat rreth zonave të konsoliduara, do t'i nënshtrohen procesit të dendësimit, si koncept i afrimit të popullsisë drejt qendrave të pajisura me infrastrukturë, për të kursyer në maksimum tokën bujqësore dhe natyrore si dhe për të rritur efikasitetin e shërbimeve dhe të administrimit.

Urbanizimi proces i ndryshimit të popullsisë dhe territoreve nga rurale në urbane, apo si rritje graduale e përqindjes së popullsisë që jeton në qytet, do të përdoret për gjithë territoret që i atashohen Sistemit Urban nga sisteme të tjera, formale apo informale. Gjithsesi ky proces është reduktuar në minimum, me qëllim ruajtjen e aseteve natyrore dhe të tokës bujqësore. Kryesisht urbanizimi do të zhvillohet në periferi të Vau-Dejës, duke konturuar kështu kufijtë e qytetit dhe duke zhvilluar banesa dhe shërbime me intensitet të ulët.

Procesi i rigjenerimit, si dhe përmirësimi i kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori, do të aplikohet ndaj njësive në hapësira të ndotura, hapësira rurale të degraduara, stacionet e trenit të braktisura, ish objekte industriale (p.sh. zona rreth stacionit hekurudhor Mjedë) etj. Pikërisht këto struktura mund të kthehen në elemente atraktive duke rigjeneruar jo vetëm vetveten por edhe jetën urbane në zonat rreth tyre.

Proçesi i rihvillimit si aplikim i rindërtimit të një zonë, e cila është e ndërtuar, por e degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore, është një koncept i ngjashëm me konsolidimin, por ku karakteri i zonës merr një trajtë tjetër dhe fokusohet më shumë në përmirësimin e kushteve të infrastrukturës dhe shërbimeve sociale. Ky model do të rekomandohet për ato njësi, ku intesiteti ekzistues është afër atij të propozuar dhe ku nevoja imediate është përmirësimi i infrastrukturës bazë.

Në tërësinë e tij, stoku i banesave në Bashkinë Vau-Dejës ka nevojë për një riaftësim të ndërtesave, qoftë në aspektin ndërtimor ashtu edhe në aspektet estetike, teknologjike dhe në performancën e energjisë. Në këtë kuadër, termoizolimi, ritrajtimi i fasadave dhe pajisja me impiante teknike të reja do ti shërbente përmirësimit të imazhit urban në tërësi dhe kushteve të banimit në veçanti. Pa dyshim që ndërtesat e reja, qoftë edhe ato për strehimin social duhet të përmbushin standardet optimale ndërtimore duke garantuar parametrat e mësipërm.

Në planin e strehimit janë parashikuar ndërtimi i banesave sipas përcaktimeve të PPV në përputhje me popullsinë e projektuar. Në zonat e ekspansionit të qyteteve janë planifikuar zona për ndërtimin e banesave sociale që do të mundësojnë strehimin e personave në pamundësi ekonomike. Këto zona do të zhvillohen në terrene kryesisht me pronësi publike, duke krijuar mundësinë e kostove të reduktuara të ndërtimit për banesat sociale. Gjithashtu, do të shihet mundësia e përshtatjes së ndërtesave publike të braktisura (rast pas rasti) dhe shndërrimi i tyre në banesa sociale.

Gjithashtu në terrenet në pronësi publike në qendrat kryesore të bashkisë, do të kryhet transferimi i banorëve nga zonat me rrezik të lartë përmbajtjeje nëpërmjet *Transferimit të së drejtës për zhvillim*. Ky transferim do të mundësojë mbrojtjen e popullsisë nga rreziku i përmbajtjeve duke mundësuar njëkohësisht edhe zhvillimin e planifikuar të hapësirave të reja urbane. Në këto qendra të reja banimi do të mund të ndërtojnë banesën e tyre të gjithë ata banorë që përballen prej vitesh me problemin periodik të përmbajtjeve. Gjithashtu, këto territore siç përmendet më sipër, mund të përdoren edhe për banesa sociale nëse do të jetë e nevojshme. Ky projekt është një mekanizëm për zgjidhjen me kosto të ulta ose pa kosto të problemit të strehimit për zonat e përmbajtjes në Bashkinë Vau-Dejës.

2.11 ZONAT KU DO TE ZBATOHEN INSTRUMENTET PER DREJTIMIN E ZHVILLIMIT

Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” formulon një kornizë gjithëpërfshirëse për menaxhimin e tokës, siguron instrumentet e planifikimit, mjetet rregullatore dhe mjetet ekonomike. Në këtë Ligj përshkruhen instrumentet për drejtimin e zhvillimit që në mënyrë të përmblodhur janë:

- Intensiteti i ndërtimit me kushte
- Transferimi i së drejtës për zhvillim
- Zhvillimi i detyrueshëm i tokës
- Pezullimi i zhvillimit

- Servituti publik
- E drejta e transferimit
- E drejta e preferimit

Këto instrumente janë mjetet më ta mira nëpërmjet të cilave bashkia menaxhon më mirë burimet e saj të tokës, infrastrukturës dhe financimeve, duke u bërë palë dhe interpretuese e zhvillimit dhe jo vetëm zbatuese e rregulloreve, gjithmonë në shërbim të së mirës publike. Secili nga këto Instrumente ka momentin më të mirë dhe më përshtatshëm të përdorimit konkret dhe janë veç e veç apo së bashku në dispozicion të bashkisë. Dy të parët lidhen me procesin e PPV-së, sepse duhet të përcaktohen zonat e aplikimit të instrumentit (për të parin) dhe zonat e pranimit dhe marrjes të së drejtës të zhvillimit (për të dytën).

Në veçanti për Bashkinë Vau-Dejës është propozuar të përdoret Intensiteti i ndërtimit me kushte, për të siguruar në shkëmbim të sipërfaqes ekstra të ndërtuar, tokë, infrastrukturë direkte, apo investime publike të llojeve të ndryshme: banesa sociale, hapësira të gjelbra, objekte sociale dhe shëndetësore, rrugë dhe infrastrukturë tjetër teknike, etj. Ky instrument mund të aplikohet:

- Në territoret ku zhvillimit i është dhënë prioritet, si p.sh. Zonat Ekonomike. Duke pasur parasysh sa më sipër, këto zona mund të behet gjenerator i vërtetë fondesh për Bashkinë.
- Në territoret zhvillimi i të cilave është promovuar përmes rihzhvillimit, për të shërbyer edhe si motivim i aktivizimit të boshllëqeve urbane.
- Në territoret periferike të qendrave urbane, të cilat meqenëse janë të larguara nga qendra nuk dëmtojnë mjedisin dhe funksionimin e strukturës urbane. Për më tepër, në zonat periferike ndërtimi është zakonisht më i kufizuar dhe për këtë arsye mund edhe të jetë i dëshirueshëm rritja e tij, natyrisht me kushte.

Intensiteti i ndërtimit me kushte mund të përfitohet kur projektet e propozuara kanë një klasë të performancës energjetike të lartë duke aplikuar sisteme të avancuara të shfrytëzimit pasiv të burimeve energjetike si dhe sisteme të prodhimit të energjisë (p.sh. ndërtesa me zero energji apo me energji pozitive).

Transferimi i së drejtës për zhvillim është një instrument potencialisht i dobishme për të mbrojtur zonat ku rritja nuk është e dëshirueshme ose më pak e dëshirueshme. Megjithatë, kushtet e përcaktuara nga Vendimi nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” lidhur me përdorimin e tokës (ka të bëjë vetëm me banesat) dhe sistemet që mbron (vetëm ato bujqësore dhe natyrore) kufizojnë një varg aplikimesh në zonat urbane. Ai mund të përdoret si formë kompensimi për prona private të prekura nga ndërhyrjet infrastrukturore, apo për territoret e shpallura në rrezik përmytjesh. Ku do të transferohet kjo e drejtë për zhvillim është akoma më e vështirë të menaxhohet, por si shembull mund të shërbejnë territoret në pronësi publike, të klasifikuara për urbanizim, me prioritet banesat sociale dhe njësi të ngjashme me prioritet Konsolidimin apo Urbanizimin.

Instrumente të tjera të ndryshëm janë disponibël për financimin e infrastrukturës dhe zhvillimit urban (p.sh. sistemi i taksave, përmirësimi tarifave, financimi rritjes së taksave), të cilat janë jo të

gjitha të institucionalizuara. Megjithatë, studimi e sheh të arsyeshme specializimin e mëtejshëm dhe shfrytëzimin e tyre.

3 PLANI I MBROJTJES SE MJEDISIT

3.1 HYRJE

Programi për Mbrojtjen e Mjedisit përfshin masat zbutëse për të trajtuar ndikimet negative që shkaktohen në mjedis nga projektet e parashikuara në PPV, ndikime këto të analizuar në Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor shoqëruese të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau-Dejës.

Duke zbatuar udhëzimet e përgjithshme dhe bazuar në Direktivat Territoriale të Strategjisë në këtë pjesë do të trajtohet në dy pika:

Trajtimi i ndikimeve në mjedis, të prurjeve të Planit të Përgjithshëm Vendor që përfshin masa specifike lidhur me ndikimet në mjedis të programeve të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau-Dejës, për të minimizuar apo eliminuar efektet e mundshme negative dhe të padëshiruara në mjedis

Programi i monitorimit të Ndikimit në Mjedis, që shtrihet kriteret si do të vlerësohen dhe kontrollohen në të ardhmen ndryshimet mjedisore në territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Duke u nisur nga rekomandimet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, ky program përcakton parametrat mjedisore që duhet të kontrollohen, institucionet përgjegjëse, kohën dhe shpeshtësinë e monitorimit, si dhe shpjegon masat që duhen marrë për trajtimin e tyre.

Në kuadër të këtij vlerësimi u cituan ndikimet negative dhe pozitive, dhe në vazhdim u komentuan mundësitë e shfaqjes së ndikimeve, shkalla e tyre, shpeshtësia e shfaqjes së tyre dhe kohëzgjatja, karakteri i tyre kumulativ ose sinergjik.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor i cili u hartua paralelisht me Planin e Përgjithshëm Vendor, ka analizuar në mënyrë të detajuar të gjithë këto ndikime të mundshme të planit në mjedis dhe ka parashikuar masa zbutëse në mënyrë që të shkojë paralelisht arritja e objektivave mjedisore dhe zbatimi i projekteve të planit.

Propozimet e bëra në VSM lidhur me ndikimet e mundshme, në secilin prej elementëve mjedisor, të cilët pritet të jenë edhe negative, kanë të bëjnë me marrjen e masave lehtësuese, zbutëse dhe trajtuese, në mënyrë që ndikimet e padëshiruara në mjedis të jenë sa më minimale. Është e nevojshme që masat e propozuara për trajtimin e ndikimeve mjedisore të shkojë paralelisht me arritjen e objektivave mjedisore dhe zbatimin e projekteve të planeve të parashikuara në PPV, dhe gjithashtu të jenë praktike e të realizueshme edhe nga ana ekonomike.

3.2 TRAJTIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË PLANIT

3.2.1 Trajtimi i ndikimeve në Tokë

Ndikimi me i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj., ndërkohe që ndikimet nga fushate tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal. Nuk priten ndikime në ato sektorë ose nën sektorë ku pjesa më e madhe e aktiviteteve do të ketë të bëjë me plotësimin e boshllëqeve ligjore dhe të strukturës (aktivitete soft) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jenë të natyrës institucionale dhe organizative.

Zbatimi i projekteve të parashikuara në plan do të ketë ndikime të pakthyeshme, që reflektohen si një ndryshim në përdorimin e tokës. Tokat bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyesëm në seksionet mbi të cilët janë parashikuar ndërtime, por segmente të tilla në Bashkinë Vau-Dejës janë të pakta. Shpesh ndërtimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtër që mund të ndodhin gjatë fazës së zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV, përfshijnë lidhjet përmes tokave bujqësore ose pyjore, dëmtimet dhe okupimet e tokave ose dëmtimin e produkteve bujqësore për shkak të afërsisë me sheshet e ndërtimit, ndotje të tokës nga plehrat kimik, etj. Prandaj, kur planifikohet integrimi i projekteve të parashikuara në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj.

Aktivitetet në tokën bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohet në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe duhet t'i jepet prioritet i lartë planifikimit të aktiviteteve në toka me potencial më të ulët të prodhimit, dhe tokë jashtë zonave të dendura pyjore apo zonave pyjore me funksione të rëndësishme të prodhimit të lëndës së parë drusore.

Propozimet e Planit për fuqizimin dhe promovimin e sektorit bujqësor, përmbajnë edhe rrezikun e ndotjes së tokës nga pesticidet dhe plehrat kimike, si dhe uljen e cilësisë së tokës, pasi dihet se kur tokat kultivohen intensivisht gjatë një periudhe të gjatë kohore, përdorimi i vazhdueshëm i plehrave dhe pesticideve e bën atë më të varfër në lëndë organike, dhe kështu tokat karakterizohen si "*të lodhura*".

Për të minimizuar sa më shumë efektet negative të planit, janë parashikuar një sërë masash zbutëse:

- Garantimi i menaxhimit të qëndrueshëm të Tokës dhe mbrojtja e saj;
- Planifikim i aktiviteteve në Tokat me potenciale më të varfër të prodhimit;
- Infrastruktura të parashikohet e tillë që të mos rritet probabiliteti i rrëshqitjes së Tokës në zonën përreth aktiviteteve;
- Promovimi i riciklimit dhe ripërdorimi i mbetjeve të ndërtimit në ndërtimet dhe infrastrukturat e reja
- Ripërdorimi i materialit të gërmuar, trajtimi dhe transportimi i tij në minimum, dhe depozitimi i tij në mënyrë që të minimizohen ndikimet e gërryerjes;

- Largimi i dherave të ndotur që hasen gjatë punimeve dhe depozitimi i tyre në vende të caktuara ku të jenë të izoluar nga ujërat nëntokësorë;
- Mbrojtja e tokës që shtrihet nën sistemin infrastrukturor që do ndërtohet, nga ndotjet kimike dhe derdhjet e hidrokarbureve duke përdorur teknologjinë e duhur gjatë punimeve;
- Mbjellja me bimësi dhe rigjenerimin i zonave të dëmtuara;
- Nëse ndiqen praktikatat e mira bujqësore, në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian, kështu do të ketë minimizim të përdorimit të plehrave dhe pesticideve që dëmtojnë Tokën.

3.2.2 Trajtimi i ndikimeve në ajër dhe tek faktorët klimatikë

Gjatë përgatitjes së politikave dhe projekteve të planit duhet të respektohen udhëzimet dhe masat në vijim, në mënyrë që të arrihen objektivat e reduktimit të ndotjes së ajrit në zonat e ndikimit të aktiviteteve problematike:

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e bashkisë duke vendosur stacione automatike monitorimi;
- Koordinimi mes institucioneve për vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe masat ndaj ndryshimeve klimaterike;
- Implementimi i sistemit të shtypjes së pluhurit;
- Përdorimi i mjeteve të transportit publik me emetime të gazeve në nivele të ulëta ose me filtra ajri të reduktimit maksimal;
- Kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit me pezulli në qendrat urbane;
- Mirëmbajtja e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakësuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive;
- Përcaktimi i masave të emergjencave në rastet e aksidenteve për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij;
- Identifikimi dhe monitorimi i burimeve të gazeve të dëmshme;
- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi;
- Strukturimi i kërkesës së lëndës drusore;
- Monitorimi i vazhdueshëm i: kushteve ekologjike të mjedisve natyrore, përbërjes së ujërave të ligatinave, tjetërsimit të tokës natyrore dhe i të gjithë elementëve të tjerë që ndryshojnë si pasojë e ndryshimeve klimatike;
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane dhe industriale për të zvogëluar sasinë e lendeve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore;

3.2.3 Trajtimi i ndikimeve në ujëra

E veçantë për Bashkinë Vau-Dejës është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Vau-Dejës, liqeni i Komanit dhe lumi Gjadër që shpëputet nga Drin rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vau-Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën të mundur jo vetëm lidhjen e territorit në mënyrë ujore por edhe shfrytëzimin e tij për kultivimin e peshkut. Shfrytëzimi i sistemit lumor për lundrim, përveç anëve pozitive sjell edhe ndotjen e ujërave dhe dëmtimin e

habitatit ujorë. Një vëmendje e veçante duhet ti kushtohet ruajtjes së cilësisë së ujërave, duke mbrojtur kështu habitatit dhe duke i bërë këto ujëra të përshtatshëm për tu shfrytëzuar për plazhe. Sidoqoftë ndikimi i projekteve në këtë sistem është i pamënjanueshëm, por nën zbatimin e masave zbutëse këto ndikime bëhen të parëndësishme. Ajo që ndikon më shumë nga programet e PPV është infrastruktura.

Në mënyrë që të kufizohen efektet e presionit që do të ushtroje infrastruktura e parashikuar në burimet ujore dhe kështu të parandalohen ndikimet negative në cilësinë e ujit (sidomos ujit të pijshëm), duhet të shmangët ndërtimi në zonat e mbrojtura ujore.

Kur planifikohen ndërhyrjet në zonat me rrezik jashtëzakonisht të lartë, shumë të lartë dhe të lartë të akuifereve, është e nevojshme që të studiohen dhe planifikohen zgjidhje të duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, si dhe në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme).

Aktivitetet e parashikuara në PPV mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, të zvogëlojnë basenët mbrojtëse ujore dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës. Për të minimizuar sa më shumë efektet negative të planit, janë parashikuar një sërë masash zbutëse:

- Duhet planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujërat e largës, gjatë fazave të zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV, si dhe në rastet e ndodhjeve të jashtëzakonshme (p.sh. derdhjet e substancave të rrezikshme).
- Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë më pak se 50m nga brigjet e lumenjve si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- Kanalet anësore do të ndërtohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lume, apo kanalet kulluese;
- Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program masash për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Marrja e mostrave të ujërave nëntokësore duhet të bëjë *in situ* matjen e pH, turbullirës dhe përcjellshmërisë elektrike. Të gjitha veprimet e kërkuara dhe, nëse nevojiten, analizat, duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Përdorimi i pajisjeve të duhura për t'u marrë më derdhjen e substancave të rrezikshme në lumenj;
- Zbatim i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për ujitje, ndërtimi i rrjeteve moderne kolektive të ujitjes dhe monitorimi i njësive individuale të shpimeve për ujë;

Ndërtim të rrjeteve moderne të ujitjes kolektive, në mënyrë që të minimizohet sasia e ujit për ujitje që humbet me anë të avullimit dhe të ujitet bima direkt e në rrënjë, e cila thith ujin, në mënyrë që të ketë maksimizim të efikasitetit të sistemeve të ujitjes.

3.2.4 Trajtimi i ndikimeve në biodiversitet dhe në mjedisin natyror

Respektimi i masës do të zvogëlojë shqetësimet për ciklet e jetës së kafshëve dhe bimëve dhe do të rrisë probabilitetin për të arritur apo ruajtur një gjendje të favorshme të popullsisë. Mundësitë e arritjes së objektivit për ruajtjen e biodiversitetit do të jenë më të larta.

Projektet specifike duhet të plotësohen me detyrën për të mbrojtur në mënyrë me adekuate llojet e veçanta të kafshëve prej rreziqeve që vijnë si pasoje e ndërtimit të infrastrukturës së re apo ndërhyrjet në atë ekzistuese. Duhet të zbatohet masa zbutëse specifike: Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve.

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Nëse aktivitetet në mjedisin e paprekur nuk mund të shmangen, duhet të shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura, zonat me rëndësi mjedisore e kulturore dhe zonat me karakteristika të çmuara natyrore;
- Prioritet duhet t'i jepet varianteve me më pak ndikim në rrugët e migrimit të kafshëve të egra;
- Duhet të sigurohen pasazhe të përshtatshme për kafshët e egra, gjë që është në përputhje me praktikën me të mira evropiane;
- Të ulet fragmentimi i habitateve të llojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet);
- Në zonat ku planifikohet infrastruktura e re, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migrimit, duke ndërtuar strukturat e duhura dhe duke kryer gjithë sistemimet e tjera për të parandaluar lëvizjen e kafshëve të egra.

Krijimi i kalimeve të gjelbra për kafshët është i rëndësishëm të mbahet parasysh në të gjitha propozimet infrastrukturore të PPV-së dhe kryesisht në akset me lëvizshmëri më të lartë të automjeteve, përmendim këtu autostradën Lezhë-Shkodër.

3.2.5 Trajtimi i mbetjeve në zonat Hot-Spot

Zhvillime të parashikuara do të ndikojnë në gjenerimin e shtuar të sasisë së mbetjeve, të cilat mund të cenojnë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. *Hot-spot*-et përbejnë rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut, por edhe për biodiversitetin e natyrën.

Gjenerimi i mbetjeve në territorin e bashkisë ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Aktualisht, në territorin e bashkisë, në Bushat, gjendet edhe landfilli i grumbullimit të mbetjeve urbane, që ka një periudhë shërbimi për 20 vjet.

Landfill-i i Bushatit ndodhet rreth 13 km në jug të qytetit të Shkodrës, rreth 2.5 km në lindje të fshatit Bushat dhe rreth 1.5 km në lindje të fshatit Shkjezë.

Në landfill depozitohen mbetjet urbane të të gjitha llojeve dhe një listë e hollësishme e tyre është dhënë në dokumentin fillestar të këtij landfili. Nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri dhe akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni mjedisor.

Landfill-i i Bushatit është një element i territorit ku kujdesi ndaj impaktit mjedisor duhet të jetë maksimal duke garantuar ruajtjen e aseteve mjedisore të zonës.

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si më poshtë:

- Bashkia Vau-Dejës duhet të përqendrohet kryesisht në arritjen e objektivave si:
- Arritjen e afateve të VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:
 - a) Optimizimit të grumbullimit të mbetjeve;
 - b) sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
 - c) promovimit të ripërdorimit të produkteve;
 - d) përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
 - e) përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.
- Njësia e Qeverisjes Vendore, në planet e përgjithshme vendore të hartuara sipas nenit 20 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas nenit 13 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, duhet të parashikojë vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe landfillet për mbetjet inerte.
- Në zbatim të VKM nr. 608, datë 17.09.2014 “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio” Bashkia Vau-Dejës, të hartojë rregullat që duhen zbatuar për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve bio, i cili përcaktohet në planin vendor të menaxhimit të mbetjeve, të përgatitur në përputhje me Planin Rajonal dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.
- Rehabilitimi i zonave me ndotje të lartë mjedisore, rinovimi urban dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zone të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;
- Indetifikimi i të gjitha pikave të ligjshme dhe të paligjshme të hedhjes së mbetjeve;
- Inventarizmi dhe diagnostifikimi i venddepozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe raportimi;
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve;
- Janë të domosdoshëm buxhete të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat;
- Hartimi i programeve për diferencimin që në burim të mbetjeve;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme;

- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve.

3.2.6 Trajtimi i ndikimeve në mjedisin akustik-zhurmat

Masat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma duhet të përqendrohen kryesisht në:

- masa për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim;
- masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis;

Masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim janë me të efektshme. Emetimet e reduktuara të zhurmës nga burimet e saj mund të arrihet kryesisht përmes modernizimit të logjistikës në përdorim, riorganizimit të flukseve të trafikut, orareve të kryerjes së ndërhyrjeve infrastrukturore, etj. Qëllimi i SKZHIII në lidhje me vlerat e zhurmës në vitin 2020 është të arrijë objektive 56dB/ditë dhe 45dB/natë.

Masat për të parandaluar përhapje në zhurmës në mjedis janë përdorur kryesisht për të mbrojtur mjedisin nga zhurma të shkaktuara prej sektorit të transportit. Masat janë të përshtatshme kryesisht për mbrojtjen e zonave me dendësi të madhe të popullsisë përgjatë rrjetit rrugor, ndërkohe që zbatimi i këtyre masave përgjatë rrugëve ekzistuese që kalojnë përmes vendbanimeve me një strukturë urbane të formuar dhe të dallueshme tashme, është i arsyeshëm vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Masat për të siguruar kushte të duhura jetësore (p.sh. izolimit nga zhurma i dritareve në ndërtesa të ekspozuara së tepërmi) janë të përshtatshme në zonat ku masa të tjera nuk janë teknikisht të zbatueshme apo ekonomikisht të qëndrueshme.

- Masa për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim;
- Masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis;
- Masa për të siguruar kushtet e duhura të jetesës;
- Masat zbutëse gjatë fazës së zbatimit të punimeve:
- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës nga makinerive të ndërtimit, në përputhje me rregullat mbi emetimet e zhurmës nga makineritë e përdorura në vende të hapura dhe në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- Çdo impiant, i tillë si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jete i rrethuar nga një barrierë akustike apo reflektor portativ
- Implementimi i masave të përkohshme për të mbrojtur nga zhurma zonat e populluara pranë kantierëve të ndërtimit dhe rrugëve të transportit ku janë tejkaluar vlerat kufi.
- Respektimi i afateve kohore për ndërtimin afër zonave të populluara;
- Publiku i gjerë dhe banoret e zonës do të informohen paraprakisht kur të kryhen vepra që emetojnë zhurma të konsiderueshme;
- Në kantierin e punimeve nuk do të përdoret asnjë makineri apo pajisje që shkakton shqetësim të publikut për shkak të zhurmës;

3.2.7 Trajtimi i ndikimeve në popullsi dhe në asetet materiale

Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qendrat multimediale të transportit) pritet që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. Për të shmangur një përkeqësim të mjedisit ku jetohet në zonën përreth këtyre zhvillimeve, ky fakt duhet të mbahet në vëmendje kur të behet verifikimi i mundësive për zhvillim në fazat e mëvonshme, në kuadër të sigurimit të një lidhje multimodale në rajonin përreth.

Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen më aktive të komunitetit në kuadër të sistemimeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.

Propozimet e Planit nuk priten të kenë ndikime negative në popullsi, për këtë arsye nuk propozohen masa zbutëse. Në të vërtetë, siç u konstatua nga analiza e mësipërme, efekti i propozimeve të Planit do të jetë pozitiv si për popullatën e Bashkisë ashtu edhe për asetet materiale.

3.2.8 Trajtimi i ndikimeve mbi trashëgiminë kulturore

Zhvillimi i infrastrukturës së parashikuar mund të ndikojë te njësitet dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit të rrethinave të njësive të trashëgimisë kulturore, dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve të cilat mund të shkaktojnë dëme në objektet e trashëgimisë kulturore. Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh sa më poshtë:

- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore.
- Studime të detajuara të zonave ku parashikohen ndërtime në afërsi të zonave me rëndësi kulturore;
- Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jete i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimin e paqëllimshëm ose si pasoje e neglizhencës ndaj arkeologjisë.
- E gjithë puna e ndërtimit do të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve.

3.2.9 Trajtimi i ndikimeve mbi peizazhin

Përcaktimi i impaktit mbi cilësinë e peizazhit, buron kryesisht nga veçoritë pamore të hapësirës dhe nga elementet karakteristike të peizazhit që janë të pranishëm në këtë hapësirë. Peizazhi cenohet më shumë nga infrastruktura që shtrihet në zona të hapura, ku impaktet janë më të dukshme për shkak të një niveli të lartë shtrirjeje. Ndikimi është veçanërisht i lartë në rastin e një ndërhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik.

Disa ndikime të projekteve të planit në peizazh janë të pashmangshme dhe për të zbutur natyrën negative të këtyre ndikimeve propozohen masat e më poshtme:

- Zbatimin e standardeve kombëtare shqiptare të rrugëve për pastrimin e kantierëve dhe ripyllëzim, për të siguruar ruajtjen e komoditeve të nevojshme të peizazhit;
- Për mbushje, shpatet duhet ti nënshtrohen mbjelljes hidraulike me një përzierje fare që përfshin farat e barit. Përveç kësaj, mbjellja në vendet e ndjeshme, veçanërisht në afërsi të ambienteve të banimit dhe rekreacionit, do të përdoret për të reduktuar apo zbutur pengesat vizuale të shkaktuara nga ngritja e argjinaturave të projektit, sidomos në kryqëzime;
- Aty ku është e mundur, argjinaturat e projektit duhet të ulen në minimumin e mundshëm;
- Pjerrësitë e argjinaturave do të jenë sa më të buta. Mbi gjithë argjinaturat do të shpërndahet dhé, dhe ato do të mbillen me bime që mund të adoptohen në kushtet lokale;
- Në vendet ku rruga kalon pranë pronave private, do të ngrihen mbulesa bimore, me qëllim reduktimin e ndërhyrjes pamore.
- Shtimi i zonave të mbrojtura, pyllëzim dhe shtimi i hapësirave të gjelbra.

Gjatë hartimit të planit mjedisi ka pasur një rol shumë të rëndësishëm. Ruajtja dhe shtimi i hapësirave të gjelbra është mbajtur parasysh sidomos gjatë fazës së hartimit të projekteve, mund të përmendim këtu: korridoret e gjelbra të lumenjve (lumi Gjadër), korridoret e propozuara përgjatë kanaleve vaditës, pyllëzimi i kodrës së Zefjanës etj. të cilët ndikojnë në përmirësimin e peizazhit. Një propozim me ndikim pozitiv në bashkinë Vau-Dejës është Parku Rajonal i lumit Drin, i cili bën bashkimin e parkut të Alpeve me Zonën e mbrojtur të Bunës.

3.2.9.1 Zonat e reja të mbrojtura

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, PPV ka parashikuar shtimin dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura. Zonat e propozuara janë krijimi i Parkut Natyror Rajonal i Lumit Drin. Propozimi që kjo zonë me vlera të larta ekologjike dhe natyrore të marrë këtë status ka ardhur si rrjedhojë e konsultimit me kornizën ligjore dhe propozimeve nga përfaqësuesit e specialistët e bashkisë Vau-Dejës dhe njësive administrative gjatë konsultimeve për hartimin e PPV-së dhe VSM-së.

Propozimi për shtimin sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, siguron konservimin e natyrës, biodiversitetit dhe peizazhit, mbrojtjen e trashëgimisë tradicionale, historike, kulturore dhe shpirtërore, me pjesëmarrjen e komunitetit. Gjithashtu ky Park Natyror Rajonal do të shërbejë për mbrojtjen e peizazhit të lumit Drin dhe lidhjen e Alpeve me peizazhin e Bunës dhe Velipojës.

Ky propozim vjen gjithashtu nisur dhe nga potenciali i madh që ka për zhvillimin e ekoturizmit duke e gërshtuar këtë edhe me përfshirjen e një komuniteti të gjallë dhe aktiv, duke siguruar një përvojë të veçantë për vizitorët e shumtë të tij.

Shpallja e kësaj zone Park Natyror Rajonal do të kërkojë angazhimin maksimal të Bashkisë së Vaut-Dejës, nëpërmjet kryerjes së të gjitha procedurave ligjore si dhe përgatitjes së një projekti për të garantuar këtë mbrojtje ligjore.

Propozimi për shpalljen e kësaj zone “park natyror rajonal” ka ardhur duke mbajtur parasysh kriteret e mëposhtme:

- ndodhet brenda territorit administrativ të qarkut;
- është jo më i vogël se 50 ha;
- siguron mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit natyror e të biodiversitetit në shkallë lokale;
- është zonë e gjelbër natyrore, ose e kultivuar, që shërbenë për plotësimin e nevojave të komunitetit për veprimtari ekonomike tradicionale, duke respektuar kërkesat e parimit të përdorimit të qëndrueshëm të territorit;
- është i populluar me lloje të florës dhe faunës, kryesisht të karakterit lokal;
- ofron mundësi për komunitetin të ushtrojë veprimtari shoqërore, edukative, argëtuese, sportive, kulturore, rekreative dhe turistike;
- nuk është i përfshirë në rrjetin ekzistues të zonave të mbrojtura;
- nuk ka habitate të llojeve të rrezikuara, të kërcënuara, të rralla dhe endemike, të cilat mbrohen në nivel kombëtar, me një akt të veçantë normativ.




Fig. 15 Harta e Zonave të Mbrojtura. Burimi: VSM Vau-Dejës

3.2.10 Konkluzion për trajtimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit

Zbatimi i projekteve, pritet të sjellë impakte pozitive dhe negative. Impakt pozitiv pritet të ketë në drejtim të cilësisë së ajrit, ndryshimeve klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human. Impaktet pozitive mbipopullatën dhe asetet materiale do të vijnë si rezultati zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, afrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane, etj.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV (projekte infrastrukturore, bujqësore dhe turistike) dhe janë kryesisht të përkohshëm (deri në përfundim të punimeve). Territori i bashkisë ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.).

Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me peizazhe të veçanta), trashëgiminë kulturore dhe peizazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave zbutëse është zvogëlimi, sa më shumë të mundemi, i impakteve negative në mjedis. Trajtim më i hollësishëm i vlerësimit të këtyre ndikimeve është bërë në VSM-në shoqëruese të PPV-së.

Theksohet se Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis që do të hartohet në të ardhmen për projekte të ndryshme të propozuara të infrastrukturës teknike apo për projekte zhvillimi në rajonin e Bashkisë, do të duhet të marrin parasysh këtë Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM), me qëllim që të jenë më efektiv në identifikimin, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore të planeve, si edhe në formulimin e masave për trajtimin e këtyre ndikimeve mjedisore.

3.3 PROGRAM MONITORIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Bazuar në sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit (PPV), si dhe për masat e propozuara për zbutjen e tyre, është hartuar Programi i Monitorimit të Ndikimit në Mjedis. Ky program sipas literaturës botërore, përcakton personin përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e masave të trajtimit, kohën dhe shpeshtësinë e monitorimi, si dhe hartimin e raportit mbi harmonizimin e zbatimit të Planit me arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Ndikimet e parashikuara mjedisore dhe masat e propozuara të trajtimit janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme, për secilin faktor mjedisor, për të cilat u vlerësuan efekte negative:

Table 9 Ndikimet negative të parashikueshme dhe masat e propozuara

Faktori mjedisor	Ndikime negative të parashikueshme	Masa të propozuara të trajtimit
Toka	Fragmentimi, ndryshimi i përdorimit të tokës, shkatërrimi i pakthyeshmëri të tokës bujqësore në zonat e marra nga ndërtimet e reja, si dhe kontaminimi i mundshëm gjatë zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në PPV.	Planifikimi i aktiviteteve në toka me potenciale të ulëta prodhimi; Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj; Rehabilitimi i zonave pas përfundimit të punimeve dhe mbjellja me bimësi për të siguruar një mbulesë stabilizuese të tokës.
Ajri dhe Faktorët klimaterik	Ndota e ajrit nga shtimi i sasisë së elementëve të dëmshëm që do të emetohen në ajër gjatë dhe pas zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV si dhe ndikimet nga ndryshimet klimatike në territorin e bashkisë.	Shtimi i sipërfaqeve me bimësi dhe pyje; Përcaktimi i masave të emergjencës në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis; Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave dhe parametrave të ajrit, si dhe ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta për të zvogëluar sasinë e lendeve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore
Ujë	Projektet e parashikuara në PPV mund të shkaktojnë ndryshime në regjimin e ujërave nëntokësore dhe ndotje të tyre, si dhe ndotje të baseneve ujëmbajtëse nga depozitim i mbetjeve të ngurta dhe atyre me natyrë kimike.	Zbatim i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për ujitje - ndërtim i rrjeteve moderne kolektive të ujitjes - kontrolli i shpimeve në shtresat ujëmbajtëse; Pastrimi i baseneve ujëmbajtëse dhe mbrojtja e tyre nga kontaminimi dhe depozitim i mbetjeve të ngurta dhe atyre me natyrë kimike.
Mjedi Natyror dhe Biodiversiteti	Fragmentimi i habitatit, humbje të përfaqësuesve individuale të llojeve të bimëve dhe kafshëve, si dhe prishja e rrugëve të shtegtit të tyre gjatë zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në PPV.	Shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve; Shmangia e fragmentimit të habitateve Ruajtja e ciklit jetësor të kafshëve
Mbetje	Gjenerimi i mbetjeve apo depozitimi i tyre në vende të pa përshtatshme gjatë dhe pas zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV do të rrezikojnë integritetin e shtresave ujëmbajtëse nëntokësore (baseneve ujore si dhe shëndetin e popullsisë).	Monitorimi i landfillit ekzistues dhe eliminimin i venddepozitimeve të paligjshme. Diferencimi i mbetjeve që në burim; Promovimi i riciklimit të materialeve të ndryshme; Informimi i banorëve dhe ndërgjegjësimi i vizitorëve në lidhje me çështjet e menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve të ngurta;
Mjedi akustik/zhurma	Ndotje akustike gjatë fazës së zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në PPV-së.	Riorganizimi i flukseve të trafikut dhe orareve të ndërhyrjeve për të reduktuar emetimet e zhurmës; Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit të prodhuara në përputhje me normat e emetimit të zhurmës; Izolimi akustik i ndërtesave - organizim hapësinor i njësive të përpunimit në zonat ekonomike

Trashëgimia Kulturore	Degradimi i mundshëm i peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore, dëmtimi i objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe shkatërrim i mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë fazës së zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV.	Hartimi i studimeve të hollësishme arkeologjike në rastet kur duhet të ndërhyhet në zonat me karakteristika të veçanta;
Peizazhi	Dëmtimi i zonave peizazhistike me tipare të veçanta dhe elemente natyrorë të mbrojtur, si dhe prerje e bimësisë në zonat kodrinore apo ku është parashikuar ndërtime apo kalim infrastrukture;	Shmangia e prerjes së panevojshme të pemëve në zonat kodrinore/malore dhe përgjatë brigjeve lumore; Shmangia e ndërhyrjeve të panevojshme në zonat me tipare të veçanta dhe në zonat peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur.

Tabela, ku paraqiten treguesit përkatës të përshtatshëm të monitorimit, frekuenca e përgatitjes së raportit informativ dhe organi përgjegjës për monitorim:

Table 10 Programi i Monitorimit të ndikimeve mjedisore

Faktori Mjedisor	INDIKATORI	AUTORITETI MONITORUES	PARAMETRAT MJEDISORE	FREKUENCA E MONITORIMIT	KOMENTE
Biodiversiteti-fauna - flora	Numri i habitateve të rëndësishme Sipërfaqja me zona të mbrojtura Biodiversitetit Ekonomia pyjesh Zona natyrore	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Administrata e Zonave të Mbrojtura Ministria e Mjedisit Drejtoria e Zhvillimit Rajonal & Integritetit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve	Numri dhe gjendje e habitateve Numri dhe/ose sipërfaqja me zona të mbrojtura Numri i specieve endemike dhe të rralla Sipërfaqja e mbuluar me pyje Numri i zonave natyrore dhe sipërfaqja e tyre.	Sipas Planit të Menaxhimit Çdo vit	
Popullsia shëndeti i njerëzve	Jetëgjatësia e popullsisë Aksidentet në punë Varfëria	Drejtoria e shëndetit Publik Inspektorati Shtetëror i Punës Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme Numri i aksidenteve të regjistruara Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Çdo vit	
Toka	Degradimi i tokës Menaxhimi i mbetjeve Prodhimi i mbetjeve Riciklim dhe ripërdorim i mbetjeve	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Ministria e Bujqësisë Bashkia dhe Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës Bashkia	Përqindja e tokës së degraduar Sasitë e mbetjeve të eliminuara në landfille Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali % e ricikluar (letër, xham, mbetje bashkiake bio të degradueshme, alumin)	Çdo vit	

PPV Bashkia Vau-Dejës
Plani i Zhvillimi të Territorit

Uji	Cilësia e ujerave sipërfaqësore Cilësia e ujerave nëntokësore Përqindja e riciklimit të ujit Përqindja e popullsisë së lidhur me shërbimin e trajtimit të ujerave të ndotur	Autoriteti i Menaxhimit të Baseneve Këshilli Teknik i Ujit Agjencia Kombëtare e Mjedisit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Total N, total P, BOD-et, COD, SS, TDS, pH, përcjellshmëria, etj. pH, përcjellshmëri, fortësia, kloridet, sulfatët, COD, BOD, nitrati, nitrimi, total P, metalet, detergjentet, ngarkesa toksike e mikrobiologjike, etj.	Kampionim dhe matje sipas miratimit të kushteve mjedisore për çdo ITUN, çdo 6 muaj.	Sipas Ligjit nr. 34/2013 që amendon Ligjin nr 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura” Ligji nr. 9915, datë 12.05.2008 “Për Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujerave të ndotura”
Deti	Uji i Detit: Cilësia e ujit të bregdetit	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Parametrat mikrobiologjike për ujëbregdetit	Çdo 6 muaj	Direktiva 2006/7/EC për menaxhimin e cilësisë së ujerave të largës
Ajri	Ditët kur tejkalohen normat e cilësisë së ajrit ¹ Shkarkimet sipas Burimit	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet sere, Pb, CO	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të Ndotur
Faktorët klimatike	Shkarkimet e Gazeve Sere(sipas burimit %) kërkesa për energji (Alokimi i prodhimit të energjisë sipas burimit) Përqindja e BER ² (%) Mjetet në qarkullim	Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Enti Rregullator i Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor	SOx, NOx, PM10, gazet sere, Pb, CO Përqindja e Energjisë nga BER (%) Numri i automjeteve të udhëtareve	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të Ndotur

¹Kufijtë Kombëtar për cilësinë e ajrit (SKZHI II)

²BER-Burimet e Energjisë së Rinovueshme

PPV Bashkia Vau-Dejës
Plani i Zhvillimi të Territorit

Trashëgimia kulturore Peizazhi	Numri i godinave të ruajtura që restaurohen Numri i vizitoreve Gjelberim urban për frymë	Bashkia, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit	Numri i godinave të ruajtura që restaurohen Numri i vizitoreve Gjelbërim urban për frymë	Çdo vit	
-----------------------------------	--	---	---	---------	--

4 PLANI I SHERBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE

4.1 INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Ndërhyrjet në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë Vau-Dejës janë elementë të rëndësishëm të Strategjisë së zhvillimit, që janë shtruar në PPV dhe janë shtjelluar në Planin e veprimit sipas prioritetit dhe mundësisë për ndërhyrjen nisur edhe nga fondet e nevojshme.

Mund të ritheksojmë se përditësimi i infrastrukturës është pjesë e domosdoshme për të mundësuar dhe garantuar çdo formë të mëtejshme zhvillimi, qoftë në planin ekonomik edhe në planin urban apo social. Rëndësia që merr Infrastruktura në hartimin e Planit vjen edhe nga futja e konceptit ligjor të Sistemit Infrastrukturor.

Ndërhyrjet e rëndësishme në këtë nivel u trajtuan edhe në kapitujt e mësipërm, por këtu vlen të përmendim stacionin multimodal të Mjedës, që është nder projektet më ambicioze dhe me impakt më të lartë. Objektivi i këtij projekti është realizimi i një qendre logjistike të integruar, që përmbledh tipologji të ndryshme transportesh, e tillë që të optimizojë grumbullimin dhe shpërndarjen e mallrave në hyrje dhe dalje. Ky projekt mund të financohet me fonde private (Project Financing) dhe publike (Ministria e Infrastrukturës) me mundësi bashkëfinancimi me BE, Programi IPA II.

Stacioni do të përfshijë aksesin nëpërmjet infrastrukturës hekurudhore dhe rrugore si dhe parashikon mundësinë e lidhjes me transportin lumor përgjatë lumenjve Drin dhe Buna nëpërmjet porteve lumore në Vau-Dejës dhe Ashtë. Nëpërmjet këtij projekti, poli urban Vau-Dejës - Mjede kthehet në një nyje të rëndësishme të rajonit ekonomik Shkodër – Lezhe duke shfrytëzuar më së miri pozicionin strategjik dhe aksesin në infrastrukturë.

Një tjetër pjesë me rëndësi e ndërhyrjeve në infrastrukturë është propozimi strategjik për krijimin e korridorit lundrues lumor si një mënyrë e lidhjes së territorit përgjatë lumit Drin, në mënyrë të kujdesshme ndaj mjedisit dhe duke i dhënë theksin morfologjik propozimeve konkrete për menaxhimin e territorit.

Funksioni i këtij korridori është të rrisë lidhjen ekologjike midis Parkut të Alpeve dhe Peizazhit të Mbrojtur të Bunës, duke e shoqëruar këtë funksion kryesor me ndërtimin e një sistemi transporti lokal me impakt të ulët, për të siguruar aksesin në vendbanimet malore dhe në destinacionet kryesore turistike në zonë.

Një tjetër projekt i rëndësishëm, megjithëse jo imediat, është trajtimi biologjik i ujërave të zeza të fshatrave në zonat e thella malore të Vig-Mnelës, Shllakut dhe Temalit, të cilët aktualisht kanë mungese totale kanalizimesh, që është zgjidhur me gropa septike individuale, të hapura shpesh pa kriter. Propozimi i PPV-së është një impiant për menaxhimin e këtyre mbetjeve në

formë të organizuar, pa bërë kanalizime të mirëfillta tradicionale, por duke i kthyer një pjesë të mbetjeve tokës në formë plehu organik dhe duke shmangur ndotjen e mundshme të ujërave nga derdhjet dhe të ujërave nëntokësore nga filtrimet e pakontrolluara të gropave septike.

4.1.1 Infrastruktura e transportit

Propozimet e Planit të Përgjithshëm Vendor synojnë krijimin e një sistemi rrugor të integruar, që të sigurojë aksesueshmëri dhe lidhje në të gjithë territorin e Bashkisë dhe të jetë miqësor me mjedisin. Ndërrhyrjet në sistemin rrugor kanë për qëllim mbulimin e nevojave aktuale dhe të pritshme, përmirësimin cilësor dhe përshtatjen sipas standardeve të infrastrukturës ekzistuese, sigurimin e një shpërndarje të balancuar në territorin e Bashkisë dhe reduktimin e impakteve negative në mjedis. Ndërrhyrje në infrastrukturën në pronësi të autoriteteve të ndryshme nga bashkia mund të kërkojnë rishikimin pjesor të PPV-së.

4.1.1.1 Mënyrat e ndërrhyrjes në sistemin rrugor

Parashikohet ndërrhyrja në sistemin ekzistues rrugor nëpërmjet tri mënyrave:

1. Zgjerimi i rrjetit rrugor nëpërmjet lidhjeve të reja rrugore. Konkretisht propozohen:
 - Devijimi i segmentit të rrugës Tiranë-Hani i Hotit, e cila propozohet të kthehet në rrugë të kategorisë A, gjeometria e së cilës tregohet në hartat përkatëse.
 - Propozohen disa devijime të rrugëve të kategorisë C, pranë qendrave të banuara si psh. ndërtimi i një segmenti të ri në Mjedë, Bushat, Barbullush etj.
 - Propozohet ndërtimi i segmenteve të reja rrugore të kategorisë E, pranë qendrave urbane.
2. Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese. Me rikonstrukcion nënkuptohet çdo ndërrhyrje që i bëhet trupit të rrugës (zgjerim i trupit të rrugës, asfaltimi etj.) për të përmirësuar funksionimin e saj. Disa nga rrugët që propozohen për rikonstrukcion janë:
 - Zgjerimi i segmentit të rrugës Tiranë-Hani i Hotit që kalon në bashkinë e Vau-Dejës, nga rrugë e kategorisë C në rrugë të kategorisë A.
 - Rikonstruksioni i rrugës së kategorisë C, Vau-Dejës – Koman, propozohet edhe shtimi i korsisë së biçikletave përgjatë kësaj rruge.
 - Rikonstruksioni i rrugës së kategorisë C, Vau-Dejës – Bushat – Velipojë, propozohet përmirësimi i segmenteve ekzistuese të kësaj rruge, shtimi i korsive të biçikletave përgjatë gjithë rrugës, si edhe realizimi i segmenteve të reja që mundësojnë lidhjen e Bushatit me Velipojën.
 - Rikonstruksioni i rrugës Vau-Dejës – Vig, propozohet përmirësimi i segmentit ekzistues dhe plotësimi me korsi biçikletash si edhe shtimi i segmenteve të reja rrugore, të kategorisë F me korsi biçikletash.
 - Rikonstruksioni i rrugës, Koman – Ukbibaj, propozohet rikonstruksioni i kësaj rruge si rrugë e kategorisë F si edhe shtimi i korsive të biçikletave.

- Të gjitha rrugët e kategorisë F të cilat sigurojnë lidhjen e qendrave të banuara propozohet ti nënshtrohen rikonstruksionit në segmente të caktuara, sipas nevojës.
- 3. Përmirësimi i rrugëve ekzistuese. Me përmirësim nënkuptohet çdo ndërhyrje që bëhet në rrugë pa ndikuar në trupin e rrugës. Në këtë mënyrë ndërhyrje përfshihet shtimi i korsive të biçikletave paralel rrugës ekzistuese apo shtimi i zonave të gjelbëruara.
- Përmirësimi i aksit Shkodër – Pukë – Kukës.
- Përmirësimi i rrugëve ekzistuese bujqësore.
- Shtimi i korsive të biçikletave.

4.1.2 Rregullat e sistemit rrugor dhe të transportit sipas Kodit Rrugor

4.1.2.1 Përcaktimi dhe përshkrimi i kategorive të sistemit rrugor

Në Kodin Rrugor Shqiptar (Ligj Nr. 8378, dt. 22.7.1998) përcaktohen dhe përshkruhen kategoritë e rrjetit rrugor si më poshtë:

- A- Autostradë – Rrugë interurbane ose urbane me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankinë të shtruar të mundshme në të majtë dhe korsi emergjence, ose bankinë të shtruar në të djathtë, pa kryqëzime në nivel, e pajisur me rrethim dhe sisteme asistence për përdoruesin gjatë gjithë gjatësisë, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor dhe e dallueshme me sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalësimi dhe shpejtimi.
- B- Rrugë interurbane kryesore – Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekt anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor. Për të tjera kategori të mundshme mjetesh të përdoruesve duhet të parashikohen hapësira të përshtatshme. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara, me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalësimi dhe shpejtimi.
- C- Rrugë interurbane dytësore – Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina.
- D- Rrugë urbane kryesore – Të gjitha rrugët me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe një korsi e mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqendruara.

- E- Rrugë urbane dytësore – Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.
- F- Rrugë lokale – Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme të përcaktuar në pikën 1 të nenit 2, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

Shënim: Rrugë bujqësore - term i përdorur për rrugët në shërbim të bujqësisë të cilat mjafton të plotësojnë kushtet minimale për kalimin e mjeteve bujqësore.

4.1.2.2 Hyrje-dalje në rrugë

Kushdo që ndërton në territore që nuk janë përgjatë rrugëve apo shesheve të hapura ku rrugët kanë hyrje-dalje, duhet fillimisht të provojë që ka arritur marrëveshje për hyrje-dalje (akses) të përshtatshme në parcelën e ndërtimit nga rruga ekzistuese publike apo private e hapur për kalimin publik.

4.1.2.3 Rregulla për anërrugët

Në të gjitha përvijimet rrugore duhet të merret parasysh shpërndarja e sipërfaqes së rrugës për të gjithë përdoruesit e saj, duke krijuar sipas parashikimeve hapësira të nevojshme për korsi të dedikuara për transport publik, korsi biçikletash dhe trotuare me të gjithë parametrat teknikë për PAK.

Për ndërtimet ekzistuese e të reja, riparimet, rindërtimet, rikonstrukcionet dhe zgjerimet, brezat e rezervuar për mbrojtjen e rrugës, të matura nga kufiri rrugor, nuk duhet të kenë përmasa më të vogla se ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe në këtë rregullore, sipas tipit të rrugës.

Jashtë qendrave të banuara, në pjesën e brendshme të lakoreve (kthesave) dhe jashtë pronësisë rrugore, duhet të sigurohet një brez i rezervuar me gjerësi të rritur, ku ndalohet çdo tip ndërtimi, rrethimi, të mbjellash ose depozitimi, sipas normave të përcaktuara në aktet në zbatim për gjerësinë e lakores. Në pjesën e jashtme të lakores, brezi i rezervuar është i njëjtë me atë të përcaktuar për pjesën e drejtë të rrugës.

Jashtë qendrave të banuara, në kryqëzimet rrugore në nivel, në pjesën e brendshme të lakoreve (kthesave) duhet të sigurohet një brez i rezervuar me gjerësi të rritur me qëllim sigurimin e fushëpamjes së duhur, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi.

Ndalohen ndërtimet mbi tokë, pranë dhe në brendi të ndërkëmbimeve (kryqëzimeve jo në nivel) që sipas gjykimit të entit pronar të rrugës pengon funksionimin normal të ndërkëmbimit. Gjerësia e brezit të rezervuar për rampat e jashtme (rrugët që bëjnë të mundur këmbimin e drejtimit të lëvizjes), i korrespondon brezit të rezervuar të rrugës me kategori më të ulët që kryqëzohet në ndërkëmbim.

Zotëruesve të terreneve në kufi me pronësitë rrugore, jashtë qendrave të banuara, u ndalohe:

- të hapin kanale, hendeqe dhe të kryejnë çfarëdolloj gjurmimi në terrenet anash rrugëve;
- të ndërtojnë, të rindërtojnë ose të zgjerojnë anash rrugëve objekt ose mure rrethues të çfarëdo tipi dhe materiali në largësi nga kufiri rrugor më të vogël se ato të përcaktuara në aktet në zbatim për çdo tip rruge;
- të mbjellë pemë anash rrugëve, shkurre e të tjera të këtij lloji. Në aktet në zbatim përcaktohen largësitë e ndryshme nga kufiri rrugor në varësi nga llojet e ndalimeve të treguara.

Në të gjitha rrugët dhe pjesët që i përkasin asaj, ndalohe:

- të dëmtohen veprat e artit, të mbjellat dhe impiantet rrugore;
- të ndryshohet forma dhe të zihet sipërfaqja e rrugës ose e pjesëve që i përkasin asaj apo në përgjithësi të krijohen gjendje të rrezikshme për trafikun;
- të dëmtohet, të zhvendoset, të hiqet sinjalizimi rrugor dhe çdo objekt tjetër që i takon asaj;
- të pengohet rrjedhja e lirë e ujërave në kanalet ose hendeqet anësore dhe në veprat përkatëse të grumbullimit dhe shkarkimit të ujit;
- të shkarkojnë në kanale dhe hendeqe, pa leje të rregullt, materiale të çfarëdo lloji ose të kanalizohen në to ujëra të çfarëdo natyre;
- të qarkullojnë kafshë, duke përjashtuar rrugët lokale, sipas normave të parashikuara për lëvizjen e kafshëve;
- të hidhen ose të grumbullohen mbeturina ose materiale të çfarëdo lloji;

Rrethimet dhe të mbjellat në njësitë/zonat pranë rrugëve duhet të realizohen në përputhje me orientimet e Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore në fuqi, me qëllim që të mos pengojnë apo të zvogëlojnë fushëpamjen e nevojshme për sigurinë e qarkullimit rrugor.

4.1.2.4 Rrugë private

Ndërtimi i rrugëve private është subjekt i autorizimeve dhe procedurave të zakonshme të kontrollit për ndërtimin e rrugëve. Për rrugët private duhet të sigurohet:

- një fashë e mjaftueshme toke për trupin e rrugës;
- shtrimi i tyre, nëse autoriteti vendor e shikon të nevojshme;
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të mbledhjes dhe largimit të ujërave të shiut derisa ato të derdhen në kanalizimet publike;
- mirëmbajtja, ndriçimi dhe pastrimi i tyre;
- instalimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës së kërkuar;

4.1.2.5 Parametrat e lëvizjes dhe të transportit publik

Shërbimi i transportit të udhëtarëve organizohet nga strukturat përkatëse të bashkisë Vau-Dejës, në përputhje me Ligjin Nr.8308, dt.18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”, i ndryshuar, Ligjin Nr.8378, dt.22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin Nr.142.dt.20.01.1998 “Për procedurat për marrjen e Lejeve në veprimtari Transporti”, i ndryshuar, V.K.M. Nr. 637, dt.21.05.2008 “Mbi ndryshimin e tarifave të transportit qytetës të Udhëtarëve”, Ligjit Nr.7582.dt.13.07.1992. “Për ndërmarrjet shtetërore”, Ligjin Nr.7961.dt.12.07.1995.”Kodi i Punës”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me udhëzime të tjera të fushës së transportit që në thelb kanë disiplinimin e parametrave tekniko - ekonomik që operatorët duhet të plotësojnë në lidhje me kushtet e kryerjes së shërbimit.

4.1.2.6 Brezat e rezervuara jashtë dhe në qendrat e banuara

Sipas VKM nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”:

“Largësia nga kufiri rrugor jashtë qendrave të banuara e cila duhet respektuar kur hapen kanale, gropa apo kur kryhet çdo lloj gërmimi anash rrugëve, nuk mund të jetë më e vogël se thellësia e kanaleve, gropave apo gërmimeve dhe, në çdo rast, nuk mund të jetë më pak se 3 m.

Jashtë qendrave të banuara, siç është përcaktuar në drejtimet e nenit 4 të Kodit Rrugor, por brenda zonave të parashikuara për të bërë ndërtime apo që ndryshojnë nga plani urbanistik i përgjithshëm, në rastet kur plani në fjalë është i miratuar për zbatim të drejtpërdrejtë, ose edhe kur për këto zona janë kryer plane urbanistike në zbatim, largësitë e kufirit rrugor, që duhen respektuar në ndërtimet e reja, në rindërtimet në vazhdim, shembjet e plota apo bë zgjerimet përballë rrugëve, nuk mund të jenë më pak se:

- a) 30 m për rrugët e tipit A
- b) 20 m për rrugët e tipit B
- c) 10 m për rrugët e tipit C

Për largësitë nga kufiri rrugor, që duhen respektuar në qendrat e banuara, të ndiqen rregullat e vendosura në Nenin 37 të Rregullores Vendore.”

4.1.2.7 Sinjalizimi rrugor

Fusha e zbatimit të normave, që lidhen me sinjalet rrugore, shtrihet në rrugët publike dhe në rrugët që përshihen në zonat e porteve, aeroporteve, autoporteve, universiteteve, spitaleve, varrezave, kazermave dhe fushimeve ushtarake, si dhe në zonat e tjera shtetërore, të hapura për përdorim publik.

Sinjalet janë të detyrueshme edhe në rrugët dhe në zonat e hapura për përdorim publik si rrugë private, zona stabilimentesh dhe fabrikash, banesash, parqesh të autorizuara ose ngastrash toke dhe duhet të jenë në përputhje me ato të vendosura nga këto norma; në rrugë të tilla, nëse ato nuk janë të hapura për përdorim publik, sinjalet janë fakultative, por nëse përdoren, duhet të jenë në përputhje me ato të vendosura me rregullore.

4.1.3 Kushtet teknike – dimensionimi i seksionit të rrugës

Rruga është pjesë e sipërfaqes e përcaktuar për përdorim publik për qarkullimin e mjeteve motorike ose jo, këmbësorëve dhe kafshëve. Sipas përdorimit të rrugës, përcaktohen kritere për projektimin e karakteristikave gjeometrike dhe funksionale të rrugës, dhe si rezultat i të cilave, kategorizohen rrugët.

Rrugë e kategorisë A, me karrexhata të pavarura, me dy korsi lëvizje 3.75m, korsi emergjence 3m dhe bankina të pashtuara 1.5m.




Fig. 16 Rrugë e kategorisë A

Rrugë e kësaj kategorie, në bashkinë e Vau-Dejës është propozuar të kthehet segmenti i rrugës Tiranë – Hani i Hotit.

Rrugë e kategorisë C, rrugë me një karrexhatë, me dy korsi lëvizje për sens me gjerësi minimale 3.5m dhe bankina të shtruara, minimumi 1m dhe korsi biçikletash me gjerësi totale 3m.




Fig. 17 Rrugë e kategorisë C + korsi biçikletash

Sipas VKM 628 dt. 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve” rrugët e kategorisë C nuk janë më të vogla se 9m (C3) por jepet dhe një tip tjetër rruge e kategorisë C, konkretisht C1, rrugë me dy korsi nga 3.75m dhe bankina të shtruara 1.5m.




Fig. 18 Rrugë e kategorisë C

Rrugët e kategorisë C, janë segmente rrugore në administrimin e ARrSh-së. Në Bashkinë Vau-Dejës, të tilla, propozohen disa akse, konkretisht: Vau-Dejës – Koman, Vau – Dejës – Bushat – Velipojë, Shkodër – Vau-Dejës – Pukë.

Rrugë e kategorisë E, rrugë me dy korsi për sens nga 3m, bankina të shtruara nga 0.5m, trotuare 1.5m. Këto rrugë propozohen për të gjitha qendrat urbane të Bashkisë Vau-Dejës.




Fig. 19 Rrugë e kategorisë E

Rrugë të kësaj kategorie propozohen të gjitha rrugët në qendrat urbane të Bashkisë së Vau-Dejës. Në disa segmente propozohet që rrugët urbane të përmirësohen duke shtuar pista biçikletash si vazhdim të itinerarit përkatës të treguar në harta për lëvizjen me biçikleta.




Fig. 20 Rrugë e kategorisë E + korsi biçikletash

Rrugë e kategorisë F, rrugë me dy korsi për sens nga 3.25m, bankina të shtruara nga 1m.




Fig. 21 Rrugë e kategorisë F

Janë parashikuar dhe rrugë të tipit F, me korsi nga 3.25m dhe bankina të shtruara nga 1m dhe korsi biçiklete 2.5m me bankina të shtruara 0.5m. Më poshtë jepet një prerje tip e kësaj rruge.




Fig. 22 Rrugë e kategorisë F + korsi biçikletash

Në të gjitha rastet kjo rrugë parashikohet me breza të gjelbër. Ndërmjet rrugës automobilistike dhe rrugës së biçikletave minimumi një brez 1.5m i gjelbëruar dhe në të dy krahët breza të gjelbëruar sipas mundësisë konkrete të realizimit.

4.1.4 Parametra të tjerë, skema e lëvizjes dhe transporti publik

Në bashkinë e Vau-Dejës propozohet kthimi i rrugës Tiranë – Hani Hotit në rrugë të kategorisë A, duke e devijuar si segment në zonën nga kryqëzimi i Bushatit në drejtim të kufirit me Shkodrën. Kjo zonë e mbetur do të funksionojë si rrugë industriale. Në të dy anët e rrugës ekzistuese propozohet të shtohen, breza të gjelbëruar me gjerësi 10m, trotuare nga 2m dhe një pistë biçikletash me gjerësi 3m. Këto përmirësime do të shërbejnë për të aksesuar më lehtë zonën industriale në të dy krahët e rrugës.




Fig. 23 Rruga industriale nga kryqëzimi i Bushati drejt kufirit me Shkodrën

Plani i përgjithshëm vendor për Bashkinë e Vau-Dejës, synon të promovojë lëvizjen e qëndrueshme dhe në harmoni me mjedisin. Në funksion të kësaj është propozuar dhe lidhje e territorit me pista biçikletash si dhe realizimi i një korridori të gjelbër në Bashkinë Vau-Dejës përgjatë lumit Gjadër. Më poshtë jepen disa prerje tipike.




Fig. 24 Korridor i gjelbër




Fig. 25 Pista për biçikleta

Për sa i përket lëvizjes së banorëve në Bashkinë e Vau-Dejës, sugjerohet përdorimi i transportit publik nëpërmjet disa linjave të propozuara urbane. Konkretisht:

- Linja 1 (Vau-Dejës – Hajmel – Pistull – Bushat – Stajkë – Mjedë – Vau-Dejës);
- Linja 2 (Bushat – Barbullush – Kukël – Fshat i Ri – Rranxë – Melgush – Ashtë – Bushat);
- Linja 3 (Fillon në Nënshatë - Hajmel Vau-Dejës – Karmë dhe përfundon në Koman);
- Linja 4 (Vau-Dejës – Mnelë e Madhe - Vig);
- Linja 5 (Koman – Ukbibaj);
- Linja e tragetit Vau-Dejës – Koman;
- Linja e tragetit Koman – Fierzë.

Shërbimi i transportit të udhëtarëve organizohet nga strukturat përkatëse të bashkisë Vau-Dejës, në përputhje me Ligjin Nr.8308, dt.18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”, i ndryshuar, Ligjin Nr.8378, dt.22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin Nr.142.dt.20.01.1998 “Për procedurat për marrjen e Lejeve në veprimtari Transporti”, i ndryshuar, V.K.M. Nr. 637, dt.21.05.2008 “Mbi ndryshimin e tarifave të transportit qytetës të Udhëtarëve”, Ligjit Nr.7582.dt.13.07.1992. “Për ndërmarrjet shtetërore”, Ligjin Nr.7961.dt.12.07.1995.”Kodi i Punës”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me udhëzime të tjera të fushës së transportit që në thelb kanë disiplinimin e parametrave tekniko - ekonomik që operatorët duhet të plotësojnë në lidhje me kushtet e kryerjes së shërbimit.

4.2 NDIKIMI I PLANEVE TE TJERA

Territori i bashkisë Vau-Dejës përfshihet në disa nga programet dhe projektet strategjike të Planit Kombëtar. Vau-Dejës është qendër urbane terciare e polit të zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë. Qendrat urbane terciare karakterizohen nga funksione dhe shërbime bazë.

Vau-Dejës karakterizohet nga ekonomia e lidhur kryesisht me bujqësinë, dhe me një perspektivë të mirë të zhvillimit të turizmit historik dhe natyror. Me karakterin që ka sot, Vau-Dejës mbështet zhvillimin e polit rajonal Shkodër – Lezhë, dhe falë pozicionit gjeografik, luan roline e portës perëndimore për të aksesuar Alpet shqiptare.

Bashkia Vau-Dejës është pjesë e këtyre Projekteve strategjike, të propozuara nga PPK, në kontekstin ballkanik dhe më gjerë:

- Korridori i Gjellbër - Realizimi i lidhjes midis Malit të Zi dhe Greqisë nga Hani i Hotit në Shkodër dhe Gjirokastrë përmes pikës kufitare të Kakavijës, me një gjatësi prej 405 km
- Rruga peisazhistike Blu (kalon tangent në veriperëndim të territorit) - rrugë bregdetare turistike me impakt të ulët mjedisor, që lidh lokalitetet e bregdetit: Velipojë – Shëngjin, Shëngjin – Patok, Patok – Durrës, Durrës – Divjakë, Divjakë – Seman, Seman – Vlorë, Vlorë – Dhërmi, Dhërmi – Sarandë, Sarandë – Butrint)
- Rruga Shkodër – Vau-Dejës – Pukë – Kukës – Prishtinë e cila është një alternativë mjedisore dhe turistike për lidhjen e Prishtinës me bregdetin e Velipojës apo të Shëngjinit

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës kalojnë Korridoret energjetike të mëposhtme:

- IAP- Ionian Adriatik Pipeline do të kalojë në pjesën perëndimore të Shqipërisë, nga Fieri në Shkodër për të furnizuar Malin e Zi, Bosnjën e Kroacisë.
- IAP-KOSOVË. IAP degëzohet në rajonin Shkodër- Lezhë, për të furnizuar Kosovën nëpërmjet Kukësit duke realizuar Unazën Perëndimore të Ballkanit (Western Balkan Rings - WBR).

Ndër projektet më të rëndësishëm, që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar janë:

Referuar sistemit natyror, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Shpallja dhe promovimi i parkut kombëtar të Alpeve si park me rëndësi rajonale dhe hartimi i politikave dhe instrumenteve financiare për nxitjen e zhvillimit të turizmit malor.

Referuar sistemit ujor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Përcaktimin e Vijës Blu dhe respektimin strikt të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi dhe

Rregullores së Planifikimit të korrikut 2015, në mënyrë që të mbrohet ekosistemi natyror i zonës.

- Qendrat primare dhe sekondare duhet të pajisen me impiant të trajtimit të ujërave të ndotur, përpos 3 impianteve ekzistues/të planifikuar Shkodër, Lezhë - Shëngjin dhe Velipojë, në mënyrë që brenda vitit 2030 të mos derdhen më ujëra të zeza në lumenj, det dhe të rritet cilësia e baseneve.
- Itinerarin turistik vozitës lumor - liqenor, duke integruar vozitjen dhe lundrimin në një rrjet rekreativ: Vau-Dejës - Liqeni i Shkodrës - Pulaj - Ishulli i Bojanës.

Referuar sistemit bujqësor:

- Krijimin e një tregu rajonal bujqësor, i cili do të plotësonte zinxhirin ekonomiko-bujqësor në agro-përpunimin e produkteve bujqësore.

Në lidhje me Infrastrukturën e transportin:

- Zhvillimin e qendrës primare të Shkodrës dhe Lezhës si dy qytete-porta, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugëve kombëtare që ofrojnë, si dhe zhvillimin e qendrave Bajzë, Koplik, Laç si hub-e logjistike, për rolin kryesor, pozicionin kufitar që kanë si pika grumbullimi të produkteve bujqësore dhe stacione me rëndësi për njerëz dhe mallra.
- Përmirësimin e kushteve dhe fuqizimin e kapacitetit akomodues të portit të Shëngjinit si nyje shumë e rëndësishme për polin ekonomik Shkodër – Lezhë
- Integrimin dhe funksionimin me kapacitet të plotë sipas modaliteteve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Hani i Hotit, Bajzë, Koplik, Grilë, Milot si stacione mallrash; Shkodër, Lezhë si stacione qendrore, si dhe rigjallërimin e stacioneve për pasagjerë, Mjedë, Baqël, Laç, Gjorm, Mamurras.
- Itinerarin peizazhistik blu në këtë zonë, përgjatë qendrave: Ulqin - Velipojë - Shëngjin - Lezhë – Kune-Vain, të paraprirë nga projektet strategjike të MTI-së dhe MM-së.
- Në përputhje me OST-në, ndërtimin e nënstacioneve të reja në Koman dhe Lezhë. Në këtë të fundit janë parashikuar të kalojnë edhe linjat 400 dhe 220kV që do të lidhin Shqipërinë me Kosovën dhe me Malin e Zi.
- Ndërtimin e parkut energjetik, i cili do të përbëhet nga dy parqe eolike dhe një termocentral biomasë me kapacitet vjetor prodhimi përkatësisht 1.1 Twh dhe 750 Gwh.
- Vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative, duke synuar që rrezatimi prej 2700 orë/vit të shfrytëzohet në ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

4.3 SHERBIMET SOCIALE, TIPOLOGJIA DHE RREZET E MBULIMIT

4.3.1 Tipologjia

Bazuar në objektivat e synuara për popullsinë e vendbanimeve për vitin 2030, u bë një vlerësim i nevojave në të ardhshmen lidhur me shërbimet e infrastrukturës, të tilla si

- njësitë arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe, arsim profesional)
- mirëqenia sociale
- terrenet sportive
- qendrat kulturore
- mjediseve publike (parqe, ishuj gjelbërimi, kënde lojërash, etj.)
- hapësira parkimi publik
- shërbim shëndetësor (qendra shëndetësore, konsultore, ambulanca, etj.)

Vlerësimi i nevojave të të ardhmes është bazuar në këta faktorë

- legjislacioni përkatës (numri i njësive sipas madhësisë të përcaktuar të popullsisë, standardet etj.),
- strategjia e propozuar e zhvillimit hapësinor (prioritetet, zonat e propozuara për zhvillim, etj.)
- Shpërndaja e popullsisë

Po kështu e rëndësishme është situatë aktuale, niveli i shfrytëzimit dhe i mirëmbajtjes së strukturave ekzistuese, mënyra e shpërndarjes dh rrezet e shërbimit në hapësirë e nivel popullsie. Në shpërndarjen e re, është synuar mjaftueshmëria e strukturave të dobisë dhe përdorimit të përbashkët që do t'ju shërbejnë sa më shumë vendbanimeve si dhe përmirësimit të nivelit të shërbimeve sociale. Propozimi fillestar i PPV-së është formuluar bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e planifikimit, standardet dhe rregullimet e tjera të përcaktuara në VKM 671/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".
- strukturat e ndërtuara, distancat dhe periudhat kohore dhe relievi gjeografik
- lidhjet rrugore / veprat rrugore të propozuara.
- madhësitë ekzistuese dhe të parashikuara të popullsisë.

Si pjesë e një qasjeje-aksesi gjithëpërfshirës janë marrë parasysh të gjitha sa më lart dhe u bë një përpjekje për të kombinuar kriteret bazuar në ligj dhe fakte.

Duke u përpjekur për të pajtuar numrin teorik të njësive me atë real, propozojmë bashkimin e disa shkollave (sidomos shkollave 9- vjeçare të cilat janë edhe më të shumtat) dhe shërbimit të nxënësve nga shkolla të përzgjedhura ekzistuese propozohet të mbahen ato që janë më të centralizuara në lidhje me grupin e vendbanimeve të shërbyera, në një hapësirë më të gjere dhe një gjendje më të mirë etj.

Mjaft prej shkollave ekzistuese ose i shërbejnë një numri të vogël nxënësish ose kanë kapacitet mesatar. Besojmë se bashkimi do të çojë në njësi me numër të rëndësishëm nxënësish që mund të përmirësohen dhe të grumbullojnë një masë të rëndësishme të strukturave plotësuese dhe shërbimeve arsimore respektive. Bashkimet propozohet të implementohen në një periudhë afatgjatë pasi të përmirësohet rrjeti rrugor dhe të zhvillohet mjaftueshëm transporti brenda Bashkisë.

Objektet shkollore ekzistuese që pas bashkimit, dhe me kalimin e kohës do të pushojnë së funksionuari, mund të përdoren për një gamë të gjerë shërbimesh sociale. Në varësi të nevojave të komuniteteve lokale dhe në raport me mundësitë e mirëmbajtjes apo të përmirësimit të potencialit të ndërtesave, në të ardhmen mund të transformohen në hapësira për t'i shërbyer shoqatave dhe eventeve kulturore, njësive të mirëqenies sociale, etj. Gjithashtu, kopshtet dhe shkollat 9- vjeçare që propozohet të shfuqizohen, në disa vendbanime mund të strehojnë respektivisht çerdhe që do të propozohen.

U bë gjithashtu edhe një regjistrim i ndërtesave dhe vendeve fetare ekzistuese, strukturave sociale dhe ndërtesave administrative. Duke pasur parasysh mungesat në hapësirat kulturore dhe njësitë e mirëqenies sociale, rekomandojmë krijimin e qendrave / hapësirave kulturore dhe strukturave sociale (p.sh. qendrave rinore, qendrave për fëmijë ose të moshuar) me prioritet vendbanimet me popullsi më të madhe, të cilat do të grumbullojnë edhe shumicën njësive shkollore.

Për sa i përket hapësirave të gjelbra, terreneve sportive dhe parkingjeve, është bërë një vlerësim i nevojave në të ardhmen për tokë në bazë të popullsisë të synuar dhe standardeve të tokës. Duke pasur parasysh mangësitë ekzistuese, propozohet pajisja e të gjitha vendbanimeve me parkingje, terrene sportive dhe mjedise publike.

Lidhur me nevojat për kujdes mjekësor rekomandojmë pajisjen me ambulanca (qendra të ofrimit të ndihmës së parë) të vendbanimeve që nuk kanë sot (më te shumtat kanë), por bën përjashtim zona malore, e cila për strukturën e saj me dendësi shumë të ulët do të duhet ta marrë këtë shërbim në qendrën lokale më të afërt.

Përsa i përket cilësisë së infrastrukturës ekzistuese sociale, vërejmë se në përgjithësi është nën mesataren. Gjendja e objekteve shkollore në vendbanimet urbane është më e mire dhe në mjaft raste ndërtohen edhe shkolla të reja, kurse në pjesën rurale të bashkisë, gjendja lë për të dëshiruar. Në parashikimin e bazuar në rritjen e popullsisë në vitet e ardhshme dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve arsimore, propozohet përmirësimi i përgjithshëm estetik dhe funksional i stokut të ndërtesave shkollore.

4.3.2 Shpërndarja në territor

Popullsia e synuar e planifikuar është 41 000 banorë dhe shpërndahet në qendrat e banuar dhe njësitë ekzistuese. Në bazë të saj llogariten nevojat në të ardhmen për tokë në bazë të standardeve të tokës (neni 83, VKM 671/2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”) dhe ilustruhet në mënyrë skematike propozimi që i referohet katër niveleve të arsimit dhe ish komuniteteve lokale. Atje ku janë vëzhguar mangësi, konkretisht në çerdhe dhe në shkollat e mesme, propozohen njësi të reja duke kombinuar raportin njësi/ popullsi (VKM 671/2015 - neni 83), me vendndodhjen e vendbanimeve dhe rrezet e shërbimit.

Në shumicën e rasteve toka e propozuar është treguese, analoge me popullsinë e synuar dhe do të finalizohet dhe lokalizohet në kuadër të studimeve të specializuara. Një disa raste propozimi është konkret dhe i treguar në hartë. Propozimet konkrete janë shprehur në bashkëpunim me bashkinë Vau-Dejës, duke u mbështetur në projekte paraprake dhe me tendencën për t’u zhvilluar në troje publike, ose në territore me prioritet zhvillimi.

4.3.3 Rrezet e mbulimit

Lidhur me rrezen e shërbimit të fëmijëve / nxënësve, ato përcaktohen në nenin 83 të VKM 671/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", në nivel shkolle dhe me dallim në zonat urbane dhe rurale.

Për çerdhet përcaktohet rrezja 200-300m, për Kopshtet 250-350m (zonat urbane) dhe 500-600m (zonat rurale), për Shkollat 9- vjeçare 500-600m (zonat urbane) dhe 1000-1500m (zonat rurale) dhe për Shkollat e Mesme 1000-1500m (zonat urbane) dhe 2000-4500m (zonat rurale).

Kriteri i rrezes të shërbimit bashkëvlerësohet në programimin e përgjithshëm, në kontekstin e kombinimit optimal të të gjitha parametrave dhe në përshtatjen e rrethanave dhe nevojave ekzistuese. Është e qartë që në kushtet e shpërhapjes urbane me dendësi shumë të ulët, rrezet e shërbimit funksionojnë mirëfillti vetëm në qendrat urbane, kurse për territoret me intensitet të ulët numri i objekteve të shërbimit është në bazë popullsie ekzistuese dhe të parashikuar.

Rrezja maksimale respektohet në vija të përgjithshme. Në rastet kur popullsia e shërbyer është e vogël dhe distancat të mëdha dhe preferohen bashkimet e propozuara, i jepet rëndësi krijimit të njësive të qëndrueshme, madje edhe me rreze më të madhe të ofrimit të shërbimeve.

5 PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIMIN E PPV

5.1 PROJEKTET E ZHVILLIMIT

5.1.1 Identifikimi dhe hartëzimi i projekteve

Ne këtë plan projektet strategjike janë ndare në dy kategori: projektet bazë dhe projektet e zhvillimit. “Projektet bazë” janë ato projekte të cilët janë të domosdoshëm për t’i krijuar sistemit lokal kushtet fillestare për zhvillimin e mëtejshëm dhe kanë të bëjnë me plotësimin e kushteve minimale për efikasitetin e sistemit territorial. Nga ana tjetër, “projektet e zhvillimit” janë ato projekte të cilëve plani u ngarkon detyrën për dhënien e shkëndijës së parë të proceseve të zhvillimit të sistemit territorial dhe social-ekonomik.

Ne kategorinë e projekteve bazë hyjnë ato ndërhyrje të cilat duhet të jenë pjesë e politikave rutinë të financimeve publike: pra bëhet fjalë për projekte jo të jashtëzakonshme dhe realizimi i tyre duhet të bazohet në fondet e zakonshme të financimit nga ana e shtetit dhe bashkisë. Është e vështirë, si rrjedhojë e natyrës së tyre, që këto projekte të mund të paraqiten në hartë apo të mund të përlogaritet vlera e tyre.

Projektet e zhvillimit, nga ana tjetër, janë ato të cilët kanë një përmbajtje më të fortë strategjike: ato duhet të konsiderohen si ndërhyrje të “jashtëzakonshme” dhe, për këtë, duhet të mbështeten në politika “shtesë” të qeverisë. Brenda kësaj kategorie projektesh duhet bërë një zgjedhje prioritesh në mënyrë që të mund të vazhdohet me programimin e investimeve të nevojshme.

Hartëzimi i projekteve të zhvillimit është më i lehtë dhe i realizueshëm, pasi shpeshherë bëhet fjalë për ndërhyrje të lokalizuara, edhe pse në disa raste mund të parashikojnë ndërhyrje të shpërhapura që nuk paraqiten dot në hartë. Vendosja në hartë e projekteve të zhvillimit, gjithsesi, duhet të konsiderohet thjesht si udhëzuese, duke qenë se paraqesin një projekt që është në nivelin e projekt-idesë, aq më tepër në një moment fillestar të fazës së konsultimit me entet lokale dhe mbajtësit e interesit (*stakeholder*). Një përkufizim më i përpikët i projekteve strategjike të zhvillimit do të jetë i mundur vetëm pas përcaktimit të prioriteteve të programimit.

Për sa me sipër, paraqitja e një vlerësimi paraprak të prioriteteve teknike në zbatimin e projekte bëhet nëpërmjet ndarjes së projekteve të zhvillimit në tre fasha kohore:

1. Projekte të realizueshme në një periudhë kohore të shkurtër (afat-shkurtër)
2. Projekte të realizueshme në një periudhë kohore të mesme (afat-mesëm)
3. Projekte të realizueshme në një periudhë kohore të gjatë (afat-gjatë)

Periudha “afat-shkurtër” nënkupton nga 1 deri në 5 vite, “afat-mesëm” nga 6 nga në 10 vite dhe “afat-gjatë” me shumë se 10 vite.

Kriteret për klasifikimin e projekteve në fashën afat-shkurtër janë:

- Mundësia e ndërhyrjes se menjëhershme (disponimi i tokës, disponimi i teknologjive, qartësia e procedurave etj.);
- Disponimi ose mundësia e gjetjes se shpejtte të resurseve financiare (te cilat mund të jene si publike ashtu edhe private)
- Mos-ekzistenca e kundërshtive ose arritja i shpejtte e konsensusit (pra, përjashtohen te gjitha projektet për te cilat mbajtësit e interesit (stakeholders) kanë kundërshti ose opinione te ndryshme)

Projekteve të zhvillimit afatshkurtër mund edhe t’iu jepet roli i “projekteve pilot” (përveç rolit “prioritar”). Në këtë rast bëhet fjalë për projekte që parashikojnë ndërhyrje shembullore që kanë për qëllim promovimin e idesë se zhvillimit: projekte që janë të afta të tregojnë në mënyrë të komunikueshme dhe bindëse efektin virtuoze të projekteve të zhvillimit.

5.1.2 Projektet e zhvillimit dhe ato pilot

“Projektet e zhvillimit” janë projektet të mirëfillta me karakter strategjik, të cilave plani kërkon t’iu caktojë detyrën e nisjes së proceseve të zhvillimit të sistemit territorial dhe atij socio-ekonomik.

Bëhet fjalë, në përgjithësi, për projekte që kanë disa karakteristika bazë: i) janë të lidhura ngushtë me potencialin që plani i njeh kontekstit të konsideruar; ii) kanë një rëndësi të lartë dhe aftësi të mëdha nxitëse; iii) prej tyre pritët një impuls i fortë në ndihmë të proceseve të zhvillimit.

Këto projekte përfaqësojnë përgjigjen operative ndaj drejtimit që plani sheh si potencial (ose kërkon të zhvillojë) në një territor të caktuar: i japin forcë potencialeve ekzistuese ose të evidentuara në kontekstin lokal. Është kjo arsyeja pse këto projekte janë të rëndësishme dhe me peshë të madhe, si nga pikëpamja e përqendrimit të resurseve, ashtu edhe nga ajo e pritshmërisë së zhvillimit.

Për shkak të natyrës së tyre të veçantë, këto projekte nuk mund të jenë të shumtë në numër, për të njëjtin territor. Situata me optimale do të ishte që, për secilin kontekst bashkiak, plani të përcaktojë pak ndërhyrje, pra ato që cilësohen si më prioritare nga administratorët lokalë dhe palët e interesit.

Në kuadër të kësaj kategorie të projekteve, është e domosdoshme të identifikohen ata që kanë për detyrë të shfaqin, me fakte, potencialet e zhvillimit të identifikuar për territorin

përkatës ("projektet pilot" "projektet prioritare"). Këto ndërhyrje, janë të lidhura ngushtë me strategjinë e zhvillimit të identifikuar për zonën në studim, por janë të një përmase më të vogël, edhe pse me domethënie dhe ndikim të fortë komunikues. Karakteristika kryesore e këtyre projekteve është, që të realizohen shpejt dhe me pak fonde: bëhet fjalë kryesisht për projekte demonstruese, për të cilat nuk është e nevojshme që të ketë shpenzime të mëdha kapitale, ndërkohë që është e rëndësishme të jenë në gjendje të nisin menjëherë, dhe të jenë në gjendje të tregojnë, sa më shpejt, në kohë të shkurtër, frytet e veprimeve të zhvillimit të identifikuara në planin e propozuar.

5.2 PLANI I VEPRIMIT

Në prill të vitit 2009, Shqipëria paraqiti kërkesën zyrtare për pranim në Bashkimin Evropian (BE), gjë që shënoi nisjen e një procesi që çoi Këshillin e Bashkimit Evropian, në qershor të vitit 2014, t'i japë vendit statusin 'kandidat' për në BE. Duke u mbështetur në këtë status, Shqipëria mund të marrë financimet e parashikuara nga Plani i Ndërhyrjeve për fazën e dytë, ajo e Para-Pranimit (IPA II - Instrument for Pre-accession Assistance). Ky plan, që bën pjesë në Politikën e Pranimit në Bashkimin Evropian, përfshin periudhën 2014-2020 dhe vë në dispozicion një buxhet prej 11.7 miliardë euro për ndërhyrjet në pesë nga fushat e mëposhtme:

- mbështetje në tranzicion dhe përforsim të institucioneve nëpërmjet reformave të Administrimit Publik;
- bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet shteteve pjesëtare të UE dhe vendeve të tjera të pranueshme në IPA (Maqedoni, Turqi, Shqipëri, Mal i Zi, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë);
- zhvillim rajonal, në aspektin e zhvillimit ekonomik, të transportit dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- zhvillimi i burimeve njerëzore dhe luftë kundër përjashtimit dhe varfërisë;
- zhvillimi rural dhe i sistemeve bujqësore.

Në dhjetor të vitit 2014 Bashkimi Evropian ka lëshuar një dokument që përditëson udhëzimet për Analizat Kosto-Përfitim (CBA – Cost Benefit Analysis), të përcaktuara më parë nga BE në 2003 dhe në 2008 duke iu referuar IPA-s së parë, të cilat janë kërkesa për të hyrë në bashkë-financimin e Programeve Operative të Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF – European Regional Development Fund) dhe Fondin e Kohezionit.

(http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/studies/pdf/cba_guide.pdf)

Metodat e analizës financiare dhe ekonomike të Analizave Kosto-Përfitim (CBA) të përcaktuara në këto udhëzime, dhënë shkurtimisht më poshtë, janë ato të cilave në do t'u përmbahemi në analizën financiare dhe ekonomike të projekteve që do të jenë pjesë e Planit të Veprimit të kësaj PPV-je.

5.2.1 Fazimi i zhvillimit dhe projektet prioritare

Për të kuptuar më mirë renditjen e objektivave strategjike për zhvillimin e territorit të Bashkisë Vau-Dejës dhe marrëdhënien mes tyre, është përpiluar skema e mëposhtme.

Table 11 Shtrirja kohore e projekteve strategjike

OB.	PROG.	PROJEKTET	AFATI		
			Shkurtër	Mesëm	Gjatë
1- PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	1.1.1 Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale			
		1.1.2 Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë			
		1.1.3 Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve			
		1.1.4 Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike			
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	1.2.1 Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane			
		1.2.2 Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit			
		1.2.3 Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmbytjet			
	1.3 Shërbimet publike	1.3.1 Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit)			
		1.3.2 Shërbimi i autobusëve shkollorë			
		1.3.3 Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara			
		1.3.4 Qyteti mik i fëmijëve			
2- LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	2.1.1 Përmirësim i rrugës Shkodër – Pukë – Kukës			
		2.1.2 Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve			
		2.1.3 Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës – Bushat-Velipojë - Shëngjin			
		2.1.4 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman	Priorit.		
		2.1.5 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Vig			
		2.1.6 Përmirësim i rrugës Koman-UkBibaj			
		2.1.7 Realizimi i bypass-it të Vau-Dejës			
		2.1.8 Rehabilitim i urës Hajmel			
	2.2 Korridori lumor	2.2.1 Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman	Priorit.		
		2.2.2 Lidhja rrugore e stacioneve të tragetit me fshatrat			
		2.2.3 Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi			
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen	2.3.1 Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë			
		2.3.2 Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Mjedë dhe Hajmel			

3- QENDRAT URBANE		2.3.3 Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel			
		2.3.4 Realizim i pistave të biçikletave			
	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	3.1.1 Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës / Mjedë)			
		3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)	Priorit.		
	3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	3.2.1 Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës	Priorit.		
		3.2.2 Zhvillim i qendrës urbane Mjedë			
		3.2.3 Zhvillim i qendrës urbane Bushat	Priorit.		
		3.2.4 Zhvillim i qendrës urbane Rranxë			
		3.2.5 Zhvillim i qendrës urbane Barbullush			
		3.2.6 Zhvillim i qendrës urbane Koman			
		3.2.7 Zhvillim i qendrës urbane Hajmel			
		3.2.8 Zhvillim i qendrës urbane Nënshatë			
		3.2.9 Zhvillim i qendrës urbane Ashtë			
		3.2.10 Zhvillim i qendrës urbane Kosmaç			
		3.2.11 Zhvillim i qendrës urbane Vig			
		3.2.12 Zhvillim i qendrës urbane Benë			
	3.3 Rikualifikimi urban	3.3.1 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës	Priorit.		
		3.3.2 Rikualifikim i qendrës urbane Bushat			
4- TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	4.1.1 Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik			
		4.1.2 Lidhje funksionale me Planin e Alpeve nëpërmjet ndërhyrjeve për zhvillimin e ekskursionizmit dhe sporteve ujore			
		4.1.3 Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit përgjatë liqenit			
		4.1.4 Realizimi i një korridori të gjelbër në lumin Gjadër			
		4.1.5 Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit			
	4.2 Turizmi kulturor	4.2.1 Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Vig – Sapë – Danjë – Sardë – Koman	Priorit.		
		4.2.2 Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit			
		4.2.3 Realizim i një itinerari për turizmin energjetik			
		4.2.4 Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale dhe ansambleve urbane			
		4.2.5 Projekt ndriçimi skenografik i kështjellave (Sapë, Danjë, Sardë)			

5- BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	4.2.6 Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës			
		4.3.1 Realizim qendrash për agro - turizëm dhe turizëm eno - gastronomik			
		4.3.2 Projekt për pyllëzimin mjedisor të kodrës së Zefjanës			
		4.3.3 Projekt për brandimin e prodhimeve lokale			
		4.3.4 Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit			
	5.1 Strukturat e shërbimit	5.1.1 Realizimi i qendrave agro - ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit.	Priorit.		
		5.1.2 Zona tregtare me prodhime me km zero			
		5.1.3 Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmbytjeve në zonat malore.			
		5.1.4 Organizimi i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë.			
		5.1.5 Nxitja e shoqërizimit të punës, domosdoshmëri për rritjen e prodhimit bujqësor.			
		5.1.6 Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gështenjën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal.			
	5.2 Rritja e prodhimtarisë	5.2.1 Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehte			
		5.2.2 Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat dhe Vau-Dejës			
		5.2.3 Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejës			
		5.2.4 Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë.			
		5.2.5 Zhvillimi i baxhoje në Hajmel dhe Vig-Mnelë			
		5.2.6 Zhvillimi i vreshtave në Hajmel ,Bushat, Vau-Dejës, Vig –Mnelë			
		5.2.7 Asistence Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale): • Kultivimi i perimeve në sera • Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit.	Priorit.		
		5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok.	Priorit.		

		5.2.9 Park bletësh në Shllak dhe Temal			
6- ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	6.1.1 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike			
		6.1.3 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës			
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë	6.2.1 Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës			
		6.2.2 Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik			

Përveç zhvillimit në faza të projekteve strategjike, gjithashtu është përcaktuar një rend i zhvillimit në kohë të territorit. Këtu janë marrë në konsideratë nevojat imediate dhe hierarkia urbane si dy ndër aspektet prioritare për fazimin e zhvillimit.

Zhvillimi afatshkurtër në 5 vitet e para do të përqendrohet në të gjitha ato zona që:

- Kanë dendësinë më të lartë të popullsisë
- Qendrat e banimit kryesore (Vau-Dejës, Bushat)
- Poli i zhvillimit bujqësor Bushat – Rranxë
- Zona me potenciale të larta të zhvillimit turistik (itinerari turistik Sapë – Danjë – Sardë - Koman)
- Zonat e prekura nga projektet pilot dhe ato prioritare
- Infrastrukturen primare

Zhvillimi afatmesëm në 5 vjeçarin e dytë do të përqendrohet në:

- Lokalitetet kryesore (Mjedë, Rranxë, Hajmel, Nënshatë, Barbullush, Koman, Ashtë, Kosmaç, Mnelë e Madhe, Benë)
- Zonat e zhvillimit ekonomik
 - Bushat
 - Mjedë
- Poli i zhvillimit të transportit multimodal Vau-Dejës - Mjedë
- Intensifikimin e shërbimeve në qendrat kryesore rurale
- Infrastrukturën sekondare

Zhvillimi afatgjatë do të përfshijë të gjitha zonat e tjera duke synuar kryesisht:

- Realizimin e objektivave strategjike të PPV
- Realizimin e projekteve të zhvillimit

- Pajisjen përfundimtare me infrastrukturë e shërbime të qendrave urbane dhe rurale
- Zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë

Gjatë gjithë këtij procesi, e rëndësishm është që vendimmarrja të ndjekë prioritetet strategjike të parashikuara në PPV. Gjithashtu një faktor tjetër kryesor është edhe rritja e kapaciteteve për thithjen e fondeve dhe të investimeve në bashki duke mundësuar financimin e zhvillimit në përputhje me parashikimet e PPV.

5.2.2 Analiza financiare e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit

Qëllimi i analizës financiare të një projekti është që të vlerësojë karakteristikat e tij, si më poshtë:

- përfitimin nga projekti në tërësi;
- përfitimin për pronarët dhe grupet e interesit;
- sigurimin e qëndrueshmërisë financiare;
- përcaktimin e flukseve të mjeteve monetare të krijuara nga projekti, me qëllim vlerësimin e kostove dhe përfitimeve socio-ekonomike, të cilat maten në analizën ekonomike.

Nga pikëpamja metodologjike, analiza financiare e një projekti fillon me vlerësimin e flukseve të të ardhurave monetare, hyrëse dhe dalëse, që ai gjeneron:

a) Fluksi i të ardhurave dalëse:

- shpenzimet totale të investimit: shpenzimet teknike (kostot fikse të prodhimit, të tilla si toka, ndërtesa, makineri etj.) dhe shpenzimet fillestare;
- kostot operative: kostot e personelit, shpenzimet e energjisë, si dhe shpenzimet e tjera, shërbime dhe produkte të ndërmjetme, të lëndëve të para;
- kosto të tjera: shlyerjen e kredive, interesi pasiv mbi borxhet, taksat.

b) Fluksi i të ardhurave hyrëse:

- të ardhurat operative;
- burimet financimi;
- kontribute publike;
- kapitali social që vjen nga privatët;
- kreditë (huatë) që vijnë nga privatët.

Analiza e flukseve të të ardhurave monetare mundëson vlerësimin e profilit financiar të projektit, dmth.:

- rendimenti financiar i investimeve, sa i përket vlerës aktuale dhe normës së rendimentit të brendshme;
- rendimenti financiar e kapitalit kombëtar, që është vlera aktuale dhe norma e rendimentit të investimit pa përfshirë kontributet që vijnë nga BE-ja;
- qëndrueshmëria financiare e projektit.

Një projekt konsiderohet i qëndrueshëm nga pikëpamja financiare nëse rreziku për të mbetur në të ardhmen pa të ardhura monetare (cash), si gjatë fazës së investimit fillestar ashtu dhe gjatë fazës operacionale, është zero.




Fig. 26 Qëndrueshmëria financiare e projektit

Nëse një projekt ka kthim financiar neto pozitiv ($FNPV > 0$), atëherë projekti nuk kërkon mbështetje publike financiare (*projekt i nxehtë*). Në të kundërt, një projekt që tregon një kthim financiar neto negativ ($FNPV < 0$), ka nevojë për mbështetje financiare (*projekt i ftohtë*).

5.2.3 Analiza ekonomike e politikave të përcaktuara në Planin e Veprimit

Qëllimi i analizës ekonomike është vlerësimi i efekteve socio-ekonomike të një projekti dhe kontributit të tij në mirëqenien e zonës dhe të vendit. Për këtë qëllim duhen vlerësuar disa vlera që nuk janë drejtpërdrejt të dukshme:

- të ashtuquajturat “çmime hije” (*shadow prices*), të cilat pasqyrojnë kostot sociale të të mirave dhe shërbimeve të prodhuara, në vend të çmimeve të thjeshta të tregut;
- "korrigjimet fiskale", dmth. eliminimi i shtrembërimeve të çmimeve të tregjeve shkaktuar nga subvencionet dhe taksat;
- prania dhe madhësia e "efekteve anësore" të mundshme të projektit, të cilat janë efektet (pozitive dhe/ose negative) të projektit të cilat nuk janë reflektuar në çmimet e vëzhguara, dmth, kostot dhe përfitimet e mundshme që rrjedhin nga projektet e subjekteve apo personave të tretë, kur për këta të fundit nuk ka një përfitim monetar (shembull tipik janë efektet në mjedis).

Pasi të gjitha kostot dhe përfitimet e një projekti (te vëzhguara ose të parashikuara) janë matur dhe vlerësuar në terma monetare, matet performanca ekonomike, duke përdorur treguesit e mëposhtëm:

- vlerën ekonomike aktuale neto, e barabartë me diferencën ndërmjet vlerës aktuale (dmth. e zbritur) të përfitimeve me kostot sociale të pritshme neto;
- normën e rendimentit ekonomik, të barabartë me normën e zbritjes, e cila e aplikuar për llogaritjen e vlerës aktuale ekonomike, e bën zero vlerën e këtij të fundit;
- raportin mes përfitimeve dhe shpenzimeve aktuale.

Sigurisht, projektet që tregojnë një vlerë ekonomike aktuale negative janë nuk janë projekte të përshtatshme për t'u realizuar, ndërkohë që është e përshtatshme për të zbatuar ato projekte me një vlerë ekonomike aktuale pozitive.

Së fundmi, analiza kompletohet me vlerësimin e rreziqeve, në mënyrë që të marrë parasysh pasigurinë që shoqëron çfarëdo projekt investimi, i cili përfshin edhe rreziqet e ndryshimeve të klimës. Analiza e rreziqeve që përshkojnë një projekt, artikullohet në tri pika:

- analiza e ndjeshmërisë (*sensitivity analysis*), e cila çon në identifikimin e ndryshoreve 'kritike', ndryshimi i papritur e të cilave mund të ketë efekte rrënjësore në performancën ekonomike ose financiare të projektit;
- analiza e cilësisë dhe analiza probabilitistike e rreziqeve ndaj të cilave projekti është i ekspozuar;
- ndërhyrjet që kanë për qëllim parandalimin ose zbutjen e këtyre rreziqeve.

5.3 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE

Plani financiar (Plani i Investimeve Kapitale) i investimeve të parashikuara për realizimin e Projekteve Pilot të përcaktuara në PPV-në e bashkisë Vau-Dejës ka këto tre objektiva:

- Identifikimi i kërkesës financiare të lindur nga realizimi i veprave, pra shuma e kapitalit të nevojshëm për zbatimin e investimeve të parashikuara.
- Përcaktimi i burimeve të mundshme të financimit të veprave.
- Vlerësimi ekonomik i veprave, me qëllim verifikimin që vlera aktuale neto e projekteve të financuara të jetë pozitive.

Plan i Investimeve Kapitale përcakton kërkesën totale për kapital financiar të nevojshëm për realizimin e veprave të parashikuara në këtë Plan të Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe duke pasur parasysh pamjaftueshmërinë e shumës së disponueshme për Bashkinë për realizimin e veprave të renditura këtu, buxheti i parashikuar në këtë dokument tregon angazhimin e nevojshëm që bashkia duhet të ketë, duke u ndihmuar si nga burimet kombëtare, ashtu edhe nga kontribute të organizmave ndërkombëtarë.

5.3.1 Kërkesa financiare për projektet pilot dhe mbulimi i saj

Ndër projektet e propozuara në këtë Plan, tërësia e “projekteve pilot” - të përcaktuar në fazën e dytë – shfaq një kërkesë financiare relativisht të kufizuar. Nëntë projektet pilot të përcaktuar për Bashkinë Vau-Dejës janë si më poshtë:

- Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman (2.1.4), kosto e llogaritur: 7.000.000 euro
- Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës - Koman, (2.2.1), kosto e llogaritur: 1.500.000 euro
- Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë) (3.1.2), kosto e llogaritur: 2.000.000 euro
- Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës (3.2.1), kosto e llogaritur: 1.900.000 euro
- Zhvillimi i qendrës urbane Bushat (3.2.3), kosto e llogaritur: 1.900.000 euro
- Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës (3.3.1), kosto e llogaritur: 2.200.000 euro
- Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Sapë – Danjë – Sardë – Koman (4.2.1), kosto e llogaritur: 1.350.000 euro
- Realizimi i tre qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë, (5.1.1), kosto e llogaritur: 2.250.000 euro
- Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shëgë në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok, (5.2.8), kosto: 610.000 euro investime private, 20.000 euro shpenzime të Bashkisë

Kërkesa financiare që lind për realizimin e këtyre veprave arrin deri në një total të barabartë me 20.710.000 euro. Ky shpenzim mund të mbulohet vetëm pjesërisht nga fondet e disponueshme të Bashkisë. Siç tregohet në seksionin 3.1.1 “Burimet Lokale”, Buxheti i Bashkisë tregon se kjo e fundit ka liri të plotë për të vendosur destinacionin dhe përdorimin e këtyre fondeve: Transfertat e Pakushtëzuara (Faqja 2 e Buxhetit) dhe Burimet Lokale (Faqja 1 e Buxhetit) për 2017, Transfertat e Pakushtëzuara janë të barabarta me 202,644,000, kurse Burimet Lokale janë të barabarta me 153,000,000, për një total prej 357 644 000 lek (2.672.375 euro).

Parashikimi i buxhetit për dyvjeçarin e ardhshëm tregon një rritje të lehtë të këtyre fondeve, dhe supozohet që një rritje e tillë të konfirmohet për pesëvjeçarin e ardhshëm dhe në vitet e mëpasshme. Natyrisht, do të jetë Bashkia ajo që vendos sasinë e këtyre fondeve që do të shkojë për realizimin e projekteve pilot. Duke supozuar që Bashkia do të përdorë 70-80% të këtyre të ardhurave për këtë qëllim, kemi afërsisht 2.000.000 euro në vit që mund të tërhiqen për financimin dhe bashkë-financimin e projekteve të listuar.

Duke i artikuluar ndërhyrjet për një periudhë kohore pesëvjeçare, mund të llogariten rreth 10,000,000 euro nga fondet e ardhura nga arka e Bashkisë, të cilat korrespondojnë me gjysmën e kërkesës financiare të treguar. Duke pasur parasysh mundësinë e gjerë për përfitimin e ndihmave kombëtare dhe ndërkombëtare për të mbuluar pjesën e mbetur të

kërkesës për kapital, kjo shifër duket e mjaftueshme për të lejuar zbatimin e projekteve pilote të PPV-së.

Projekti 2.1.4: Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman

Analiza financiare:

Fluksi i arkës në dalje:

- i. kosto totale e investimit: 7.000.000 €
- ii. kostot operative të mëvonshme: kostot e mirëmbajtjes, aktualisht të papërcaktuara

Fluksi arkës në hyrje:

- i. të ardhura operative: nuk janë parashikuar të ardhura.
- ii. burime financimi: fondet e Bashkisë dhe bashkëfinancimet Qeveri-BE-Banka Botërore (RDF, ADF, IPA II)
- iii. kontributet publike: si më sipër
- iv. kapital social (aksione) të ardhura nga privatë: i pavlefshëm
- v. kredi (loans) të ardhura nga privatë: asnjë.

Rendimenti financiar i investimit, si në terma të vlerës aktuale, ashtu dhe të normës së rendimentit të brendshëm, është padyshim negativ: bëhet fjalë për një projekt tipik “të ftohtë”. Për më tepër, është projekti më i kushtueshëm ndër projektet e paraqitura. Është e nevojshme që pjesa më e madhe e fondeve të vijë nga kontributet dhe ndihmat kombëtare dhe të huaja të sipërpërmendura. Siç tregohet në seksionin 3.2, të gjitha veprat e lidhura me rrjetin rrugor, dhe në mënyrë të veçantë realizimi i rrugës Vau-Dejës-Koman (që rezulton të jetë projekti më i kushtueshëm), janë të përshtatshme për tu përzgjedhur nga ndihma e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Banka Botërore), nëpërmjet Programit të Rrugëve Lokale dhe Dytësore, që mundëson fonde për zhvillimin e rrjeteve rrugore lokale, dhe programi IPA II, seksioni Transporti.

Analiza ekonomike:

Projekti paraqet “efekte anësore” pozitive të dukshme, gjë që ka çuar si Bashkimin Evropian ashtu edhe Bankën Botërore, në përfshirjen e ndërhyrjeve në favor të rrjetit rrugor, lëvizshmërisë dhe transportit ndër projektet me prioritet në programet e tyre të ndihmës për Shqipërinë. Synimi i ndërtimit të rrugëve të reja, si të gjitha veprat e tjera infrastrukturore, është përbushja e mangësive në rrjete dhe infrastruktura, të cilat konsiderohen si një frenim në rritjen ekonomike të vendit. “Efektet anësore” ekonomike pozitive të ndërtimit të rrugëve të reja, të rritura edhe nga mangësitë strukturore aktuale në Shqipëri, bëjnë që:

- i. Vlera ekonomike aktuale neto e projektit, megjithëse nuk matet, sigurisht që është pozitive dhe kjo e bën të pritshme që projekti mund të financohet kryesisht nga kontributet e programeve IPA II dhe FSHZH.
- ii. Norma e rendimentit ekonomik afatgjatë, megjithëse nuk matet, është sigurisht pozitive dhe mbi normën aktuale të interesit.
- iii. Raporti mes përfitimit dhe kostove aktuale të projektit është padyshim më i madh se një: përfitimet e parashikuara ekonomike dhe sociale i kalojnë kostot e realizimit.

Projekti 5.2.8: Mbjellja e 150 ha shegë

Analiza financiare:

Fluksi i arkës në dalje:

- i. Kosto totale e investimit: 610.000 € investime private dhe 20.000 € konsulencë teknike në ngarkim të Bashkisë.
- ii. Kostot operative: shpenzimet për mbjelljen shpërndahen në një hark kohor për 10 vjet, me një mesatare prej 61.000 euro në vit.

Fluksi i arkës në hyrje:

- i. Të ardhura operative: të ardhurat e parashikuara nga shitjet për hektarë dhe të llogaritura mbi bazën e çmimeve aktuale ndërkombëtare të shegës, variojnë nga 26.000 deri 38.000 euro në vit pas 3 vitesh, për të arritur në 52.00 dhe 76.000 në vit pas pesë vitesh nga mbjellja.
- ii. Burimet e financimit: investime private dhe fondet e Bashkisë
- iii. kontributet publike: a) Kredi e zbutur dhe fonde garancie nga Qeveria Italiane nëpërmjet Programit për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri (PRODAPS) dhe të menaxhuara nga Ministria Shqiptare për Zhvillim Ekonomik; b) kontribute evropiane të programit IPATECH, që është pjesë e Bashkëpunimit Adriatik Transkombëtar IPA.
- iv. kapital social (aksione) të ardhura nga privatë: i pavlefshëm, përveç donacioneve për qëllim bamirësie.
- v. Kredi (loans) të ardhura nga privatë: projekti është fitimprurës dhe i përshtatshëm për të marrë kredi bankare edhe jo të zbutur.

Me një investim fillestar prej më pak se 5,000 euro për hektar, kultivimi i shegës prodhon të ardhura bruto shitjeje, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, të cilat janë rreth dhjetë herë më të larta. Rendimenti financiar i investimit (FNPVC), si në terma të vlerës aktuale, ashtu dhe të normës së rendimentit të brendshëm, është pozitive: bëhet fjalë për një projekt që mund të vetëfinancohet në periudhën afatgjatë.

Analiza ekonomike:

Tregu ndërkombëtar i Shegës është në rritje që prej disa vitesh, në veçanti ai evropian, me parashikime për rritje të mëtejshme të kërkesës nga ana e konsumatorëve të vendeve perëndimore. Vendet prodhuese – Italia, Spanja, Izraeli, Kili, Peru, Afrika e Jugut, Irani, Turqia dhe Argjentina – kanë rritje të prodhimit dhe eksportit.

Vepra do të prodhojë të ardhura operative në rritje, deri sa të arrijë kapacitetin maksimal prodhues, pas pesëmbëdhjetë viteve të para nga fillimi i mbjelljes. Pas tre vitesh, prodhimi i plantacionit mund të arrijë 50% të potencialit të tij prodhues, me 150 kuintal për hektar. Nga viti i pestë, potenciali është në maksimum dhe i barabartë me 300 kuintal për hektarë. Në tregun evropian, çmimet me shumicë të Shegës variojnë (në bazë të cilësisë dhe përmasave) mes 1.75 dhe 2.55 euro për kg. Në vijim, mbjellja e shegës në Shqipëri, ku kostot për mbjellje dhe kultivim janë rreth një e pesta e kostove analoge të matura në Itali dhe Spanjë, paraqet profile të larta përfitimi. Për të marrë përfitim maksimale nga shfrytëzimi, sugjerohet ndër të tjera:

1. Të harmonizohet prodhimi me kërkesat e cilësisë dhe gjurmimin nga BE-së në mënyrë që të përfitojë njohjen dhe mbrojtjen e markës së prodhimit;
2. Të synohet në përpunimin dhe transformimin e produktit në vend (lëngjet dhe të tjera) për të shitur produktin e përfunduar, i cili është më i kërkuar nga konsumatorët evropianë.

Nga sa më sipër, vijon që:

- i. Vlera ekonomike aktuale neto e projektit, megjithëse nuk matet, sigurisht që është pozitive dhe kjo e bën të pritshme që projekti mund të financohet kryesisht nga kontributet e programeve IPA II.
- ii. Norma e rendimentit ekonomik afatgjatë, megjithëse nuk matet, është sigurisht pozitive dhe mbi normën aktuale të interesit.
- iii. Raporti mes përfitimit dhe kostove aktuale të projektit është padyshim më i madh se një: përfitimet e parashikuara ekonomike dhe sociale i kalojnë kostot e realizimit.

Projekti 2.2.1: Realizimi i linjës së transportit uhor nga Vau-dejës në Koman

Për këtë projekt, analiza është e kufizuar në ndërhyrjet që janë në ngarkim të Bashkisë, pra realizimi i: 1) një moli për ankorimin e trakteve për nisje/mbërritje, ii) një moli të vogël ankorimi për stacionet e ndërmjetme; iii) sistemim i plazhit; iv) realizimi i shërbimeve të dyqaneve dhe restoranteve

Analiza financiare

Fluksi i arkës në dalje:

- i. Kosto totale e investimit fillestar: 1.500.000 €

- ii. Kostot operative: kosto të ardhshme të mirëmbajtjes, për momentin nuk janë të vlerësuara

Fluksi i arkës në hyrje:

- i. Të ardhura operative: është e mundur të merren të ardhura operative nëpërmjet vendosjes së taksave për ankorim në mol. Nuk është e këshillueshme që të përdoret kjo taksë të paktën për pesë vitet e para pas realizimit të veprës, për të inkurajuar përdorimin e moleve nga kompanitë private
- ii. Burimet e financimit: fondet e Bashkisë dhe kontribute kombëtare dhe të huaja
- iii. Kontributet publike: bashkë-financime kombëtare nëpërmjet RDF, kontribute të BE, programi IPA II, seksioni Transporti
- iv. Kapital social (aksione) të ardhura nga privatë: asnjë për ndërhyrjet i-iii; ndërsa realizimi i shërbimeve të dyqanit dhe restorantit mund të kryhet në financimin e projektit (project financing), me injektim kapital nga kompania që realizon lokalet dhe i menaxhon ato.
- v. Kredi (loans) të ardhura nga privatë: asnjë

Analiza ekonomike

Përfitimi i mundshëm i linjave të transportit ujor në segmentin Vau Dejës-Koman të lumit Drin, sigurohet nga fakti që tashmë ekzistojnë dhe janë operative ndërmarrjet që ofrojnë këto shërbime mbi bazë sezonale dhe vjetore në segmentin e lumit nga Komani në Fierzë. Megjithëse këto aktivitete janë të pafavorizuara nga kushtet e dobëta të rrugës që lidh Vau-Dejës me Komanin, disa kompani ofrojnë transport të pasagjerëve dhe automjeteve nga Komani në Fierzë. Është e pritshme që të njëjtat kompani apo të tjera mund të investojnë në ofrimin e shërbimeve të njëjta të transportit pjesën e poshtme të lumit.

Projekti paraqet “efekte anësore” pozitive me natyrë të ndryshme: i) ndikimi në punësim i veprave dhe shërbimeve të transportit; ii) implementimi i sistemit të lëvizshmërisë për realizimin turistik të korridorit Vau-Dejës – Valbonë; iii) ndikimi pozitiv i realizimit të itinerarit turistik kulturor Sapë-Vig-Danjë-Sardë-Koman.

Së fundi, projekti nuk duket se është i ekspozuar ndaj rreziqeve specifike përveç atyre që rezultojnë nga mundësia që nuk ka ndërmarrje private të interesuara për përdorimin e strukturave. Rrezik ky që duket i papërfillshëm.

Nga sa më sipër, vijon që:

- i. Vlera aktuale ekonomike neto e projektit megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive dhe kjo e bën të pritshme që projekti mund të financohet kryesisht nga kontributet e programit IPA II, Transporti.

- ii. Norma e rendimentit ekonomik afatgjatë, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive dhe mbi normën aktuale të interesit.
- iii. Marrëdhënia mes përfitimit dhe kostove aktuale të projektit është padyshim më shumë se një: përfitimet e parashikuara ekonomike dhe sociale i tejkalojnë kostot e zbatimit.

Projektet 3.2.1, 3.2.3 dhe 3.3.1: Ndërhyrjet për Zhvillimin e Qendrave Urbane.

Veprat e parashikuara në projektet e Zhvillimit të Qendrave Urbane janë, për nga natyra e tyre, vepra publike që nuk prodhojnë rendiment financiar dhe që kanë një ndikim ekonomik pozitiv në zhvillimin tregtar dhe shërbimet urbane. Bëhet fjalë për projekte 'të ftohta' të financuara tërësisht nga fondet publike, me kontribute kombëtare (RDF), evropiane (IPA II) dhe italiane. Në të vërtetë, siç është përmendur në seksionin 'Burimet e Aktivizueshme', këto vepra i përkasin fushëveprimit të Kapitullit 2 të Protokollit të Bashkëpunimit 2014-2016 ndërmjet Agjencisë së Bashkëpunimit Italiane për Zhvillim dhe Qeverisë Shqiptare: Veprimet në favor të zhvillimit social, burimeve njerëzore, përfshirjes dhe kohezionit territorial.

Analiza financiare e tre projekteve

Fluksi i arkës në dalje:

- i. Investimi total: 6.000.000 euro
- ii. Kostot operative: kosto të ardhshme të mirëmbajtjes, për momentin nuk janë të vlerësuara

Fluksi i arkës në hyrje:

- i. Burimet e financimit: fondet e Bashkisë dhe kontribute kombëtare dhe të huaja
- ii. kontributet publike: bashkë-financime kombëtare nëpërmjet RDF, kontribute të BE, programi IPA II, seksioni Transporti. Kontribute të Qeverisë Italiane.
- iii. kapital social (aksione) të ardhura nga privatë: asnjë.
- iv. Kredi (loans) të ardhura nga privatë: asnjë

Analiza ekonomike

Veprat publike të konsideruara këtu nuk kanë një çmim tregu, por një çmim të quajtur "çmim hije", një vlerësim ekonomike për periudhën afatgjatë që merr parasysh përfitimet private dhe sociale që ato prodhojnë. Për momentin, Bashkia paraqet një shpërndarje të madhe të banimeve në territor dhe një mungesë të qendrës urbane. Kjo e fundit është thelbësore për krijimin e përfitimit për ndërmarrjet tregtare dhe shërbimet. Kjo nënkupton që këto vepra, në planin afatgjatë, do të prodhojnë 'efekte të jashtme' pozitive për territorin, vlera e të cilave mund të vlerësohet në shifra mbi kostot fillestare. Së fundi, projekti nuk duket të jetë i ekspozuar ndaj rreziqeve specifike.

Nga sa më sipër, vijon që:

- i. Vlera aktuale ekonomike neto e projektit, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive ii) Norma e rendimentit ekonomik afatgjatë, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive dhe mbi normën aktuale të interesit.
- ii. Marrëdhënia mes përfitimit dhe kostove aktuale të projektit është padyshim më shumë se një: përfitimet e parashikuara ekonomike dhe sociale i tejkalojnë kostot e zbatimit.

Projekti 3.1.2 dhe 5.1.1: Ndërhyrjet në favor të Bujqësisë

Projektet e dedikuara për zhvillimin e prodhimit bujqësor – 3.1.2 “Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)” dhe 5.1.1 “Realizimi i tre qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë” – parashikojnë ndërtimin e i) një ndërtese për zyra, kosto 1.000.000 euro; iii) një kapanoni për pajisjet teknike, kosto 1.000.000 euro; iii) një kapanoni për magazinimin e produkteve bujqësore, kosto 1.000.000 euro; iv) një kapanoni frigoriferik për konservimin e produkteve, kosto 1.000.000 euro; v) një godinë zyrash, kosto 200.000 euro; dhe së fundi vi) një shesh i asfaltuar, kosto 50.000 euro.

Analiza financiare e dy projekteve:

Fluksi i arkës në dalje:

- i. Investimi total: 4.250.000 euro
- ii. Kostot operative: kosto të ardhshme të mirëmbajtjes, për momentin nuk janë të vlerësuara

Fluksi i arkës në hyrje:

- i. Të ardhura operative: është e mundur të merren të ardhura operative nga këto investime duke i dhënë privatëve me qira hapësira zyre dhe magazinimi, dhe duke i shitur privatëve shërbimet e magazinimit dhe ngrirjes së produkteve. Duke qenë se qëllimi i këtyre veprave është përmirësimi i produktiviteti të sektorit bujqësor lokal, këshillohet që Bashkia të praktikojë çmime “politike” që të mbulojnë kostot e menaxhimit dhe mirëmbajtjes, por jo kostot fikse (fillestare) të investimit. Në këtë mënyrë, autoriteti publik, realizon në fakt një grant për ndërmarrjet bujqësore me qëllim që të inkurajojë përdorimin e strukturave nga ndërmarrjet private, duke marrë në ngarkim kostot fikse të investimeve që përndryshe do të rëndonin përdoruesit e impiantit.
- ii. Burimet e financimit: fondet e Bashkisë dhe kontribute kombëtare dhe të huaja
- iii. kontributet publike: bashkë-financime nëpërmjet i) RDF, ii) kontributeve të BE, programit IPA II, seksioni Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, iii) Kontribute të Qeverisë

Italiane, objektivi i pestë strategjik i marrëveshjes së bashkëpunimit, Bujqësia dhe Kultivimi i Peshkut.

- iv. kapital social (aksione) të ardhura nga privatë: asnjë.
- v. Kredi (loans) të ardhura nga privatë: asnjë

Analiza ekonomike

Bujqësia shqiptare, ashtu si ajo e Bashkisë, paraqet një potencial të dukshëm ekonomik, zhvillimi i të cilit megjithatë është i penguar nga mungesa e infrastrukturës dhe nga përmasat e vogla të njësive të prodhimit. Veprat e propozuara në këto dy programe kanë për qëllim të pajisin territorin e infrastrukturës logjistike dhe administrative të nevojshme për zhvillimin e prodhimit bujqësor. Ndikimi i këtyre ndërhyrjeve në prodhimin lokal, është vështirë të përcaktohet nga ana sasiore përveçse në mënyrë të përafërt. Megjithatë, është e pritshme që shumica e të ardhurave private dhe të ardhurat tatimore rezultuese si pasojë e rritjes së produktivitetit të shkaktuar nga prezenca e strukturave të lartpërmendura, tejkalon koston fillestare.

Së fundi, projekti nuk duket se është i ekspozuar ndaj rreziqeve specifike

Nga sa më sipër vijon që:

- i. Vlera aktuale ekonomike neto e projektit, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive.
- ii. Norma e rendimentit ekonomik afatgjatë, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive dhe mbi normën aktuale të interesit.
- iii. Marrëdhënia mes përfitimit dhe kostove aktuale të projektit është padyshim më shumë se një: përfitimet e parashikuara ekonomike dhe sociale i tejkalojnë kostot e zbatimit.

Projekti 4.2.1: Itinerari turistik kulturor Sapë - Vig - Danjë – Sardë - Koman

Ky projekt artikullohet në katër ndërhyrje: i) Përmirësimi i aksesit të vendeve për t'u vizituar, kosto: 1.000.000 euro; ii) Realizimi i një zone pushimi në vendet që vizitohen, kosto 250.000 euro; iii) Realizimi i sinjalistikës turistike, kosto 50.000 euro. Ndërhyrjet (i) dhe (ii) që prodhojnë pothuajse tërësinë e kërkesës financiare të projektit, janë ndërhyrje për kushtet e rrugëve, dhe ashtu si projekti 2.1.4, janë të përshtatshme për t'u përzgjedhur për ndihmat e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Banka Botërore) nëpërmjet Programit për Rrugët Lokale dhe Sekondare, dhe Programit IPA II, seksioni Transporti.

Analiza financiare

Fluksi i arkës në dalje:

- i. Kosto totale e investimit: 1.350.000 euro
- ii. Kostot operative të ardhshme: kosto të mirëmbajtjes, për momentin nuk janë të vlerësuara

Fluksi i arkës në hyrje:

- i. Të ardhura operative: nuk janë parashikuar të ardhura.
- ii. Burimet e financimit: fondet e Bashkisë dhe bashkë-financime Qeveri-BE-Banka Botërore (RDF, ADF, IPA II)
- iii. kontributet publike: si më sipër.
- iv. kapital social (aksione) të ardhura nga privatë: e pavlefshme.
- v. Kredi (loans) të ardhura nga privatë: asnjë.

Analiza ekonomike

Sektori turistik shqiptar ka regjistruar një rritje progresive duke u nisur nga fundi i viteve '90, që më pas u bë e dukshme, disi e habitshme, në vitet e fundit. Numri i turistëve të huaj ka kaluar nga 500.000 në 2005 në 4.2 milionë në 2015, me një shpenzim mesatar ditor për turist të vlerësuar rreth 80 euro. Falë këtij zhvillimi eksponencial të qarkullimit të këtij sektori, turizmi tani jep kontribut prej 10% të PBB –së (GDP) , duke pasur parasysh edhe ndikimin që prodhon për tregtinë dhe ushqimin (restorantet).

Vlerësohet se, në 2013, sektori ka prodhuar një fluks të ardhurash nga turistët e huaj të barabartë me 1.670 milionë dollarë amerikanë. Resurset peizazhistike, arkeologjike dhe kulturore të Vendi, janë të mëdha shfrytëzimi tregtar i të cilave është padyshim i destinuar për t'u rritur, falë edhe investimeve të operatorëve të huaj, kryesisht italianë. Projekti, së fundi, është integruar në mënyrë sinergjike në kuadrin e ndërhyrjeve të tjera në kushtet rrugore dhe zhvillimin e produkteve bujqësore lokale. “Efektet e jashtme” pozitive afatgjata të këtyre veprave sigurisht janë të mjaftueshme për të justifikuar realizimin e tyre.

Së fundi, projekti nuk duket se është i ekspozuar ndaj rreziqeve specifike.

Nga sa më sipër, vijon që:

- i. Vlera aktuale ekonomike neto e projektit, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive.
- ii. Norma e rendimentit ekonomik afatgjatë, megjithëse nuk është e matur, është padyshim pozitive dhe mbi normën aktuale të interesit.
- iii. Marrëdhënia mes përfitimit dhe kostove aktuale të projektit është padyshim më shumë se një: përfitimet e parashikuara ekonomike dhe sociale i tejkalojnë kostot e zbatimit.

5.3.2 Konsiderata përmbyllëse

Investimet e treguara në këtë PIK kërkojnë burime financimi të barabarta me 20.710.000 euro, gjysma e së cilës (afërsisht) mund të vijë nga burimet e Bashkisë gjatë një harku kohor pesëvjeçar. Pjesa e mbetur duhet të financohet nga ndihmat kombëtare dhe të huaja. Pavarësisht se detyrimi financiar për Bashkinë nuk është e papërfillshme, për realizimin e këtyre veprave është e justifikuar nga pikëpamja ekonomike.

Të gjitha projektet pilot të konsideruara, janë ndërhyrje të natyrës infrastrukturore, me përjashtim të projektit të mbjelljes së shegës. Kjo e fundit, nga ana e saj, paraqet marzhe fitimi të dukshme dhe të gjera, të tilla që të tërheqin investime private.

Nga këndvështrimi makroekonomik, ekziston një konsensus i gjerë se ekonomia shqiptare ka potencial të madh për rritje dhe një nevojë të madhe për përmirësimin të thellë të infrastrukturës. Duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës të Vendit dhe të Bashkisë Vau-Dejës, është e pritshme që investimet që do të jenë në gjendje të plotësojnë këto boshllëqe do të kenë një rritje të rendimentit ekonomik, domethënë do të prodhojnë rendiment ekonomik më shumë se proporcional me investimet e bëra, si afatmesme ashtu dhe ato afatgjatë.

Në periudhë afatshkurtër, investimet e konsideruara do të kenë një ndikim të dukshëm pozitiv në nivelet e punësimit dhe të të ardhurave të rajonit. Sipas Armela Mançellari, në 'Efektet makroekonomike të politikës fiskale në Shqipëri: vlerësim me modelin SVAR, Banka e Shqipërisë, Departamenti i Kërkimeve, në Shqipëri "shumëzuesi i PBB-së për shpenzimet kapitale është 0.95 pas një tremujori", pra shumëzuesi për periudhën afatshkurtër i shpenzimit publik për investimet është afërsisht sa njësia: për çdo euro të shpenzimit kapital, Prodhimi i Brendshëm Bruto i vendit rritet me 95 cent. Është e pritshme që ky efekt shumëfishues i shpenzimit publik të ketë magnitudë të ngjashme edhe në nivel rajonal.

Në përfundim, vlerësimi i efekteve ekskluzivisht ekonomike të investimeve të përshkruara këtu, tregon qartë se, megjithëse shpenzimet e parashikuara kërkojnë sakrificë për arkën e Bashkisë, ky përdorim i burimeve lokale është mjaft i justifikuar nga rritja ekonomike dhe sociale që pritet të përfitohet.

5.4 TERMAT E REFERENCËS PËR ZONAT ME PDV

5.4.1 Të përgjithshme

Në paragraf jepen dhe propozohen disa udhëzime bazë që duhen konsideruar gjatë përgatitjes të termave të referencës (TR) për plane të detajuar vendore PDV që hartohen për zona sensitive në aspektin e zhvillimit në tërësi të bashkisë Vau-Dejës. Konkretisht bëhet fjalë për rregulla të përgjithshme (kryesisht të referuar nga eksperiencia dhe në zbatim të

kuadrit ligjor për planifikimin e territorit) dhe disa specifike të cilat njëkohësisht nxisin zhvillimin e kontrolluar dhe të qëndrueshëm për njësitë strukturore në të cilat zbatohen.

Termet e referencës, duhet të përmbajnë:

- Titulli i projektit;
- Afati për kryerjen e konsulencës;
- Tipi i konkursit (kombëtar/ndërkombëtar)
- Zonën dhe njësinë strukturore për të cilën hartohet PDV;
- Krieteret e përgjithshme dhe të veçanta të kompanive konsulentë që do garojnë për kryerjen e shërbimit;
- Niveli dhe lloji i ekspertizës së kërkuar
 - Urbanist / Arkitekt
 - Inxhinier ndërtimi;
 - infrastrukture transporti;
 - Inxhinier hidroteknik;
 - Ekspert mjedisi;
 - Agronom;
 - Ekspert GIS;
 - Ekspert të tjerë, sipas nevojës;
- Udhëzimet dhe rregullat që do përdoren për vlerësimin dhe kualifikimin e kompanive konsulente që garojnë;
- Kuadër i përgjithshëm përshkrues dhe konteksti i zhvillimit. Këtu, sipas rastit jepen të dhëna: demografike, infrastrukture, lidhja me qendrat e banuara. Pra bëhet një përshkrim i detajuar;
- Qëllimet strategjike që kërkohen të arrihen;
- Fazimi i zbatimit të PDV nëse është e nevojshme. Duke patur parasysh që zonat me PDV nuk zhvillohen njëkohësisht, në tërësinë e tyre, duhen qartësuar fazat e zhvillimit të infrastrukturave të transportit dhe shërbimeve primare e sekondare duke specifikuar dhe kërkesat që duhen konsideruar;
- Kuadri ligjor që duhet marrë në konsideratë dhe rregulla specifike në varësi të zonës ku hartohet PDV;
- Materiali që kërkohet të dorëzohet dhe afatet respektive. Raporte teknike, material grafik (harta) dhe rregullorja. Përas i përket materialit grafik duhet specifikuar shkalla e paraqitjes së hartave të printuara por gjithashtu konsulenti duhet të përgatisë në platformën GIS gjithë dokumentacionin grafik i cili dhe do publikohet në Rregjistrin e Integruar të Territorit;
- Hartimi i Vlerësimeve Mjedisore sipas kërkesave të kuadrit ligjor respektiv;
- Procesi i konsultimit publik dhe përfshirja e grupeve të interesit. Duhet përcaktuar në plan veprimi i qartë, që në respektim të fazave të zhvillimit të projektit (PDV-së) organizohen dhe konsultimet publike.
- Për zonat turistike apo të tjera me interes kombëtar duhet konsideruar koordinimi me AKPT, MZHU dhe me institucionet qendrore që mbulojnë sektorët e zhvillimit në fjalë (Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore etj.).

Duhet patur në konsideratë që struktura, përmbajtja dhe procedurat për Nismën dhe procesin e miratimit të PDV duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në varësi të procedurës që ndiqet për prokurimin e shërbimeve të konsulencës, sqarojmë se gjithë procedura dhe dokumentacioni përkatës duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor për prokurimin publik në vendin tonë.

5.4.2 Termat e referencës për PDV e Njesisë Qendrore Urbane të Vau-Dejës

Titulli i Projektit – Hartim PDV me qëllim zhvillim e Qendrës Urbane të Vau-Dejës dhe Tregut Artizanal

5.4.2.1 Hyrje

Qyteti i Vau-Dejës është një nyje strategjike ku ndërthuren një seri aksesh lëvizje primare dhe dytësore, me karakter ekonomik, turistik, historik dhe mjedisor. Pikërisht në këtë territor do të zhvillohet poli i transportit multimodal Vau-Dejës – Mjedë dhe do të jetë qendra për aksesin e shërbimeve publike bazë në bashki. Gjithashtu pranë Vau-Dejës kalojnë aksi kryesor i veriut, Tiranë - Lezhë – Shkodër - Hani i Hotit dhe rruga Shkodër – Pukë – Kukës – Prishtinë.

Vau-Dejës është mjaft pranë me liqenin e Shkodrës, plazhin e Velipojës dhe të Shëngjinit, portin e Shëngjinit, aeroportin e Gjadrit, qendrat urbane të veriut (Lezhën dhe Shkodrën) si dhe itinerarin turistik përgjatë luginës së Drinit, që nis në Alpe e përfundon në Velipojë.

Vau-Dejës është edhe qendra kryesore urbane e zonës së Zadrimës, një territor i shquar për prodhimet bujqësore, traditat kulturore si dhe artizanatin.

Pikërisht në qendër të qytetit lind nevoja e zhvillimit të një hapësire ku në rradhë të parë të modelohet konteksti urban duke zhvilluar një hapësirë cilësore, e më pas të ofrohen shërbime dhe funksione që pasurojnë ofertën ekonomike dhe përfaqësojnë më së miri vlerat kulturore dhe traditën lokale.

Kjo hapësirë duhet të përmabajë zona rekreative dhe hapësira publike, shërbime dhe një treg artizanal e hapësira ekspozimi të prodhimeve lokale të traditës dhe të ditëve të sotme.

Qendra e re e qytetit duhet të jetë një hapësirë që gjeneron aktivitet, ofron funksione atraktive dhe shpalos vlerat lokale kulturore dhe historike të bashkisë Vau-Dejës.

Nisur nga rëndësia e veçantë që ka ky PDV, rekomandohet zhvillimi i tij me konkurs të hapur kombëtar apo ndërkombëtar, në mënyrë që të zgjidhet propozimi më i përshtatshëm sipas përcaktimeve të parashtuara në këto terma reference.

5.4.2.2 Objektivat dhe synimet e studimit

Promovimi i zhvillimit urban dhe atij ekonomik në qytetin e Vau-Dejës

Objektiva specifike:

- Krijimi i një qendre urbane atraktive
- Promovimi i imazhit të bashkisë
- Stimulimi i zhvillimit ekonomik për biznesin lokal
- Rritja e numrit dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve
- Rritja e ofertës turistike
- Shfrytëzimi i lidhjes me itineraret turistike
- Rritja e punësimit të komunitetit lokal
- Mbështetja e sektorit të prodhimit artizanal
- Promovimi i prodhimeve dhe traditës lokale
- Rritja e hapësirës publike në qendër të qytetit
- Shpalosja e vlerave kulturore dhe historike

5.4.2.3 Programi funksional i zonës

Funksionet kryesore që do të zhvillojë zona përshkruhen në vijim por nuk janë të limituara në këtë listë:

- Hapësirë publike dhe e gjelbër
- Sheshi kryesor i bashkisë dhe hapësirë për organizim eventesh
- Hapësira rekreative
- Treg artizanal dhe i produkteve lokale
- Ambiente ndihmëse të tregut
- Hapësira ekspozimi
- Shërbime publike
- Shërbime private
- Pika ndërlidhjeje me rrjetin e transportit multimodal
- Vende parkimi për automjete dhe biçikleta

5.4.2.4 Kushtet e zhvillimit

Sipas PPV Vau-Dejës, referuar pasaportës së njësisë, identifikohen të dhënat dhe kushtet e mëposhtme të zhvillimit:

- Sip e njësisë 5.5 Ha
- Intensiteti maksimal i ndërtimit 2.2
- KSHT maksimal 70%
- KSHR minimal 15%
- KSHP minimal 15%
- Vendparkime 50
- Lartësia maksimale e ndërtimeve 4 kate (15.5m)

5.4.2.5 Raporti i Analizës së Njesisë Strukturore

Raporti i analizës së njesisë që trajohet me PDV për «Njësia Qendrore Urbane në Vau-Dejës» duhet të jetë në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktualisht në fuqi. Gjithashtu ky Raport duhet të bazohet dhe referohet në përcaktimet e PPK dhe PPV të bashkisë Vau-Dejës.

Në pjesën e parë do të kryhet një analizë e thellë e cila do të duhet të përmbajë:

- Kuadrin më të gjerë hapësinor dhe ligjor
- Metodologjinë
- Përshkrimin e gjendjes aktuale
- Caktimin e kufijve të zonës së studimit dhe përshkrimin e nësive kufitare

Përshkrim i detajuar i situatës aktuale të zonës e cila do të përfshijë:

- Punësimin ekonomik-Lokal: Të shënohet aktiviteti ekonomik aktual i zonës së studimit
- Evidentimin e parcelave dhe të tregohet statusi i pronësisë.
- Të shënohen përdorimet aktuale të tokës
- Përshkrim i peizazhit natyror dhe problemet ekzistuese mjedisore
- Evidentim i infrastrukturës ekzistuese teknike (rrjetet e shërbimeve, rrugët, etj) dhe gjendjes së tyre
- Evidentim i infrastrukturës sociale dhe hapësirave publike ekzistuese në zonën e studimit
- Cilësia e ndërtesave ekzistuese dhe diagnostikim i nevojave për mirëmbajtje/rinovim/restaurim
- Eksplorim Gjeologjik: Të kontrollohet përshtatshmëria gjeologjike e zonës së studimit, me qëllim që të parashikohen ndërhyrjet e nevojshme specifike nëse ka nevojë.

Ky Raport duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustrojnë elementet kryesore të analizës.

Baza hartografike do të përfshijë të paktën:

Harta të shkallës 1: 500 deri 1: 2.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj), kufijtë, përmasat dhe emërtimet.

Këto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.

Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përshkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.

I gjithë materiali hartografik duhet të jetë i përgatitur edhe në Platformën GIS në përshtaje me standardet e përcaktuara për publikim në Rregjistrin e Integruar të Territorit

Është e nevojshme që raportin teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike e zonës së studimit.

5.4.2.6 Strategjia e zhvillimit të njësisë

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale dhe dokumentin strategjik të PPV, zhvillohet strategjia e propozuar për zhvillimin e programit të parashikuar për njësinë strukturore objekt i PDV-së.

Ky raport identifikon dhe propozon objektivat strategjik për zonën e ndërhyrjes, ku sipas rastit edhe mund të shtohen (plotësohen) ato të dhëna në dokumentin e PPV-së.

Në përfundim të këtyre dy raporteve, bazuar në gjetjet e analizës dhe objektivat e zhvillimit duhet të bëhet dhe një konsultë publike duke përfshirë dhe grupet e interesit. Pjesë e domosdoshme e këtij takimi duhet të jenë dhe përfaqësia e pronarëve të përfshirë në PDV.

5.4.2.7 Plani i Zhvillimit të PDV-së

Në Raportin e Planit të Zhvillimit të PDV-së do të duhet të analizohen propozimet konkrete për zhvillimin e zonës së studimit që do të shoqërohet me hartat përkatëse. Më konkretisht:

- Përdorimet e propozuara të përdorimit të tokës dhe përdorime specifike, funksionet/aktivitete nënkategoritë e tyre pas riorganizimit të parcelave (nëpërmjet bashkimit ose ndarjes së parcelave).
- Propozimet për infrastrukturën e nevojshme: rrjetet e transportit rrugor, rrjete të furnizimit me ujë, rrjete të ujësjellës-kanalizime, rrjetet të zjarrfikësive, rrjete të ndriçimit elektrik, sisteme të ujitjes së zoanve të gjelbërta, impiante të trajtimit të ujërave të zeza, menaxhim energjetik, ndërtesë për administratën e sipërmarrjeve të parkut, parkimet etj.
- Propozimet për hapësirat publike dhe të përbashkëta (p.sh. parqe të gjelbërta, hapësira sheshesh, hapësira për parking, rrugë, trotuare dhe zona të instalimit të infrastrukturës) dhe shërbimet publike.
- Propozimet për ndërhyrjet në ndërtesat ekzistuese me dokumentacionin përkatës. Do të shënohen cilat ndërtesat do të shkatërrohen dhe cilat do të rinovohen/rikonstruktohen.
- Vendndodhjet e propozuara të ndërtesave dhe vëllimet e tyre indikative
- Sugjerimet për shpërndarjen dhe intensitetin e ndërtimit, koeficientin e ndërtimit, distancat minimale dhe lartësitë e ndërtesave sipas Rregulloreve përkatëse.
- Aplikim të instrumenteve të zhvillimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Baza hartografike do të përfshijë të paktën:

Hartat e propozimeve (sipas pikave të mësipërme) në shkallën 1: 500 deri 1: 2.000.

I gjithë materiali hartografik duhet të jetë i përgatitur edhe në Platformën GIS në përshtaje me standardet e përcaktuara për publikim në Rregjistrin e Integruar të Territorit

5.4.2.8 Rregullorja e PDV

Rregullorja e PDV-së duhet të përmbajë:

- Përcaktimi i rregullave të përgjithshme në zbatim të Rregullores së PPV Bashkia Vau-Dejës dhe atyre specifike që do të përdoren.
- Sqarime për kodet që do të përdoren për kategoritë/nënkategoritë e përdorimit të tokës, sistemet, subjekte dhe kategori të tjera në përputhje me terminologjinë ligjore dhe atë të përdorur në Rregulloren e PPV.
- Do të duhet të përcaktohen faktorët dhe kondicionet e zhvillimit (rregulla të përgjithshme, distancat, lartësia maksimale, materialet e përdorshme, element të fasadave etj) dhe të vendosen linjat e ndërtimit,
- Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit, të burimeve natyrore, të vendndodhjes, në mënyrë që të sigurohet se zhvillimi i propozuar nuk do të ndikojë negativisht.
- Rregullat për zhvillimin e zonës së studimit: kushtet e rritjes, kategoritë/nënkategoritë e përdorimit të tokës, përdorimet e lejuara, kushtet dhe kufizimet, etj
- Rregullat e ndarjes dhe bashkimit të parcelave.
- Të drejtat dhe kufizimet, siç ato burojnë nga kuadri i propozuar i zhvillimit
- Rregullat për rrjetin rrugor dhe rrjetin e transportit. Do të duhet të përcaktohen kategoritë e rrjetit rrugor dhe lidhja e tyre me infrastrukturën lokale/kombëtare, karakteristikat e tyre teknike dhe të përcaktohen parametrat e lëvizshmërisë dhe transportit.
- Përcaktimi i zonave buferike të infrastrukturës.

5.4.2.9 Plani i Veprimit dhe Plani i Investimeve

Plani i veprimit të studimit që do të përfshijë projekte/veprime/ndërhyrje konkrete, me referencë koston e vlerësuar, burimet e financimit, grupet e përfshira të interesit, prioritetet, diagramën kohore të zbatimit, treguesit e vlerësimit/monitorimit dhe vëzhgime të tjera. Në përputhje me planin e veprimit do të hartohet plani i investimeve kapitale me kosto ndërtimi dhe operative për infrastrukturën e propozuar.

Për realizimin e një pjese të investimeve në Njesisë Qendrore Urbane të Vau-Dejës mund të përdoret Partneriteti Publik Privat. Kontributi i sektorit publik në këtë rast shihet si i domosdoshëm pasi kemi të bëjmë me hapësirën kryesore të qytetit në të cilën do të organizohen pjesa më e madhe e aktiviteteve publike, përfaqësuese dhe festive. Gjithësesi, ngritja e tregut dhe shërbimeve mund të mbështeten me investime private ku raporti i investimit dhe kushtet e partneritetit përcaktohen me marrëveshje.

5.4.2.10 Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PDV

Për të monitoruar zbatimin e PDV-së dhe vlerësuar performancën e tij, në respektim të objektivave dhe qëllimeve të dhëna, do të duhet të përcaktohet, gjatë planifikimit të projektit, një grup treguesish (tregues financiarë, tregues shpenzimesh, rezultatesh dhe ndikimesh). Këta tregues mund të jenë masa sasiore por dhe vëzhgime cilësorë dhe do të përcaktojnë mënyrën me të cilin do të matet performanca e projektit.

6 MONITORIMI I PLANIT TE ZHVILLIMIT

Plani i Zhvillimit të Bashkisë do të zbatohet me anë të projekteve të drejtpërdrejta, parashikimeve të planit të përdorimit të tokës dhe zbatimit të Rregullores. Janë drejtoritë specifike pranë Bashkisë Vau-Dejës që kanë përgjegjësinë për zbatimin e politikave të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit. Njëkohësisht, në mënyrë sistematike duhet bërë monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe të planit prej vetë Bashkisë.

Bazuar në parashikimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, bashkitë kanë detyrim ligjor të hartojnë një raport vjetor në lidhje me zhvillimin e territorit. Ky raportim i shërben njëkohësisht edhe Bashkisë, që kupton me antë të treguesve suksesin ose jo të përdorimit të instrumentave planifikues, por nga ana tjetër shërben edhe si indikator kontrolli nga pushteti qendror dhe nga publiku për transparencën dhe zbatueshmërinë e dokumentave të aprovuar.

Çdo vit, bashkia duhet të masë treguesit e mëposhtëm, dhe çdo tre vjet duhet hartuar një raport i brendshëm në lidhje me zbatimin e strategjisë. Në varësi të rezultateve të monitorimit, mund që më pas të bëhet ndryshimi dhe alternimi i politikave dhe programeve për t’ju përgjigjur dinamikave të reja. Për monitorimin e planit do të përdoren 3 lloj indikatorësh.

Table 12 Indikatore të sipas Sistemeve

Sistemi	Indikatorë	Zonë	Njësia
Sistemi Urban	1. Sipërfaqja e territorit urban 2. Sipërfaqja e infrastrukturës/banore 3. Popullsia (ekzistuese dhe e parashikuar) 4. Strehimi privat/social 5. Shërbime administrative; 6. Shërbime sociale/banorë, arsim/banorë dhe shëndetësi/banorë; 7. Transporti publik dhe privat (nr. makina/ familje) 8. Ndarja në zona; 9. Sipërfaqet e gjelbra/ banorë dhe sportive/ banorë; 10. Hapësira kulturore dhe rekreative/ banore; monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore; 11. Detyrimet ndaj kërkesave fetare; 12. Intensiteti për ha; 13. Parkime/banore;	a) hapësira publike; b) kategoritë e banimit; c) Nënkatëgoritë e banimit; ç) Sipërfaqja bruto; d) Sipërfaqja neto; dh) Dendësia për ha; e) Dendësia për ha = njësi/banimit për ha; f) Sipërfaqja e infrastrukturës; g) Gjellbërimi në nivel zone; gj) Parkimi;	Ksht Kshr Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Gjellbërimi/banorë Parkimi/banorë Nr. banorësh Nr. përdoruesish Shërbimet Nënkatëgoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara

PPV Bashkia Vau-Dejës
Plani i Zhvillimi të Territorit

	14. Indikatorët ekonomikë (GDP/ sektorë/ lloji bizneseve/ çmimet/ punësimi/ punësimi për sektor/ taksat vendore/ borxhi /shpenzimet sipas sektorit); 15. Pronat publike dhe private; 16. Tendencat e zhvillimit në territor	h) Ndarja në njësi; i) Vlera e tokës	
Sistemi Bujqësor	Territor bujqësor; SB. Primare (Boniteti I-IV); SB Dytësore (Boniteti V-X); SB me sistem ujitjeje; SB pa sistem ujitjeje; SB Tokë pa fryt	Kategoria Bazë Nënkategoria Ndarja në njësi	Ksht / Kshr / Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Nënkategoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara
Ujor	Ujëra tokësore Ujëra Bregdetare	Sip- Liqene, Lumenj, Përrenj Ligatina	
Infrastruktura	Sip. rrugë kombëtare Sip. rrugë interurbane Sip. rrugë urbane parësore Hekurudha Gazdote Elektrodote Ujësjellës - Kanalizime - Impiante		
Natyror	Sip. e përgjithshme Sip. pyjore Sip. Kullota Sip. të gjelbra (jo urbane) Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm	Kategoria Bazë Nënkategoria Ndarja në njësi	Ksht / Kshr / Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Nënkategoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara

Fillimisht, janë indikatorët e përcaktuar në VKM 671 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” në shtojcën tre, të cilat masin ndryshimet në bazë sistemi. Pjesa më e madhe e treguesve të tabelës vjen nga Rregullorja e Planit. Roli i Bashkisë në këtë rast do të jetë zbatimi i tyre në kushtet e aprovimit të PDV-ve, por edhe monitorimi, për të kuptuar nëse ka probleme në aplikimin e të dhënave dhe parametrave që vijnë nga PPV-ja.

Një set i dytë indikatorësh vjen nga Aplikimi dhe Monitorimi i objektivave Strategjike, për Projektet Bazë dhe Projektet e Zhvillimit.

Table 13 Indikatoret sipas Objektivave Strategjikë

OB.	PROG.	PROJEKTET	Tregues vlerësimi (monitorimi)	Përgjegjës për zbatimin
1- PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	1.1.1 Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale	Fazat e realizimit të punimeve Aksesueshmëri a, numri i automjeteve në transit Cilësia e ujërave	Bashkia Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ARRSH Ministria e Zhvillimit Urban
		1.1.2 Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë		
		1.1.3 Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve		
		1.1.4 Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike		
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	1.2.1 Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane	Fazat e realizimit të punimeve Niveli i ndotjes së ambientit Cilësia e ujërave	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban
		1.2.2 Sistemi i pastrimit të rrugëve të qytetit		
		1.2.3 Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmytjet		
	1.3 Shërbimet publike	1.3.1 Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit)	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban
		1.3.2 Shërbimi i autobusëve shkollorë		
		1.3.3 Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara		
		1.3.4 Qyteti mik i fëmijëve		
2- LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	2.1.1 Përmirësim i rrugës Shkodër – Pukë – Kukës	Fazat e realizimit të punimeve Numri i automjeteve në transit	Bashkia Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ARRSH
		2.1.2 Përmirësimi i rrugës përgjatë rrzës së maleve		
		2.1.3 Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës – Bushat-Velipojë - Shëngjin		
		2.1.4 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Koman		
		2.1.5 Përmirësim i rrugës Vau-Dejës-Vig		
		2.1.6 Përmirësim i rrugës Koman-UkëBibaj		
		2.1.7 Realizimi i bypass-it të Vau-Dejës		
		2.1.8 Rehabilitim i urës Hajmel		
	2.2 Korridori lumor	2.2.1 Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman	Numri i pasagjerëve dhe	Bashkia Ministria e Transportit

3- QENDRAT URBANE			automjeteve të kryera Numri i turistëve	dhe Infrastrukturës	
		2.2.2 Lidhja rrugore e stacioneve të tragetit me fshatrat	Fazat e realizimit të punimeve Numri i automjeteve në transit		
		2.2.3 Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi	Fazat e realizimit të punimeve Numri i automjeteve dhe pasagjerëve në transit		
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen	2.3.1 Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë			
		2.3.2 Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Mjedë dhe Hajmel			
		2.3.3 Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel			
		2.3.4 Realizim i pistave të biçikletave			
		3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	3.1.1 Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës / Mjedë)	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban
			3.1.2 Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë)		
		3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	3.2.1 Zhvillim i qendrës urbane Vau-Dejës	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve	Bashkia Ministria e Zhvillimit Urban
			3.2.2 Zhvillim i qendrës urbane Mjedë		
			3.2.3 Zhvillim i qendrës urbane Bushat		
			3.2.4 Zhvillim i qendrës urbane Rranxë		
3.2.5 Zhvillim i qendrës urbane Barbullush					
3.2.6 Zhvillim i qendrës urbane Koman					
3.2.7 Zhvillim i qendrës urbane Hajmel					
3.2.8 Zhvillim i qendrës urbane Nënshatë					
3.2.9 Zhvillim i qendrës urbane Ashtë					
3.2.10 Zhvillim i qendrës urbane Kosmaç					
3.2.11 Zhvillim i qendrës urbane Vig					
3.2.12 Zhvillim i qendrës urbane Benë					
	3.3.1 Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës		Bashkia		

	3.3 Rikualifikimi urban	3.3.2 Rikualifikim i qendrës urbane Bushat	Fazat e realizimit të punimeve Sondazhe të qytetarëve Numri i turistëve	Ministria e Zhvillimit Urban
4- TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	4.1.1 Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Mjedisit
		4.1.2 Lidhje funksionale me Planin e Alpeve nëpërmjet ndërhyrjeve për zhvillimin e ekskursionizmit dhe sporteve ujore		
		4.1.3 Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit përgjatë liqenit		
		4.1.4 Realizimi i një korridori të gjelbër në lumin Gjadër		
		4.1.5 Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit		
	4.2 Turizmi kulturor	4.2.1 Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Vig – Sapë – Danjë – Sardë – Koman	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Kulturës
		4.2.2 Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit		
		4.2.3 Realizim i një itinerari për turizmin energjetik		
		4.2.4 Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale dhe ansambleve urbane		
		4.2.5 Projekt ndriçimi skenografik i kështjellave (Sapë, Danjë, Sardë)		
		4.2.6 Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës		
	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	4.3.1 Realizim qendrash për agro - turizëm dhe turizëm eno - gastronomik	Fazat e realizimit të punimeve Numri i turistëve	Bashkia Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
		4.3.2 Projekt për pyllëzimin mjedisor të kodrës së Zefjanës		
		4.3.3 Projekt për brandimin e prodhimeve lokale		
		4.3.4 Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit		
5-	5.1 Strukturat e shërbimit	5.1.1 Realizimi i qendrave agro - ushqimore në Bushat për grumbullimin, magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimit.	Fazat e realizimit të punimeve	Bashkia Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit

		5.1.2 Zona tregtare me prodhime me km zero	Numri i turistëve Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në terma sasiorë dhe cilësorë	Rural dhe Administrimit të Ujërave
		5.1.3 Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmytjeve në zonat malore.		
		5.1.4 Organizimi i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë.		
		5.1.5 Nxitja e shoqërizimit të punës, domosdoshmëri për rritjen e prodhimit bujqësor.		
		5.1.6 Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gështenjën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal.		
	5.2 Rritja e prodhimitarisë	5.2.1 Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehte	Fazat e realizimit të punimeve Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në terma sasiorë dhe cilësorë	Bashkia Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
		5.2.2 Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat dhe Vau-Dejës		
		5.2.3 Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në Vau-Dejës		
		5.2.4 Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë.		
		5.2.5 Zhvillimi i baxhoje në Hajmel dhe Vig-Mnelë		
		5.2.6 Zhvillimi i vreshtave në Hajmel ,Bushat, Vau-Dejës, Vig –Mnelë		
		5.2.7 Asistence Part-Time e veçantë teknike me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë (shkolla profesionale): • Kultivimi i perimeve në sera • Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit.	Fazat e realizimit të punimeve Rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në terma sasiorë dhe cilësorë	Bashkia Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
		5.2.8 Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shege në zona kodrinore, në 6-te fshatra me nga 25 ha në bllok.		
		5.2.9 Park bletësh në Shllak dhe Temal		
6-ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	6.1.1 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike	Fazat e realizimit të punimeve Kuota e kërkesës energjetike lokale i	Bashkia Ministria e Energjisë dhe Industrisë
		6.1.3 Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës		

			përmbushur nga fonde alternative	
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë	6.2.1 Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës	Fazat e realizimit të punimeve Kuota e kërkesës energjetike lokale i përmbushur nga fonde alternative	Bashkia Ministria e Energjisë dhe Industrisë
		6.2.2 Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik		

Seti i tretë i indikatorëve janë të dhënat statistikore, që bashkia duhet t'i mbledhë vetë, apo të ndjekë përditësimin e tyre nga Institucionet e specializuara si INSTAT-i. Proçesi i mbledhjes së informacionit për këtë plan nuk ishte i lehtë; do të ishte e udhës që ky informacion të ruhej e të përditësohej me kujdes, për të lehtësuar zhvillimin e projekteve të ngjashëm, si dhe të PDV-ve dhe Planeve Sektoriale që do të sjellë e ardhmja. Mbledhja e këtyre të dhënave duhet të vazhdojë në mënyre periodike, duke u mbështetur në programe të unifikuara për tërë vendin dhe të aksesueshme për rezultatet edhe nga publiku.

Table 14 Indikatorët për Monitorim periodik

Kategoria	Treguesi
Demografia	Jetëgjatësia
	Dendësia e popullsisë/ hektarë
	Raporti urban/rural i popullsisë
	Nr. lindje në vit
	Nr. vdekje në vit
	Emigrimi dhe imigrimi në Bashki
	Piramida e popullsisë
	Popullsia sipas gjinisë dhe moshës
	Treguesit mbi komunitetet rome
	Prindër të vetëm
	Persona të cilët jetojnë vetëm
Transporti, aksesueshmëria, komunikimi	Punësimi në sektorin e transportit
	Aksesi në këmbë në hapësira të gjelbra
	Koha e udhëtimit për në punë
	Modaliteti i udhëtimit për në punë
	Aksesi në internet
	Numri i udhëtarëve ditorë me tren
	Numri i firmave me website
	Numri i përdoruesve të website të bashkisë
	Numri i përdoruesve të transportit publik në ditë
	Numri i përdoruesve të biçikletave

	Aksesi në ujë të pishëm
Energjia	Emetimet e GHG
	Konsumi i Energjive të rinovueshme
	Investimet në energji
	Prodhimi i energjisë sipas burimit
	Çmimi i elektricitetit dhe gazit
Mirëqënia Sociale	% e popullsisë që jeton në banesa sociale
	Aksesi në shërbime sociale
	% e popullsisë me ndihmë sociale
	Aksesi në shkolla të mesme
	Sipërfaqja mesatare për banim në m ²
	Çmimi mesatar i banesave
	Braktisja e shkollave fillore
	Banesat boshe
	Niveli i sigurisë në zona
	Nr. shtretërish dhe nr. punonjës në shërbime shëndetësore
	% e banesave që kanë mangësi në shërbime bazë
Ekonomia	% e punësimit sipas sektorëve
	% e punësimit në sektorin publik dhe privat
	Numri i bizneseve të mëdha
	Numri i bizneseve të vogla dhe të mesme
	Lëvizjet për qëllime punësimi
	Specializimi ekonomik (investimet sipas sektorëve)
	Dendësia e punësimit sipas zonave
	Investime në ekonomi të gjelbërta
	Investime në sipërmarrje sociale
	Numri i turistëve
	Numri i shtretërve në Hotel për zonë
	% e vetëpunësimit
Mjedisi	% e zonave me vlera të larta ekologjike
	Nr. i banesave të lidhura me sistemin e kanalizimeve
	Nivelet e zhurmës
	Cilësia e ajrit
	Erozioni
	Cilësia e Ujit të Pishëm
	Tërmetet
	Temperaturat mesatare
	Niveli i reshjeve
	Thatësirat
	Përmbytjet
	Emetimet e GHG
	Rrëshqitjet e tokës
	% Mbulimi e Tokës
	Nivelet e zhurmës

PPV Bashkia Vau-Dejës
Plani i Zhvillimi të Territorit

Institucionale	Pjesëmarrja elektorale
	Partneritete publike private
	Nr. i përdoruesve të shërbimeve publike
	Nr. i përdoruesve të zyrave të informacionit
	Kënaqësia e publikut me shërbimet qeverisësë
Territoriale	% e humbjes së tokës bujqësore
	% e humbjes së tokës natyrore
	% e mbulesës së tokës
	% e zhvillimit për qëllime banimi
	% e zhvillimit për qëllime shërbimi
	% e zhvillimit për qëllime tregtare
	% e zhvillimit për qëllime infrastrukturore

7 RISHIKIMI I PPV

Në Neni 26 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” referohen kushtet dhe faktorët që mund të kontribuojnë në rishikimin e PPV. Në mënyrë specifike PPV ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative dhe territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

PPV është një mekanizëm zhvillimi fleksibël i cili ka për qëllim orientimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit. Në këtë optikë, PPV mund të pësojë ndryshime dhe rishikime gjatë kohës në përshtatje me nevojat e zhvillimit dhe me kushtet e paraqitura në momentin e kërkesës për rishikim. Rastet kryesore kur lind nevoja për rishikimin e PPV janë:

- Rishikim për interesa madhore apo kombëtare
- Rishikim për mospërputhje me legjislacionin
- Rishikim në kuadër të ndryshimeve në PPK, PINS si dhe strategjive kombëtare të zhvillimit
- Rishikim si pasojë e ndryshimit të kufijve administrativë të bashkisë
- Rishikim në interes të investimeve në ekonomi me vlerë mbi 20 milionë euro
- Rishikim në kushte të jashtëzakonshme (fatkeqsi natyrore, luftë, emergjenca civile)
- Rishikim në raste të tjera të paparashikuara që krijojnë një problem madhor në zbatimin e strategjisë territoriale dhe të zhvillimit

Në çdo rast, rishikimi i planit nuk është i mundur nëse:

- Bie në kundërshtim me objektivat e zhvillimit dhe ato strategjike si dhe me konceptet bazë të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë Territoriale
- Ndërhyn duke bërë ndryshime në zona ku shtrihet mbi 10 % e territorit apo ku vendoset mbi 10 % e popullsisë.

Në rast se ndërhyrje të tilla janë të nevojshme atëherë nevojitet hartimi i një PPV të ri i cili i përgjigjet nevojave të reja për zhvillimin e territorit dhe të ekonomisë në Bashkinë Vau-Dejës.

Çdo rishikim i PPV bëhet pasi dokumentohet nevoja për rishikim, pasi realizohen dëgjesa publike dhe pasi konsultohen ekspertë të fushës përkatëse. Mbështetur në këtë proces, kryetari i Bashkisë mund të iniciojë rishikimin e PPV duke ndjekur të gjitha hapat ligjore të nevojshme për realizimin e saj.

8 KAPACITETET INSTITUCIONALE

8.1 HYRJE

Në këtë Raport për kapacitetet institucionale të Bashkisë Vau-Dejës është bërë një panoramë e gjendjes ekzistuese, sfidave dhe problematikave kryesore me të cilat përballet stafi i bashkisë në kontekstin e ndryshimeve thelbësore që ka sjellë reforma territoriale-administrative.

Në raport fillimisht përshkruhet roli i Qeverisë Qendrore e cila përveçse ka udhëhequr gjithë procesin e reformës territoriale-administrative, ka ndërmarrë edhe një seri hapash konkret për implementimin e saj për një periudhë sa më të shkurtër duke i ardhur në ndihmë direkte njësive të reja të qeverisjes vendore të formuara, në procesin e decentralizimit efektiv. Ndër më kryesoret mund të përmendim:

- Ngritja e Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale
- Miratimi i strategjisë ndërsektoriale për decentralizim dhe qeverisjen vendore 2015–2020

Duke qenë se raporti i kapaciteteve institucionale hartohet si pjesë e dokumenteve të PPV-së të bashkisë Vau-Dejës, në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i gjithë institucioneve (autoriteteve) qendrore të cilat në zbatim të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, kanë kompetenca dhe detyra të mirë përcaktuara në këtë sektor. Përveç autoriteteve vendim-marrëse në nivel qendror, raporti paraqet dhe rolin Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) në përputhje me ndryshimet e fundit të kuadrit ligjor (Ligjit të planifikimit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij).

Gjithashtu, është bërë dhe një prezantim i shkurtër i platformës kombëtare e-Albania pjesë e të cilës është dhe portali e-Lejet që përbën një sistem elektronik për aplikimin për lejet e ndërtimit. Sistemi elektronik i lejeve është baza e të dhënave shtetërore për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, pjesë e Regjistrit të Integruar të Territorit, dhe realizon ndërveprimin e të gjitha subjekteve të përfshira në proces, duke përfshirë aplikuesin, autoritetet përgjegjëse për dhënien e lejeve dhe institucionet publike që kanë detyrimin ligjor të japin informacion apo pëlqim lidhur me kërkesën për leje.

Në pjesën e dytë të këtij raporti është paraqitur analiza institucionale e bashkisë Vau-Dejës. Duke patur parasysh që aktualisht, procesi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit ka një karakter multi-disiplinor kjo analizë e përgjithshme ka shërbyer për të evidentuar nevojën e një bashkëpunimi të vazhdueshëm mes njësive dhe drejtorive të ndryshme. Gjithashtu, në

këtë pjesë përshkruhen edhe masat e propozuara për rritjen e efikasitetit të bashkisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

8.2 REFORMA ADMINISTRATIVE DHE SFIDAT KRYESORE TE BASHKISE VAU-DEJËS

Reformat thelbësore të viteve të fundit, ku më kryesorja Reforma Administrativo-Territoriale, kanë bërë që stafet e bashkive të reja të përballen me një sërë sfidash rëndësishme për të arritur funksionimin efektiv dhe adekuat, që mbeten dhe qëllimi kryesor i këtyre reforma. Rritja e territorit, ndryshimet strukturore dhe funksionale në organizim, kuadri i ri ligjor i shoqëruar dhe me rritjen e disa shërbimeve dhe kompetencave kanë bërë të domosdoshëm një ri-strukturim të organigramave të bashkive me fokus rritjen e kapaciteteve teknike dhe organizmin e përshtatshëm të tyre. Ndër synimet kryesore të reformës Administrativo-Territoriale janë

- rritje e efikasitetit dhe përmirësimin e cilësisë e të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike vendore;
- rritje e burimeve financiare dhe të mjeteve për qeveritë vendore;
- përmirësim i mekanizmave të demokracisë përfaqësuese dhe fuqizimin e instrumenteve të demokracisë direkte;

rritje e kapaciteteve të administratës publike vendore, si dhe forcimin e strukturave komunitare në nivel njësie vendore, lagje dhe fshati.

8.3 ROLI I QEVERISE VENDORE

8.3.1 Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Reforma Administrativo-Territoriale dhe decentralizimi janë një prioritet kyç i Qeverisë qendrore. Për këtë qëllim madhor në emër të Qeverisë, vepron Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, i cili do mbështesë zbatimin e kësaj reforme, në të gjitha etapat, nëpërmjet një procesi pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar, si dhe me praktikën më të mira ndërkombëtare. Bazuar në VKM Nr. 1012, datë 22.11.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore” detyrat e Ministrit përsa i përket zbatimit të reformës dhe pushtetit lokal janë:

- Drejton, bashkërendon punën dhe ndjek në tërësi procesin e kryerjes së reformës administrativo-territoriale.
- Bashkërendon punën dhe ndjek realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit e të qeverisjes vendore.
- Harton dhe/ose bashkërendon punën për projekt-aktet ligjore e nënligjore në fushën e decentralizimit e të qeverisjes vendore.

- Drejton dhe/ose bashkërendon punën ndërmjet strukturave të ngritura në kuadrin e marrëdhënieve ndërinstytucionale me njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë.
- Përfaqëson politikat e qeverisë në fushën e reformës së decentralizimit e të qeverisjes vendore pranë nismave dhe organizatave ndërkombëtare.

8.3.2 Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale

Qeveria me qëllim mbështetjen e njësive të reja të qeverisjes vendore deri në garantimin e funksionalitetit të plotë të tyre ka ngritur Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale. Kjo agjenci do të ketë rol bashkërendues dhe koordinues midis institucioneve qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore për zgjidhjen e problematikave që dalin nga procesi i tranzicionit të bashkimit të njësive të reja vendore. Mandati i agjencisë do të jetë udhëzimi dhe asistenca në drejtim të shpërndarjes së fondit financiar të tranzicionit të parashikuar në buxhetin e shtetit si dhe do të informojë në vazhdimësi të gjithë institucionet dhe partnerët mbi ecurinë e zbatimit të reformës administrative-territoriale.

Kjo Agjenci u ngrit në zbatim të VKM Nr. 83, datë 28.1.2015, *“Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale”*.

Në zbatim të këtij vendimi AZRT-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

- Mbështet ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore në bashkërendimin e masave dhe proceseve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organeve të qeverisjes vendore, në kuadrin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale.
- Mbështet dhe udhëzon punën administrative të institucioneve shtetërore dhe organeve të qeverisjes vendore për zbatimin e legjislacionit në fuqi, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.
- Ofron shërbime për njësitë e qeverisjes vendore, në kuadrin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale.
- Bashkërendon punën me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështetin reformën administrativo-territoriale.
- Ndërmerr dhe/ose zbaton projekte në mbështetje të njësive të qeverisjes vendore për garantimin e funksionalitetit administrativ dhe infrastrukturor, në kuadrin e reformës administrativo-territoriale.
- Ndihmon në hartimin e ndryshimeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për zbatimin e reformës administrative-territoriale.
- Informon në mënyrë periodike institucionet publike dhe grupet e interesit për ecurinë e zbatimit të reformës administrativo-territoriale.
- Bën vlerësimin e kërkesave të njësive të qeverisjes vendore për përdorimin e fondit transitor për zbatimin e reformës territoriale.

8.3.3 Strategjia ndërsektoriale për decentralizim dhe qeverisjen vendore 2015–2020

Në kuadër të Reformës Territoriale-Administrative, me nismën e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore (si përfaqësues i Qeverisë Shqiptare) dhe me asistencën e donatorëve kryesorë³ që operojnë në vendin tonë, në një periudhë kohore 1 vjeçare⁴, është hartuar dokumenti strategjik afatshkurtër i cili paraqet drejtimit kryesore të zbatimit të kësaj reforme. Ky dokument është miratuar me:

VKM Nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”

Hartimi i këtij dokumenti strategjik merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur reforma administrative-territoriale ka hyrë në fazën e parë të zbatimit të saj dhe mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të rritjes së efikasitetit të qeverisjes vendore dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020 paraqet vizionin e qeverisë për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore dhe përparimit të procesit të decentralizimit sipas standardeve evropiane. Qëllimet dhe objektivat e kësaj strategjie përputhen plotësisht me qëllimet dhe objektivat e përgjithshëm të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, për zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë, në rrugën e saj drejt integritetit evropian.

Ndër objektivat kryesore të kësaj strategjie janë:

Mbështetja institucionale dhe infrastrukturore për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

Njësitë e reja të qeverisjes vendore do të funksionojnë me një model të ri organizimi në territor, ku bashkitë e reja do të kenë në strukturën e tyre administrative të detyruar me ligj edhe njësitë administrative përbërëse (ish-komunat).

Lidhja funksionale midis bashkive të reja dhe njësive të tyre përbërëse do të kërkojë mbështetje me asistencë teknike për ndërtimin e modeleve të organizimit institucional dhe administrativ brenda bashkisë së re si dhe mbështetje infrastrukturore për të bërë lidhjen

³ PLGP/USAID, OSBE-ja, Këshilli i Evropës, Agjencia Zvicerane për Zhvillim Ndërkombëtar, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim, PNUD dhe DLDP.

⁴ Procesi i hartimit të “Strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020” filloi në mars 2014 dhe përfundoi në shkurt 2015. Në korrik 2015 miratohet në Këshillin e Ministrave.

fizike dhe virtuale (komunikimi online) midis tyre. Do të synohet që njësitë administrative të jenë mjaftueshmërisht funksionale për të garantuar një nivel të lartë të shërbimeve administrative në to.




Fig. 27 Kuadri i politikave strategjike të SKNDQV-së 2015–2020

Qëllimi kryesor i strategjisë është konsolidimi i autonomisë vendore nëpërmjet mbështetjes për funksionimin me efikasitet të strukturave përfaqësuese, ekzekutive dhe komunitare të qeverisjes vendore në të gjitha nivelet.

8.3.4 Institucionet (autoritetet) qendrore në planifikimin dhe zhvillimin e territorit

Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i funksionimit të autoriteteve qendrore dhe rolit të tyre në planifikimin dhe zhvillimin e territorit në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave funksionon në zbatim të ligjit nr. 9000, dt. 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Përveç kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, Këshilli i Ministrave ngarkohet me disa përgjegjësi konkrete në fushën e planifikimit dhe

të zhvillimit të territorit bazuar në legjislacionin përkatës⁵ të këtij sektori, ku ndër më kryesoret përmendim:

- Hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar
- Miratimin e rregulloreve në nivel kombëtar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
- Mbështet e zhvillimit të burimeve të nevojshme njerëzore e profesionale, në nivel qendror dhe vendor, për planifikimin e territorit, kontrollin e zhvillimit dhe administrimin e regjistrit të integruar të territorit.

Këshilli Kombëtar i Territorit

Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. Ky organ funksionon në zbatim të Ligj nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe përbërja e tij aktualisht përcaktohet në VKM nr. 1097, dt. 28.12.2015 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”. Në zbatim të këtij kuadri ligjor KKT ka këto kompetenca:

- Miraton, dokumenteve të planifikimit, kërkuar nga autoritetet e planifikimit;
- Miraton e dokumentet sektorial të planifikimit;
- Përcakton rëndësinë kombëtare të një çështjeje, zone ose objekti në planifikimin e territorit, dhe miraton planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, kur parashikohen të tilla nga Plani i Përgjithshëm i Territorit.

Ministria e Zhvillimit Urban

Ministrisë e linjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktualisht Ministria e Zhvillimit Urban funksionin në zbatim të ligjit nr. 9000 dt. 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe përgjegjësitë kryesore përcaktohen në VKM nr. 944, dt. 9.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë së zhvillimit urban dhe turizmit”, i ndryshuar me VKM nr.159, dt. 25.02.2015.

Në zbatim të Ligj nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” kjo ministri ka këto përgjegjësi kryesore:

- përgatitjen e politikave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- hartimin e kuadrit ligjor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- marrjen e nismës dhe koordinimin e punës për hartimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit, si dhe për rishikimin e tij;
- marrjen e nismës, sipas rastit, dhe koordinimin e punës për hartimin e planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe për rishikimin e tyre;

⁵ Ligj nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji

- bashkërendimin e objektivave të autoriteteve qendrore të planifikimit në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare;
- kryerjen e studimeve dhe vlerësimeve në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në përfundim, i parashtrohet Këshillit të Ministrave për shqyrtim dhe miratim masat për përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës dhe përmirësimin e ecures së detajimit të Planit të Përgjithshëm të Territorit;
- hartimin e rregullores së ndërtimit bazuar në propozimet e dhëna nga ministrinë e tjera për rregulloret e ndërtimit të sektorëve përkatës;
- mbështetjen e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e planifikimit të territorit;
- nxitjen dhe mbështetjen e nismave dhe programeve për përmirësimin e cilësive profesionale e teknike të autoriteteve të planifikimit.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është institucion me përgjegjësi planifikimi në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. AKPT aktualisht funksionon në zbatim të Ligjit 107/2014 dhe VKM nr. 427, dt. 8.6.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”. Përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të AKPT-së në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi janë:

- bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit e zhvillimit të territorit dhe mbështet bashkërendimin vertikal e horizontal ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit.
- udhëheq, koordinon dhe ndërlidh veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në arkitekturë e planifikim;
- është përgjegjëse për informimin e proceseve të përmirësimit të legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- administron dhe mirëmban bazën e integruar të të dhënave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- është përgjegjëse për informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit, si dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së tij gjatë proceseve të hartimit e zbatimit të dokumenteve të planifikimit.
- angazhon njësitë e saj përgjegjëse për të siguruar standardet ligjore, teknike dhe metodologjike të fushës së planifikimit e zhvillimit;
- është përgjegjëse për përgatitjen e studimeve për Sistemin e Integruar të Planifikimit në Republikën e Shqipërisë dhe propozimet për ministrin përgjegjës për zhvillimin urban, KKT dhe Këshillin e Ministrave për masat për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe për procese e veprimtari në lidhje me planifikimin e zhvillimin e territorit
- harton Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave, të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare.

Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT)

Agjencia e Zhvillimit të Territorit, funksionon në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 725, dt. 2.9.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”. AZHT është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban. Në zbatim të këtij kuadri ligjor AZHT ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit;
- organizon, drejton dhe bashkërendon procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe/ose vendor, me qëllim përgatitjen për shqyrtim dhe miratim të dokumenteve në kompetencë të KKT-së, sipas parimit të shërbimit me një ndalesë;
- bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera përgjegjëse për çështje të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, që janë në kompetencë të KKT-së;

siguron që dokumentet e kontrollit të zhvillimit, në nivel qendror e vendor, të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dokumentet e miratuara të planifikimit në çdo nivel.

8.3.5 Instrumentet Kombëtare të Planifikimit

Ministria e Zhvillimit Urban, si përfaqësuese e Qeverisë Shqiptare, ka udhëhequr procesin e hartimit të tre instrumenteve të planifikimit në nivel kombëtar. Pas një pune më shumë se 2-vjeçare, KKT në qershor të vitit 2016 ka miratuar këto instrumente sipas vendimeve të mëposhtme:

- Vendim KKT nr. 1, dt. 14.06.2016 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar”
- Vendim KKT nr. 2, dt. 14.06.2016 “Për miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar”
- Vendim KKT nr. 3, dt. 14.06.2016 “Për miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës”

Finalizimi i tre instrumenteve kryesore të planifikimit në nivel kombëtar, ka krijuar tashmë një bazament solid për një zhvillim dhe mirë-menaxhim të territorit duke i ardhur në ndihmë dhe njësive të qeverisjes vendore në përcaktimin e prioriteteve dhe politikave kryesore zhvillimore që duhen marrë në konsideratë gjatë hartimit të instrumenteve vendor të planifikimit.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, si instrumenti më i lartë në hierarkinë e dokumenteve të planifikimit, do të jetë korniza orientuese mbi të cilën duhet të mbështeten të gjitha projektet strategjike zhvillimore, planet rajonale dhe strategjitë sektoriale që do të hartohen dhe zbatohen nga ministritë e linjës, në 15 vitet e ardhshme. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, përveç rolit udhëheqës dhe koordinues në hartimin e tre planeve, do të kenë edhe detyrimin për monitorimin e zbatimit të tyre. Në bashkëpunim të ngushtë me Agjencitë e Zhvillimit Rajonal, do të asistohen bashkitë në

zbatimin e modeleve dhe projekteve konkrete rajonale për stimulimin e zonave me potencial ekonomik, për të garantuar kohezionin territorial, social dhe zhvillimin ekonomik me efekt rajonal.

8.3.6 Portali e-Albania dhe e-Lejet

Portali unik qeveritar e-Albania si dhe platforma Qeveritare e Ndërveprimit janë elementët kryesor të një progresi të evidentuar edhe nga strukturat e Komisionit Evropian në fushën e Shoqërisë së Informacionit dhe qeverisjes elektronike. Portali e-Albania është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për ofrimin e shërbimeve të shumta elektronike për institucionet shtetërore, qytetarin dhe biznesin. Nëse vizitojmë faqen zyrtare të këtij portali (<https://e-albania.al/>), në rubrikën e-Shërbimet, konstatojmë numrin e madh të shërbimeve që ofron ky portal (mbi 1000 shërbime për qytetarët dhe bizneset).

Sistemi elektronik për aplikimin për lejet e ndërtimit, është një tjetër nismë e qeverisë shqiptare e udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

Ky sistem, i cili është pjesë e platformës e-Albania, u vjen në ndihmë të gjithë institucioneve të përfshira në procesin e lejdhënies dhe veçanërisht njësisë të qeverisjes vendore, si institucionet përgjegjëse për planifikimin vendor, duke lehtësuar ndërveprimin institucional, shkurtuar afatet për pajisje me leje ndërtimi dhe rritur transparencën.

Ofrimi i shërbimit të lejdhënies nëpërmjet këtij sistemi ka thjeshtuar punën e bashkive në shqyrtimin e lejeve, ka rritur transparencën në procedimin e kërkesës për leje, ka lehtësuar përpunimin e të gjithë informacionit administrativ për qytetarët, zhvilluesit dhe ndërtuesit që aplikojnë për leje ndërtimi.



Fig. 28 Pamje e faqes zyrtare të portalit e-Albania

Ministria e Zhvillimit Urban dhe AKPT, për disa muaj me radhë, janë angazhuar direkt edhe në trajnimet e stafëve teknike të Bashkive me qëllim përdorimin efektiv të kësaj platforme.

Gjithashtu me ndryshimet e fundit ligjore, konkretisht me VKM Nr. 271, datë 6.4.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar” jepen të gjitha procedurat e përdorimit të këtij portali në procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit. Ky ndryshim ligjor e ka kthyer përdorimin e këtij portali në një detyrim ligjor të cilët duhet t’i përmbahet me rigorozitet dhe efikasitet stafi i bashkisë Vau-Dejës që është direkt i lidhur me procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit.




Fig. 29 Faqja zyrtare e portalit e-Lejet

Sistemi informon në kohë reale qytetarin se në cilin institucion ka mbetur praktika e tij, dhe mbi të gjitha gjeneron automatikisht vendimet e miratimit, në rast heshtjeje nga institucionet përgjegjëse. Kuptohet që, në rast se miratimi në heshtje ka rezultuar në një vendim që është në shkelje të ligjit, nëpunësit që me heshtjen e tyre kanë shkaktuar këto shkelje do të mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

8.4 RITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË BASHKISË VAU-DEJËS

Në kuadër të reformës territoriale, Bashkia Vau Dejës, ka pësuar ndryshime jo vetëm në rritjen territoriale të saj, por dhe në organizimin e strukturës organizative. Bashkimi me ish qytetin e Vau-Dejës i Bushatit, Hamelit, Vig Mnelës, Shllakut dhe Temalit përveç rritjes territoriale dhe aseteve bujqësore, natyrore dhe turistike ka rritur edhe problematikat me të cilat përballohet sot stafi i bashkisë Vau Dejës, kryesisht në ofrimin e shërbimeve.

Siç është përmendur në gjithë raportet e PPV, problematikat kryesore sa i përket ofrimit të shërbimit shfaqen në Njësitë administrative të Shllakut dhe Temalit për të cilat mungon edhe akses i drejtpërdrejtë nga qyteti qendër i Vau Dejës (në kuptim të zonës funksionale). Problematika e shërbimeve që i ofrohen banorëve në shumë aspekte lidhet edhe me fuqinë financiare të bashkisë për të përballuar investime në sektor të ndryshëm. Gjithsesi rritja e nivelit të punonjësve dhe krijimi i sistemit të karrierës brenda institucionit duhet të jetë në

fokusin e bashkisë pasi shpesh herë janë stafi teknik që mbështet / ose jo, thithjen e fondeve të ndryshme nga qeveria qendrore apo donatorë të huaj.

Në respektim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, funksionet dhe kompetencat e NJQV-ve, nga të cilat rrjedhin edhe shërbimet publike në sektorë të ndryshëm, ndahen në 7 grupe kryesore (duke përjashtuar funksionet e deleguara):

1. Funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
2. Funksionet në fushën e shërbimeve sociale;
3. Funksionet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
4. Funksionet në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
5. Funksionet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
6. Funksionet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
7. Funksionet në fushën e sigurisë publike;
8. Funksionet dhe kompetencat e deleguara.

Ky grupim i funksioneve pasqyrohet edhe në strukturën e bashkisë Vau Dejës e cila është e organizuar sipas 7 drejtorive kryesore (teknike) e cila paraqitet në vijim.

Duke qenë se PPV është një instrument që përcakton objektiva dhe jep orientime për zhvillimin e gjithë sektorëve zhvillimor duhet patur parasysh që edhe procesi i zbatimit të këtij dokumenti kërkon maksimalisht përfshirjen e stafit teknik të bashkisë. Jo rastësisht një nga kërkesat kryesore për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor ishte dhe lidhja me dokumentin e Projekt Buxhetit Afat-Mesëm të bashkisë. Puna e përbashkët me zyrën e financës pranë bashkisë ka ndihmuar shumë grupin e punës në përzgjedhjen dhe kategorizimin e projekteve prioritare bazuar në mundësitë reale të bashkisë për financim por njëkohësisht edhe në përputhje me nomenklaturën/ terminologjinë e përdorur nga hartuesit e buxhetit.

Rasti i mësipërm tregon qartë nevojën e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura të punës së përbashkët të drejtorisë ekonomike me atë të planifikimit urban. Normalisht që ky bashkëpunim duhet të vijë në rritje pas miratimit të PPV. Në këtë kuadër bashkëpunimi me Drejtorinë që mbulojnë sektorin e bujqësisë dhe pyje/kullota, që përbëjnë dy prej sistemeve bazë territoriale, është i domosdoshëm në zbatimin e këtij dokumenti. Zyra juridike, po ashtu (apo sektori ligjor sipas emërimit të strukturës ekzistuese) duhet të mbikëqyrë në vazhdimësi përmbajtjen e akteve dhe dosjeve që aplikohen për qëllime zhvillimi.

PPV Bashkia Vau-Dejës
Plani i Zhvillimi të Territorit




Fig. 30 Organigrama e Bashkisë Vau-Dejës

8.4.1 Masat institucionale

Analiza e strukturës, organizmit ekzistues të bashkisë Vau Dejës dhe ndryshimet thelbësore që kanë sjellë reformat e ndërmarra vitet e fundit në vendin tonë përcaktojnë qartësisht nevojat kryesore në masat institucionale që duhen ndërmarrë për të ofruar një shërbim sa më cilësor dhe rritjen e kapaciteteve. Në vijim paraqiten masat kryesore institucionale që duhen ndërmarrë nga bashkia Vau Dejës.

Realizimi i tyre në disa raste kërkon një angazhim maksimal të stafit teknik të bashkisë dhe financime konkrete që duhet të jenë pjesë e parashikimeve buxhetore afat-mesme të bashkisë, por në raste specifike edhe asistenca e qeverisë qendrore dhe e donatorëve të huaj është e domosdoshme për vetë karakterin e lartë teknik që paraqesin këto masat institucionale. Në këtë kuadër propozohen të merren masat e mëposhtme:

Organizimi i degës bujqësore - teknike pranë institucionit të Bashkisë.

Duke konsideruar profilin e mirëfilltë bujqësor që ka bashkia Vau Dejës duhet një rritje e ndjeshme e kapaciteteve në drejtorinë e bujqësisë dhe shërbimit veterinar. Specialistë e punësuar në sektorët e zhvillimit bujqësor dhe veterinar duhet që realisht të marrë rolin udhëheqës në këtë sektori që përbën aksin kryesor zhvillimor të bashkisë.

Në këto kushte roli i specialistit (agronom/veteriner) dhe niveli i përgatitjes është shumë i rëndësishëm. Aktualisht, në këtë institucion, punon vetëm 1 specialist agronom i larte. Duhet patjetër të gjendet mënyra, që të paktën fillimisht, çdo njësi administrative të mbulohet me specialist agronom. Në Nj. A. Hajmel duhet caktuar një agronom i larte që të mbulojë dhe Nj.A. Vig-Mnele. Në Nj.A. Bushat duhet caktuar një agronom i larte. Në Nj.A. Shllak dhe Temal duhet caktuar një agronom. Pra sugjerojmë që minimalisht duhen shtuar 3 agronome të tjerë në strukturë.

Ndër të tjera këta specialistë duhet të mbulojnë edhe këto detyra:

- administrimin e hartave kadastrale dhe të Librave të ngastrave duke drejtuar azhurnimin e vazhdueshëm të tyre;
- administrimin e hartave të kanaleve ujitës dhe kullues të dyte dhe të trete, duke ballafaquar gjendjen reale të tyre dhe drejtuar kryerjen e punimeve dhe të investimeve;
- evidentimin e mbjelljeve të realizuara si dhe të rezultateve në prodhim;
- caktimin e fermerëve dhe fermave pilot, 2 -3 për çdo Nj.A. , në ngastrat e të cilave organizon seminare me fermerët;
- Organizon punën për mbajtjen e librit të fermerit;
- Organizon kontakte me institucione bujqësore dhe shkencore brenda dhe jashtë territorit të Bashkisë;
- evidenton gjendjen e mekanikës bujqësore dhe agregateve në njësinë që mbulon;

- Mbulon dokumentimin e arkivës për të gjithë dokumentacionin e mbajtur periodikisht që ka lidhje me sektorin e bujqësisë

Menaxhim, mirëmbajtje dhe plotësim i databazës së informacionit të mbledhur dhe të përpunuar në platformën GIS gjatë procesit të hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë. Plotësimi në mënyrë të vazhdueshme i kësaj databaze duke pasqyruar të gjitha zhvillimet që ndodhin në sistemin urban e infrastrukturor dhe të dhëna të ndryshme për sistemet e tjera territoriale, përveçse një detyrim ligjor, do ndihmonte dhe stafin e bashkisë për të pasur një panoramë të qartë të mundësive të zhvillimit në tërësi të territorit në është krijuar një bazë e mirë informacionit të cilën tashmë bashkia duhet të vazhdojë ta plotësojë në mënyrë periodike.

Krijimin e një sektori efikas të statistikave lokale dhe grumbullimin e statistikave të bazuar në treguesit e propozuar në plan si dhe për nevoja të tjera lokale (bizneset, popullsinë, turistët, prodhimin bujqësor dhe blegtoral etj.). Në këtë kuadër sigurimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Drejtoritë Lokale përfaqësuese të Autoriteteve Qendrore (Qarku Shkodër, DAMT, Bordin Kullimit etj.) dhe operatorë të ndryshëm lokal që si rezultat i punës së tyre disponojnë të dhëna, do ishte mjaft me vlerë. Gjithashtu duhet konsideruar dhe akti i ri që po përgatitet në nivel qendror për mënyrën e raportimit të zbatimit të PPV-së. Aty do parashikohen disa kritere / indikator që tregojnë në mënyrë periodike zhvillimet/ ndryshimet në territor.

Plotësimi i databazës së informacionit dhe inventarizimi i pyjeve, kullotave, tokave bujqësore me qëllim rritjen e potencialeve zhvillimore në këto sektor. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me Bordin e Kullimit, hartimi i një harte dixhitale të të gjithë kanaleve parësore, dytësore dhe tretësore në shërbim të bujqësisë është i domosdoshëm.

Inventarizim dhe krijimi i një databazë informacioni në lidhje me zhvillimin ekonomik me fokus atë të turizmit.

Krijimi i ambienteve të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit të punës. Këtu përfshihen zgjerime apo ambiente të reja që duhet të sigurohen nga Bashkia dhe plotësimi i bazës materiale të zyrave të bashkisë dhe njësive administrative me kompjuter, software të nevojshëm.

Sigurimi i një linjë interneti me kapacitetet të lartë (upload dhe download) për gjithë stafin e bashkisë por veçanërisht sektorin e prokurimeve dhe atë të lejeve të cilët në punën e përditshme kanë nevojë të ngarkojnë sasi të mëdha dokumentacioni në rrjet.

Rritja e burimeve njerëzore dhe përmirësim i infrastrukturës së nevojshme për zyrën e kadastrës së Bashkisë. Në këtë kuadër ngritjen e një databaze elektronike me gjithë pronat e bashkisë dhe hartimin e një plani afat-mesëm për regjistrimin e pronave të transferuara bashkisë Vau Dejës. Në fokus duhet të jenë kryesisht njësitë administrative (ish komunat) të

cilat nuk kanë realizuar fare (ose në nivele mjaft të ulëta) evidentimin, matjen dhe regjistrimin e pronave të transferuara.

Përgatitja e një skeme efikase bashkëpunimi mes drejtorive të ndryshme brenda Bashkisë.

Duke qenë se procesi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit kërkon një ekspertizë multi-disiplinore (jurist, gjeodet, urbanist, arkitekt, IT, ekspert GIS, agronom, inxhinier ndërtimi, infrastrukture e mjedisi, dhe në raste të veçanta edhe të tjerë specialistë) është e domosdoshme ngritja e një skeme bashkëpunimi të qartë që siguron në nivel të lartë ligjshmërinë e akteve të përgatitura nga stafi teknik dhe ndihmon procesin e vendimmarrjes. Kjo skemë bashkëpunimi të bëhet pjesë e Rregullores së Brendshme të Bashkisë.

8.4.2 Trajnimet e stafit

Duke konsideruar analizën e bërë të organigramës së bashkisë, strukturës së departamentit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe njohuritë e nevojshme, ligjore dhe teknike, për zbatimin e PPV del e nevojshme që stafi të trajnohet në disa drejtime. Trajtime të stafit të bashkisë në ato sektor të identifikuar si kryesoret:

- Njohje me kuadrin ligjor të ndryshuar si rezultat i reformës territoriale-administrative me fokus:
 - Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe gjithë paketës ligjore me ndikim në kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive të reja të qeverisjes vendore;
 - Ligjin “Për planifikimin e territorit” akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe rregulloret, udhëzimet dhe normat e projektimit që sigurojnë një zhvillim urban të qëndrueshëm dhe cilësorë;
 - Ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” akteve nënligjore që rrjedhin prej tij;
 - Dhe ato paketa ligjore sektoriale që kanë lidhje direkte me procesin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kryesisht për zhvillimin e turizmit, infrastrukturat, menaxhimin e tokës bujqësore.
- Planifikim dhe menaxhim territori bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, kryesisht për zonat me impakt në zhvillimin e turizmit;
- Menaxhim i zonave të mbrojtura me vlera të larta mjedisore të pranishme në territorin e kësaj bashkie
- Zhvillim rural dhe menaxhimin e pyjeve
- Njohje dhe aplikim i praktikave bashkëkohore me qëllim krijimin e një pakete turistike që garanton një turizëm gjatë gjithë vitit (bregdeti, zonat dhe monumentet arkeologjike, kulinaria, peshkimi etj.).
- Menaxhim i rreziqeve natyrore me fokus përmbytjet dhe ndryshimet klimatike (erozionin) të cilat vitet e fundit janë bërë një kërcënim konkret për komunitetin e kësaj zonë dhe zhvillimin në tërësi

Përsa i përket planifikimit dhe menaxhimit të territorit, trajnimet mund të konsistojnë në:

- Hartim politikash zhvillimi me fokus zonat me potenciale të larta të zhvillimit të turizmit bregdetar, malor dhe agro-turizmit
- Përdorimi i instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në kuptim të ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit (Intensiteti i ndërtimit me kushte, transferimi i së drejtës për zhvillim, zhvillimi i detyrueshëm i tokës, pezullimi i zhvillimit, Servituti publik, e drejta e transferimit, e drejta e preferimit, etj.)
- Përdorim i GIS në përputhje me standardet shtetërorë dhe Regjistrin të Territorit
- Menaxhim projektsh zhvillimi duke përfshirë praktika PPP (Public Private Partnership) kryesisht për banesa sociale dhe shërbime të ndryshme në zonat turistike
- Rregulla të përdorimit të tokës

Ndërkohë përsa i përket çështjeve sociale trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve mund të konsistojë në:

- Trajnime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje
- Trajnime për trajtimin e grave të dhunuara
- Trajnime për këshillimin e të rinjve
- Trajnime për strehimin social

8.4.3 Gjithpërfshirja e qytetarëve në proceset qeverisëse

Bashkia Vau Dejës, aktualisht e radhitur ndër bashkitë me performancë relativisht të mesme në rang vendi⁶, përsa i përket transparencës ndaj publikut duhet të jetë e angazhuar maksimalisht të përmirësojë shërbimet në këtë drejtim në të gjitha funksionet që kryen por njëkohësisht një vëmendje e veçantë duhet të jetë dhe në procesin e zbatimit të PPV-së.

Gjithashtu duhet të krijohen programe të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare. Pra krijohen mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë. Praktika të planifikimit në nivel “lagjeje” dhe “komuniteti” do të testohen dhe aplikohen si një mënyrë novatore për zhvillimin e qëndrueshëm territorial.

Sa i përket shërbimeve administrative, me mbështetjen edhe të Qeverisë Zvicerane, përmes dldp, bashkia Vau Dejës aktualisht ka operative Qendrën me Një Ndalesë ku ofrohen një numër i madh shërbimesh administrative. Madje, në këtë kuadër bashkia Vau Dejës është vlerësuar në nivel kombëtar sa i përket implementimit të këtij instrumenti shërbimesh me impakt të madh për komunitetin. Ngritja dhe përforcimi i Qendrave me Një Ndalesë në

⁶ Raporti: Monitorimi 2017- Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë, realizuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik INFOÇIP. Sipas këtij raporti, Bashkia Vau Dejës renditet e 33-ta, në tabelën vlerësuese të 61 bashkive, sipas 5 komponentëve e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

secilën njësi administrative është hapi i radhës që duhet të ndërmarrë bashkia në këtë drejtim për të siguruar bashkëveprimi komunitar dhe garantuar kohezion social.

9 ANEKS

Anekset e bashkëngjitura:

Aneksi 1: Konsultat publike të kryera gjatë hartimit të PPV

Aneksi 2: Materiali hartografik

U/III-01	Harta e ndarjes së territorit sipas sistemeve bazë
U/III-02	Harta e sistemit urban
U/III-03	Harta e sistemit infrastrukturor
U/III-04	Harta e sistemit bujqësor
U/III-05	Harta e sistemit ujor
U/III-06	Harta e sistemit natyror
U/III-07/01	Harta e ndarjeve të njësive dhe kodifikimi
U/III-07/01	Harta e ndarjeve të njësive dhe kodifikimi
U/III-08	Harta e zonimit sipas kategorive bazë të përdorimit të propozuar të tokës
U/III-09	Harta e njësive të zhvillimit
U/III-10	Harta e mënyrave të ndërhyrjes
U/III-11	Harta e intensitetit dhe nr të kateve të propozuar
U/III-12	Harta e koeficientit të shfrytëzimit të propozuar
U/III-13	Harta e njësive të propozuara për PDV
U/III-14	Harta e shpërndarjes së popullsisë në territor
U/III-15	Harta e projekteve zhvillimore
U/III-16	Harta e shpërndarjes në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve sociale (edukimi+shëndetësi)
U/III-17	Harta e zonave të rëndësisë kombetare
U/III-18	Harta e transportit publik
U/III-19/01	Harta e infrastrukturës rrugore të propozuar
U/III-19/01	Harta e infrastrukturës rrugore të propozuar
U/III-20	Harta e shkallës së ndërhyrjes në infrastrukturën rrugore
U/III-21	Harta e zonimit të territorit
U/III-22	Harta e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit
U/III-23	Harta e nevojës për sterhim
U/III-24	Harta e planit të veprimit
U/III-25	Harta e zhvillimit ekonomik
U/III-26	Harta e zonave me prioritet zhvillimi
U/III-27	Harta e pezullimit të zhvillimit
U/III-28	Harta e zonimit sipas nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës
U/III-29	Harta e vijës së kuqe të ndërtimit
U/III-30	Harta e shërbimeve dhe infrastrukturave të propozuara
U/III-31	Harta e zonave gri